AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

| |
|---|
| **Programi i Studimit të Ciklit të Tretë Master Ekzekutiv në: "Kriminologji"** |
| **Universiteti i Tiranës** |


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Luan VELIQOTI**

**Dr. Bledar MUSTAFARAJ**


**Janar / 2023**

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për Programin e studimit Master Ekzekutiv në "Kriminologji" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësië"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i te Drejtes Penale & Departamenti i te Drejtes Publike |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master Ekzekutiv në "Kriminologji" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASR Nr. 277, datë 04.09.2020 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i Tretë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 Vite/ 4 Semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | E plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 8 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 26 PAE / 3 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | - 2020-2021 24 Studentë;<br>- 2021-2022 25 Studentë; |
| 19 | Komente / të tjera: | |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti i Tiranës (i përmendur në vijim me inicialet UT), është institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin Nr. 207, datë 30.05.1957 të Këshillit të Ministrave, i cili ka ofruar studime të nivelit universitar në gjashtë Institutet e tij: *Institutin Pedagogjik, Institutin Politeknik, Instituti Ekonomik, Instituti Mjekësor, Instituti Juridik* dhe *Instituti Shkencor.*

Përgjatë viteve ky institucion ka pësuar një sërë ndryshimesh, kryesisht në strukturën e tij. Në vitin 1991, nga UT (në atë kohë me 11 fakultete) u shkëputën fakultetet inxhinierike dhe u krijua Universiteti Politeknik i Tiranës. Në Janar të vitit 2013, u shkëputën dhe dy fakultete të shkencave mjekësore, për të krijuar Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

UT ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, me adresë qendrore: Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, dhe në Filialin e tij në qytetin e Sarandës ku ofron programet e studimit në "*Administrim Biznes*" dhe "*Gjuhë Angleze*".

Sipas strukturës aktuale, ky universitet përbëhet nga një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute si më poshtë:

- Filiali i Sarandës
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Drejtësisë
- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Instituti i Fizikës Bërthamore
- Instituti i Studimeve Europiane.

Fakulteti i Drejtësisë është themeluar në vitin 1954, nën emërtimin "Instituti i Lartë Juridik". Pas krijimit të Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Lartë Juridik u përfshi në këtë Universitet, si një nga të shtatë fakultetet, me emrin "Fakulteti i Drejtësisë". Në vitin 1965, u riorganizua dhe u quajt "Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike", ku u përfshinë dega e shkencave politike dhe ajo e drejtësisë, kurse në vitin 1967, pranë këtij Fakulteti u çel edhe dega e gazetarisë. Në vitin 1991, dega e drejtësisë u nda nga ajo e filozofisë, e cila kishte zëvendësuar degën e shkencave politike. U krijuan kështu dy fakultete të veçanta, ndërsa dega e gazetarisë u transferua në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë. Ky fakultet vepron si njësi kryesore e UT (*Evidenca 1, neni 12*), i cili ofron programe të tri cikleve të studimit.

Fakulteti i Drejtësisë (i përmendur në vijim me inicialet FDUT) përbëhet nga tri departamente, që veprojnë si njësi bazë: departamenti i së drejtës penale, departamenti i së drejtës publike dhe ai i së drejtës civile (*Evidenca 1, neni 11/2, pika IV*).

UT është akredituar institucionalisht; konkretisht, me vendimin Nr. 84, datë 27.10.2018 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, është vendosur për akreditimin institucional të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti i Tiranës, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri më 26.10.2022.

Sa i përket programit të studimit Master Ekzekutiv në Kriminologji, objekt vlerësimi, është hapur fillimisht me Urdhrin e Ministrit të Arsimit Nr. 277, datë 4.9.2020 "Për hapjen e programit të ciklit të tretë 'Master Ekezekutiv në "Kriminologji", në Universitetin e Tiranës". Hapja e këtij programi është realizuar përmes ngritjes së një bordi në nivel institucional, me përfaqësues nga rektorati i UT-së, FDUT, Fakulteti i Shkencave Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri (*Evidenca 8*).

**Ky program studimi akreditohet për herë të parë.**

Programi, objekt vlerësimi, organizohet nga departamenti i së drejtës penale në bashkëpunim me departamentin e së drejtës publike të FDUT, me mbështetjen e Fakultetit të Shkencave Sociale të UT-së, dhe synon të ofrojë arsim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional, njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe trajnim për kërkim shkencor në fushën e kriminologjisë. Programi u mundëson studentëve që kanë përfunduar studimet në master shkencor në drejtësi, shkenca sociale apo fusha të tjera të përafërta ku kanë përfituar njohuri bazë në kriminologji si dhe ata që kanë eksperiencë pune në fushën e kriminologjisë, të thellojnë njohuritë në këtë fushë si dhe të zhvillojnë aftësitë kërkimore; po ashtu nxitjen e të menduarit kritik për të qenë të suksesshëm në karrierën e tyre në fushën e kriminologjisë. Ky program është ideuar duke pasur parasysh punonjësit e praktikës të angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave penale për parandalimin e kriminalitetit si dhe ata që duan të kenë një karrierë në fushën e kriminologjisë me qëllim që të rrisin aftësitë e tyre në drejtim të parandalimit dhe luftës ndaj kriminalitetit. Synohet që, studentët që do të përfundojnë studimet në këtë Master, do të kontribuojnë për të adresuar në mënyrë efektive problemet që lidhen me kriminalitetin, për të ndërtuar një shoqëri ku mbizotëron rendi dhe qetësia (*Evidenca 4, pika 2.1; Evidenca 6.1, pika 2, germat a dhe b*).

UT ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin e programit të studimit Master Ekzekutiv në "Kriminologji", ku me shkresën Nr. 52 Prot., datë 20.1.2022 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. As. Luan Veliqoti, ekspert dhe drejtues i GVJ, dhe Dr. Bledar Mustafaraj, ekspert përbërës i grupit. Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga Muhamed Prezja, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion.

Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në FDUT, të zhvilluar në datat 15-16 Shtator 2022, sipas një agjende gjithëpërfshirëse.Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga Fakulteti i Drejtësisë në ofrimin e një programi të mirë Master Ekzekutiv në "Kriminologji"; gjithashtu, në bazë të gjetjeve gjatë punimit të këtij raporti, jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë stafin akademik, kërkimor dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të juristëve.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 19.12.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 52/179 Prot, datë 19.12.2022. Universiteti i Tiranës nuk ka dërguar komente, sugjerime në lidhje mbi Draft Raportin, sipas Manualit 2017, si dhe përcaktimit në agjendën e detajuar të vlerësimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Nga vizita në institucion dhe azhurnimi me dokumentacionin ligjor akademik të Program i Studimit (PS) të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në "Kriminologji" që ofron institucioni i arsimit të lartë: Universiteti i Tiranës (UT) Fakulteti i Drejtësisë (FD), rezulton se ai nuk bie ndesh me interesat kombëtare, *sepse mbështetet në ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015, nenet 77-78, Urdhëri i MASR Nr. 277, dt.o4.09.2020 për çeljen e masterit në fjalë, si dhe aktet nënligjore të UT, evidenca nr.1 "Statuti i UT" dhe evidenca nr. 2 "Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023.* Plani mësimor i këtij masteri me kurrikulat përkatëse mbështetet në strategjinë e zhvillimit të UT, *që orienton zhvillimin e arsimit të lartë në përsl atje me zhvillimet bashkëkohore por edhe me kushtet dhe traditën tone pozitive në fushën e arsimit, dhe si i tillë ai ruan dhe konsolidon vlerat akademike dhe kulturore kombëtare.* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë shkencore. | Masteri ekzekutiv në "Kriminologji" është zhvilluar në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë shkencore të institucionit- UT, FD, (Departamenti is ë Drejtës Penale & Publike), gjë që pasqyrohet në planin mësimor, në lëndët konkrete me syllabuset respective, por edhe me personelim akademik dhe kushtet ku ai zhvillohet. *Mbi këtë bazë PS "Master Ekzekutiv në Kriminologji" realizon qëllimin dhe misionin e tij që është: të pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara në fushën e kriminologjisë, si dhe të përgatit studentë me njohuri për zgjidhjen e problemeve teknike e ligjore që paraqet dukuria e krimit dhe kriminalitetit për parandalimin e tyre.*<br><br>*(Evidenca nr. 4: Rregullorja e PS –Master Ekzekutiv në "Kriminologji"):;* |

| | |
|---|---|
| | *(Evidenca nr. 2: Mbi strukturën akademike në PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 3.**Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim te institucionit, strategjinë për zhvillimin shkencor të Njësisë kryesore/bazë, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të tij. | Ky PS, Master Ekzekutiv në "Kriminologji" i ofruar nga Universiteti i Tiranës (UT) Fakulteti i Drejtësisë (FD), është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillimin shkencor të institucionit: të njësisë bazë, të Statutit dhe Rregullores së tij, si dhe me fushat dhe drejtimet akademike të tij. Realizimi i këtij masteri, që është niveli i tretë i kualifikimit shkencor, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë në RSH, është në funksion dhe plotëson realizimin e strategjisë së institucionit në fushën e zhvillimit dhe kualifikimit shkencor. *Në këtë mënyrë bëhet e mundur plotësimi i ciklit të zhvillimit dhe kualifikimit shkencor që kryen IAL: formimi i studentëve me njohuri bazë në fushën e jurisprudenës dhe kualifikimi i tyre në nivelin shkencor akademik apo në atë ekzekutiv, siç është rasti i zhvillimit të masterit në fjalë.*<br><br>*(Evidenca nr. 1 "Statuti i UT");*<br><br>*(Evidenca nr.2 "Strategjia e zhvillimit të UT 2018-22023").* |
| **Kriteri 4.**Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Bazuar në strategjinë e zhvillimit të arsimit të Universitetit të Tiranës, Masteri Ekzekutiv në "Kriminologji" është zhvilluar në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë shkencore të institucionit- UT, FD. Ky program studimi pasqyron njohuritë në fushën e vëllimit, prirjeve, dinamikën dhe strukturën e kriminalitetit, shkaqet dhe kushtet e zhvillimit dhe njëherësh masat për zbulimin dhe parandalimit të tij në planin kombëtar, rajonal dhe më gjerë. *Gjithashtu ai përçon tek studentët njohuri në fusha të kriminaliatetit që po bëhen gjithnjë e më shumë shqetësuese për jetën dhe veprimtarinë njerëzore, siç është kriminologjia e gjelbër, viktiminologjia, krimi i organizuar dhe terrorizmi, me qëllim parandalimin e tyre.*<br><br>*(Evidenca nr. 2: Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023").* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>*- PS "Master Ekzekutiv në Kriminologji"që ofron Institucioni i arsimit të lartë UT-FD Departaamenti i së Drejtës Penale &Publike nuk bie ndesh me interest kombëtare, sepse ai mbështetet në ligjin e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë dhe akte nënligjore të UT;*<br><br>*- PS " Master Ekzekutiv në "Kriminologji",ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit, UT-FD- paisja e* |

| | |
|---|---|
| | *studentëve me njohuri të thelluara në fushën e kriminologjisë për zgjidhjen e problemebe teknike e ligjore që paraqet krimi dhe kriminaliteti;*<br><br>*- PS Master Ekzekutiv në "Krimninologji" është në përputhje me strategjinë, statutin dhe rregulloret e institucionit, me synim ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare në fushën e kërkimit shkencor për zbulimin dhe parandalimin e kriminalitetit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br><br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Institucioni që ofron Master Ekzekutiv në "Kriminologji" ka një përvojë të gjatë akademike e shkencore në fushën e jurisprudencës, ku përshihet masteri në fjalë, ndaj dhe ka kapacitetet dhe burimet e duhura akademike e shkencore për ta zhvilluar atë. Personeli akademik i nivelit Profesor dhe Prof. Asoc. alternohet me specialist me përvojë të gjatë profesionale në fushën e kriminologjisë.<br><br>*(Evidenca nr.4: Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në" kriminologji")*<br><br>*(Evidenca nr.6.5 Tabela 4 Mbi personelin akademik të angazhuar në PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji")* |
| **Kriteri 2.**Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, | Program i studimit Master Ekzekutiv në "Kriminologji" i ofruar nga Departamenti i së Drejtës Penale & Publike i FD të UT, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore shkencore që zhvillojnë këto departamente, që është kryesisht ai i fushës penale kualifikimi i një krimi, studimi mbi shkaqet dhe kushtet e kryerjes, zbulimi, hetimi dhe gjykimi sipas një procedure ligjore, në funksion të parandalimit të kriminalitetit. Ai përbëhet me kurrikula të klasifikuara, kodifikuara e përditësuara sipas direktivave e udhëzimeve kombëtare e europiane, i cili në |

| | |
|---|---|
| sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | përfundim çertifikohet me diplomë sipas Udhëzimit të MARS. (*Udhëzimi nr.11 dt. 02.04.2020 i MASR)* |
| **Kriteri 3.**Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Shkenca e kriminologjisë, si një ndër lëndët kryesore të këtij PS, është një shkencë multidisiplinare, ndaj për realizimin e tij kërkohet dhe janë angazhuar personel akademik të fushës publike e të sociologjisë. Megjithatë, pjesën kryesore të lëndëve të planit mësimor të tij, qoftë ato të përgjitshme apo të veçanta mbulohen nga njësia bazë akademike që e ofron atë dhe që është Departamenti Penal i FD të UT.<br>*(Evidenca nr. 4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr. 6.5 Tabela 4 Mbi personelin akademik të angazhuar në PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>*- Në PS "Master Ekzekutiv në "Kriminologji", Institucioni angazhon personel akademik të fushës penale me kapacitetet e duhura akademike e shkencore, në përputhje me njësinë kryesore që e ofron dhe përggjigjet për realizimin e tij, që është Departamenti Penal;*<br>*- Në PS "Master Ekzekutiv në Kriminologji" angazhohet edhe personel akademik të fushës publike e sociologjike, gjithashtu me kapacitetet e duhura akademike e shkencore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe | Në realizimin e Programit të Studimit, Master Ekzekutiv në "Kriminologji", nga institucioni është organizuar dhe realizuar |

| | |
|---|---|
| mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | bashkunimi midis njësive përgjegjëse: Departamenti i së Drejtës Penale me atë të së Drejtës Publike, por edhe me personel tjetër akademik të jashtëm të aktivizuar, si dhe me strukturat e tjera mështetëse të institucionit, si: klinika e ligjit, sekretaria dhe biblioteka, për të ndarë detyrat, marrë përgjegjësitë dhe ndjekja në vijimësi e realizimit të tyre.<br><br>*(Evidenca nr.1 "Statuti i Universitetit të Tiranës")*<br><br>*(Evidenca nr.24 "Organigrama e FDUT për vitin akademik 2021-2022")* |
| **Kriteri 2.**Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e shkencor të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Institucioni përgjegjës për realizimin e PS, Master Ekzekutiv në "Kriminologji" ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit, siç është Minsitria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë, Fakulteti i Sociologjisë i UT, si dhe në mënyrë të veçantë me OSBE-në. *Megjithatë bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme dhe me Ministrinë e Drejtësisë duhet të ishte më konkret për çështje aktuale shqtësuese të kriminalitetit, si: korrupsioni, gjakmarrja etj, për ti konsideruar e përfshirë në temë-diplomat e studentëve.* **,** *si dhe të shihet mundësia e bashkëpunimit me Institutin e mjekësisë ligjore, me spitale psikiatrike apo me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.*<br><br>*Gjithashtu, në funskion të këtij PS, krahas bashkëpunimit defakto me Akademinë e Sigurisë, ky bashkëpunim duhet të jetë edhe i formalizuar.*<br><br>*(Evidenca nr.22 "Tabela e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të FDUT me institucioine kombëtare e ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021 dhe 2021-2022).*<br><br>*(Evidenca nr.22.1 "Relacion i takimeve me partnerë dhe bashkëpunëtorë gjatë vitit akademik 2020-2021).* |
| **Kriteri 3.**Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me industrinë dhe me rrjetet e profesionistëve, për realizimin e orëve praktike parashikuar në syllabuset e | Për realizimin e praktikës profesionale të këtij PS, Master Ekzekutiv në Kriminologji, e parashikuar si lëndë në semestrin e katërt me 10 ECTS, studentët ndërmarin studime për hartimin dhe mbledhjen e të dhënave dhe rishikimin e literatures në funksion të përgatitjes e mikrotezës. *Megjithatë, për ta bërë atë më të plotë e të garantuar, duhen më shumë marrëveshje me institucione apo rrjete profesioniste në fushën e kriminologjisë,* |

| | |
|---|---|
| lëndëve, projektit kërkimor-shkencor dhe diplomës. | *si dhe një bazë minimnale mjetesh teknike laboratorike të vetë institucionit në këtë fushë.*<br><br>Një pjesë të praktikës studentët i kanë zhvilluar në Akademinë e sigurisë, disa prej tyre punojnë në struktuara të policisë së shtetit, si punonjës socialë apo avokatë në studio ligjore, çka i ndihmon në realizimin dhe përshtatjen e praktikës profesionale. Në këtë aspectështδ e nevojshmë të bashkëpunohet edhe me institucione të tjera, si: Avokati i Popullit, Drejoria e Përgjithshme e Burgjeve etj.<br><br>*(Evidenca nr.22 "Tabela e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të FDUT me institucioine kombëtare e ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021 dhe 2021-2022).* |
| **Kriteri 4.**Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" është ende në proces dhe aktualisht nuk ka raporte analitike periodike në lidhje me rezultatet dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera në funksion të realizimit të tij, çka mbetet detyrë në vijim. *Megjithatë aktualisht ky PS është gati në përfundim dhe për këtë periudhë, edhe pse të pjesshëm, duhet të kishte një raport mbi ecurinë e bashkëpunimit dhe përmirësimin eventual të kësaj veprimtarie.* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>*- Institucioni i Arsimit të Lartë, UT, FD, ka organizuar dhe zbatuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera në funksion të zbatimit të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji"për aftësimin professional, kërkimin shkencor dhe mobiliotetit.*<br><br>*-Megjithatë, ky bashkëpunim duhet të jetë më i gjerë dhe më dinamik i shprehur në analiza periodike, për ta bërë ataë sa më funksional dhe rezultativ, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Elementët përbërës të structures së PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" janë organizuar me lëndë/module të vlerësuara me kredite (ECTS), në përputhje me Lgjin e Arsimit të Lartë Nr.80 të vitit 2015. Çdo lëndë është vlerësuar me kredite sipas orëve mësimore në auditor dhe orëve të punës individuale të studentit. Programi mësimor përmban 120 kredite, të ndara në dy vite akademike me 60 kredite secili, dhe çdo vit akademik i ndarë në dy semestra. Për çdo vit akademik. Ky PS është në përputhje me legjislacionin vendas (VKM nr.41, dt.24.01.2018, por edhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ESTC).<br>*(Evidenca nr. 4 "Rregullore e PS Masster Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr. 6.7 Tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 2.**Programi i studimit synon të garantojnë përftimin e dijeve të thelluara, aftësive profesionale, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve apo rritjen profesionale të të punësuarve. | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" garanton dije të thelluara, aftësi profesionale, shkathtësi e kompetenë për studentët që janë punonjës të praktikës të angazhuar në luftën kundër kriminalitetit, por edhe për studentë që kërkojnë të vazhdojnë karrierën në drjtësi duke thelluar njohuritë në fushën e kriminologjisë dhe parandalimit të kriminalitetit.<br>Nëpërmjet këtij PS, në veçanti me njohuritë e disa lëndëve të planifikuara në të, si: teoritë mbi kriminalitetin të zgjeruara, viktiminologjia, hetimit kriminal, psikologjia ligjore etj., synohet që studentët të profilizohen në fushën e studimit të kriminalitetit dhe hartimin e programeve e strategjive të luftës |

| | |
|---|---|
| | kundër tij, çka bën të mundur plotësimin e aftësive të studentëve duke lehtësuar punësimin e tyre dha, nga ana tjetër, të plotësojë aftësitë profesionale të atyre që janë në punë në luftën kundër kriminalitetit.<br><br>*(-Evidenca nr. 4 "Rregullore e PS Masster Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br><br>*(-Evidenca nr. 6.7 Tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 3.**Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshire dhe kreditet e detyrimeve përmbyllëse. | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" përmban 17 lëndë, nga të cilat 9 janë të detyrueshme dhe 8 oftohen si lëndë me zgjedhje, prej të cilave janë zgjedhur dy, nga një për çdo semester të vitit të pare akademik. Çdo lëndë/modul ka të përcaktuar ngarkesën në kredite, si ato që zhvillohen në auditor, ashtu edhe ato jashtë tij e përmyllëse, që në tërësinë e tyre përbëjnë 120 kredite (ESTC). Raporti i ngarkesës teorike me atë praktike është i drejtë, 58/42/%. Megjithatë, duke konsideruar emërtimin "Ekzekutiv" të këtij masteri, pra me prirje aplikative të njohurive në fushën e studimit dhe parandalimit të kriminalitetit, në një azhurnim eventual të structurës dhe syllabusve të lëndëve/moduleve të këtij PS, *të shihet mundësia që raporti i mësipërm të bëhet 60/40%, duke shtuar orë praktike në lëndën "Viktiminologjia".*<br><br>*(-Evidenca nr. 4 "Rregullore e PS Masster Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br><br>*(-Evidenca nr. 6.7 Tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 4.**Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Sipas "Rregullores së PS" forma e organizimit të studimeve tëtij realizohen në formën e leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave mësimore, vizitave mësimore, konferencave e mësimit interaktiv. Pranimi i studentëve bëhet mbi bazën e kuotave dhe kritereve të pranimit të përcaktuar nga Departamenti is ë Drejtës Penale & Publike dhe të miratuara nga Senati i UT. Ky PS financohet nga buxheti i shtetit, nga pagesat (tarifat) e studentëve. Por edhe nga donacione siç është OSBE-ja, finacim ky i mbështetur dhe në përputhje me Ligjin Arsimin e Lartë në RSH.<br><br>(Evidenca *nr.1, Statuti i UT ;)* |

| | |
|---|---|
| | *(Evidenca nr.4, RRegullore e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.11, Mbi procedurën e miratimit të tarifave në programin Masster Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr. 12, Mbi kriteret e pranimit në PS master Ekzekutiv në "Kriminologji", viti akademik 2022-2023 ;)*<br>*( Evidenca nr. 13, Njoftim mbi aplikimin nè PS Masster Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*( Evidenca nr.14, Mbi shpalljen e fituesve në PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*( Evidenca nr. 14.1 Mbi ngritjen e komisionit për zgjedhjen e fituesve në PS Masster Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.15, Veendim nr.35 dt.21.10.22020 i Senatit Akademik të UT, për miratimin paraprak të tarifës së regjistrimit dhe shkollimi për PS të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në "Kriminologji", Fakulteti i Drejtësisë, për vitin akademik 2020-2021, nr.2901 prot, dt.21.10.2020).* |
| **Kriteri 5.**Programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Ky PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji", i ofruar nga Institucioni i arsimit të lartë: UT, FD, Departamenti i së Drejtës Penale &Publike, është i vetmi dhe individual në llojin e vet i organizuar dhe që funksionon në RSH.<br>*(-Evidenca nr. 6.7 Tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 6.**Një programi studimi shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryet kodifikimi i lëndëve të programit. | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" nuk shoqërohet me kod përkatës.<br>*Njësia kryesore dhe njësia bazë që ndjek zbatimin e këtij PS, në bp me zyrën e kurrikulave dhe njësinë e kontrollit të brendshëm të cilësisë, ta zgjidhë këtë çështje.* |
| **Kriteri 7.**Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Departamentit të së Drejtës Penale & Publike të FD të UT, si dhe në partneritet e bashkëpunim me fakultetin e Sociologjisë të UT. |

| | |
|---|---|
| lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | *(-Evidenca nr. 4 "Rregullore e PS Masster Ekzekutiv në "Kriminologji");* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>*- PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji"është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi kombëtare, si dhe akteve e rregulloreve të të brendshme, me përjashtim të paisjes me kod përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra nga Ministria e Arsimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br><br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Njësia kryesore bazë e UT, Fakulteti i Drejtësisë që ofron PS, Masteri Ekazekutiv në "Kriminologji" ka koordinuar veprimtarinë e dy njësive bazë të tij, si: Departamenti is ë drejtës Penale & Publike të ngarkuar direct në realizimin e këtij PS. Në përbërje të dy departamenteve të mësipërm ka një numër të mjaftueshëm personel akademik të brendshëm me tituj e grada shkencoire, të cilët të mbështetur nga struktura ndihmëse të FD dhe Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë e UT, bëjnë mundur përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin, strukturën, vlerësimin dhe akreditimin PS në fjalë.<br><br>Departamenti is ë Drejtës Penale ka në përbërje 26 personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët: 4 Prof. Dr., 9 Prof. assoc., 7 Dr dhe 6 MSC. Ndërsa Dep. i së Drejtës Pubblike ka 27 personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët: 4 Prof. Dr., 6 Prof.assoc. Dr., 12 Dr, 1 Doc. Dhe 1 MSC<br><br>*(Evidenca nr.1 Statuti i UT);*<br><br>*(Evidenca nr.24 Organigrama e FDUT për vitin akademik 2021-2022).* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e orëve praktike sipas syllabuseve të lëndëve, punëve laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj. | Sipas organigramës së FD të UT, në të përfshihet edhe personel ndihmës akademik me karakter mësimor-shkencor, me kohë të plotë, si dhe personel ndihmës akademik me karakter administrative etj., sipas syllabuseve të lëndëve; në ndihmë të praktikave mësimore në terren të studentëve, Departamentet e së Drejtës Penale & Publike bashkëpunojnë edhe me klinikën ligjore të FDUT - së, gjë që ka bërë të mundur përmbushjen e detyrimeve ligjore, për mbështetjen dhe marëvajtjen e procesit mësimor, si: për realizimin e praktikave mësimore, projekteve studimore e kërkimore, punëve laboratorike etj.<br>*(Evidenca nr.1 Statuti i UT);*<br>*(Evidenca nr.24 Organigrama e FDUT për vitin akademik 2021-2022).* |
| **Kriteri 3.**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Njësia kryesore bazë përgjegjëse pë realizimin e PS Master Ekzekutiv në “Kriminologji”, mbështetur në Rregulloren e këtij PS, për koordinimin e ecurisë dhe zhvillimit e këtij programi ka caktuar si përgjegjës Prof. assoc. Dr. Skerdian Kurti, pedagog i brendshëm i kësaj njësie.<br>*(Evidenca nr. 4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në “Kriminologji”)* |
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin ngre bordin e programit të studimit (organ këshillimor) që është i ndërtuar për programin e studimit dhe përbëhet nga personeli akademik, studentët, politikëbërësit dhe përfaqësuesit e tregut të punës. Në aktivitetin e tij bordi këshillimor mbështet ruajtjen e cilësisë së kurrikulës dhe përshtatjen e | Për realizimin e PS Masetr Ekzekutiv në “Kriminologji” njësia kryesore bazë FDUT ka ngritur bordin këshillues me qëllim mbikqyrjen e dokumentacionit përkatës dhe ndjekjen e zhvillimit të tij, si: në përgatitjen e rregulloreve, përcaktimin dhe zhvillimin e kurrikulave, në përzgjedhjen e stafit akademik, në kriteret e pranimit të studentëve, orarit, kohës dhe vendin e zhvillimit dhe përshtatjen e PS me tregun e punës, etj. Në përbërje të këtij bordi këshillues bëjnë pjesë personel akademik, student, por në të mungojnë politikbërës dhe përfaqësues të tregut të punës.<br>*(Evidenca nr.8 Mbi krijimin e bordit këshillimor për PS Master Ekzekutiv në Kriminologji”).* |

| | |
|---|---|
| saj me kërkesat e tregut të punës. | |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Njësia kryesore bazë përgjegjëse për zhvillimin e PS Master Ekzekutiv në kriminologji ka në përbërje numër të mjaftueshëm personel akademik me tituj e grada shkencore sipas kërkesave ligjhore;*<br>- *Në Dep. e së Drejtës Penale përfshihet edhe personel ndihmës akademik me karakter mësimor-shkencor, me kohë të plotë, si dhe personel ndihmës akademik me karakter administrative etj., sipas syllabuseve të lëndëve; në ndihmë të praktikave mësimore të studentëve;*<br>- *Për funksionimin me sukses të PS Master Ekzekutiv në Kriminologji, njësia bazë e FDUT ka ngitur një bodr këshillimor, si dhe ka zaktuar një personel akademik për ndjekjen e mbarëvajtjes së masterit në fjalë..* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Njësia kryesore FD dhe ajo bazë Departamenti isë Drejtës Penale & Publike disponojnë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e PS Master Ekzekutiv në “Kriminologji”. Ky informacion i është referuar Statutit të UT dhe Rregullores së këtij programi. Në organizimin e PS në fjalë janë mbajtur parasysh kërkesat e tregut të punës, kërkesat ligjore të arsimit të lartë, por edhe vëllimi, struktura, dinamika dhe tendencat e kriminalitetit në vendin tone.<br>*(Evidenca nr.1 Statuti i UT)*<br>*(Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në “Kriminologji”);* |

| | |
|---|---|
| | *(Evidenca nr. 6.1 Informacion mbi PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" përmban planin mësimor me informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve/moduleve në semestra, ngarkesën mësimore të tyre, orët në auditor e jashtë tij etj. Ky PS është i ndarë në dy vite akademikë me nga 60 kredite ESTC secili. Sasia e orëve të një student është 1500 orë mësimore, ku përfshihen orët në auditor dhe orë të punës së pavarur të tij. Në syllabuset e lëndëve/moduleve ndodhet i gjithë informacioni i nevojshëm: lëndët sipas viteve, orët dhe raporti teori/praktikë sipas llojit të lëndëve, detyrimet, vlerësimi vazhdues etj. Lëndët janë të ndarë në semstra e vite sipas informacionit që ato përmbajnë, duke qënë në harmoni dhe në funksion të plotësimit të informacionit të pëgjithshëm që merr studenti nga njera anë, por edhe të jetë dhe i lehtë në përvetësimin e tij.<br>*(Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Në Statutin e UT dhe Rregullloren e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" përshkruhen informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, si: kriteret e pranimit, kriteret e përzgjedhjes së studentëve dhe fituesit sipas kuotave të miratuara nga Senati i UT.<br>*(Evidenca nr. 1 Statuti i UT);*<br>*(Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, për orët praktike, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të | Program i lëndëve dhe syllabuset përbërëse të tyre përmbajnë objektivat formuese të lëndës, konceptet themelore të saj, metodat e mësimdhënies, detyrimet e studentit, temat e lëndës, format e kontrollit të dijeve, literatura bazë dhe ndihmëse (në shqip dhe gjuhë të huaj). Sipas VKM nr. 41, dt. 24.01. 2018, 1 kredit ESTC llogaritet në rreth 25 orë mësimore, ndërsa orë pune në auditor 1 kredit ESTC llogaritet në 10 orë mësimore. Në shpërndarjen e orëve teori praktikë në çdo syllabus mbahet parasysh që raporti teori/ praktikë të jetë 40/60% në favor të |

| | |
|---|---|
| programit, brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara. | praktikës. Në planin mësimor të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" parashikohet dhe ruhet ky raport.<br>*(Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").* |
| **Kriteri 5.**Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Syllabuset e lëndëve, në përbërje të PS, miratohen për çdo vit akademik, mbas përditësimit të informacionit – temave dhe nënçështjet, në veçanti të literaturës. Në hartimin e syllabusve dhe programit të çdo lënde është mbajtur parasysh mos dublimi dhe përsëritja e të njëjtit informacion me një lëndë tjetër sado e përafërt me të. Nuk konstatohen ndryshime në planin mësimor të miratuar fillimisht nga senati i UT.<br>*(Evidenca nr.33 "Dosja e plotë didaktike").* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" është i detajuar, informues, i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të tij.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose | PS është i emërtuar Master Ekzekutiv në "Kriminologji". Ai zhvillohet në dy vite akademike me 120 kredite (ECTS) me kohë të plotë, me 60 kredite për çdo vit akademik. Ne përfundim të studimeve, mbas shlyerjes së detyrimeve akademike e financiare student paiset me Diplomë Master Ekzekutiv në "Kriminologji" me suplementin dhe listën e notave.<br>Plani mësimor, natyra dhe lëndët/modulet përbërëse, emërtimi dhe kategorizimi i tyre, zhvillimi i orëve mësimore, punës |

| | |
|---|---|
| promovimin profesional të studentëve. | individuale dhe praktike studimore të studentëve, mundësojnë thellimin e njohuroive dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve në fushën e zbulimit dhe parandalimit të kriminalitetit.<br>*(Evidenca nr.33 Dosja e plotë didaktike – referuar VKM nr.41, dt.24.01.22018);*<br>*(Evidenca nr.7 Mbi studimin e tregut të punës për PS Master Ekzekutiv në " Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.9, Strategjia e zhvillimit të PS Master Ekzekutiv* në *"Kriminologji").* |
| **Kriteri 2.**Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" përmban lëndë të emërtuara, të kategorizuara e të shoqëruara me kredite respektive në mënyrë të atillë që mundësojnë arritjen e objektivave fformues të PS dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Ky PS përmban përman lëndë/moduele me kredite sipas VKM nr.41, dt.24.01, 2018 me ndryshime. Struktura e planit mësimor përfshin lëndë/module të harmonizuara në informacion e që plotësojnë dhe lehtësojnë dijet që studentët duhet të marrin, për tu pajisur me aftësi dhe kompetenca për punë të pavarur, për kërkim shkencor dhe rekomandime në fushën e zbulimit dhe parandalimit të kriminalitetit. Bazuar në strukturën e planit mësimor të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji", realizohet qëllimi i çeljes së këtij PS: Përgatitja e specialistëve për studimin ekrimit dhe të kriminalitetit për të sugjeruar politika dhe p/ligje për parandalimin e tij.<br>*(Evidenca nr.7 Mbi studimin e tregut të punës për PS Master Ekzekutiv në " Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").* |
| **Kriteri 3.**Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Struktura e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" përmban lëndë që fillohet me informacion të përgjithshëm në fushën e studimit të kriminalitetit, *siç janë psh, lëndë: (Teoritë kriminologjike, Sistemet* e *drejtësisë penale*), në ato me njohuri specifike e më profesionale, *siç janë p.sh. (Viktiminologjia, Kriminologjgia e gjelbër, terrorizmi* etj.) Për studimin, zbulimin dhe parandalimit të kriminalitetit. Ngarkesa në kredite dhe raporti teori-praktikë, është në përputhje me profilin e PS në fjalë dhe i ngjashëm me programe ndërkombëtare. |

| | |
|---|---|
| | *Këtë fakt e provon edhe mbështetja që i bë këtij PS ambasada amerikane dhe të OSBE-së.*<br><br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").*<br><br>*(Evidenca nr.33 Dosja e plotë didaktike – referuar VKM nr.41, dt.24.01.22018);*<br><br>*( Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");* |
| **Kriteri 4.**Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, dhe mobilitet. | Në PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" ndarja e veprimtarive formuese, krahas kërkesave ligjore në fuqi është bazuar edhe në praktika të universiteteve të huaja, si Universiteti i Bolonjës, i Malmoe, Oxford, etj.<br><br>Në ndarjen e veprimtarive formuese dhe raportin formimit teporik e praktik mbahet parasysh realizimin e objektiavave të kërij PS, që janë formimi i studentëve me njohuri të thella teorike e praktike për:<br><br>-metodat e studimeve kriminologjike;<br><br>-format e shfaqjes së kriminalitetit dhe rreyhanat që e mundësojnë atë;<br><br>- studimin e personallitetit të autorit të krimit dhe të viktimës së tij;<br><br>- Masat për parandalimin e kriminalitetit.<br><br>Ndarja e veprimtarive formuese dhe raporti midis formimit teorik me atë praktik të PS në fjalë mundësojnë arritjen e objektiva e formuese, transferimit të studimeve dhe mobilitet në kuadër të prejektit Erasmus +.<br><br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").*<br><br>*(Evidenca nr.33 Dosja e plotë didaktike – referuar VKM nr.41, dt.24.01.22018);*<br><br>*(Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");* |
| **Kriteri 5.**Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" ka pak kohë që ka filluar. Si i tillë nuk lejon koha fizike për të azhurnuar kompetencat e fituara me ato të tregut të punës, por megjithatë, lëndët/modulet |

| | |
|---|---|
| mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | e vitit të parë, që janë zhvilluar për herë të dytë, (me vitin e parë actual) është përditëssuar literatura, në veçanti ajo ndihmëse e botuar së fundmi në fushën e studimit dhe parandalimit te krimit në organe të sistemit të jurisprudencës apo në fusha të ngjashme.<br>*(Evidenca nr.33 Dosja Didaktike referuar VKM nr. 41, dt24.01.201)* |
| **Kriteri 6.**Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Struktura e planit mësimor, lëndët/modulet me syllabuset reskektive, mbas realizimit të detyrimeve nga student, bën të mundur realizimin e objektivave mësimore, garantimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e studimit, zbulimit dhe parandalimit të kriminalitetit duke zgjidhur dhe adresuar në praktikë detyrat si specialist i kësaj fushe.<br>*(Evidenca nr.33 Dosja e plotë didaktike referuar VKM nr.41, dt.23.01.2018, "Për elementët e programit të studimit të ofruar nga IAL i ndryshsuar");*<br>*(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 7.**Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Studentët e paisur me diplomën: Master Ekzekutiv në "Kriminologji", mund të vazhdojnë studime të tjera të thelluara, siç është p.sh. Doktoratura në drejtësi. Gjithashtu, me njohuritë e këtij PS, jo vetëm që bëhen më të aftë profesionalaisht dhe të sigurtë në vendin e punës që janë, por kanë më shumë mundësi vlerêsimi nga një punëdhës e rrejedhimisht të fitojnë një vend pune në fushën e studimit, zbulimit dhe parandalimit të krimit, mbas një aplikimi eventual.<br>*(Evidenca nr.7 Mbi studimin e tregut të punës pë PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.22.1 Relacion i takimeve me partnerë dhe bashkëpunëtorë gjatë vitit akademik 2020-2021);*<br>*(Evidenca nr.3, Plani i kërkimit shkencor të UT 2017-22022).* |
| **Kriter 8.** Programi i studimit duhet të jetë kombinim i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, orëve praktike, që mundësojnë zgjidhje praktike novatore të | Mbështetur në strukturën e këtij PS, në lëndët/modulet me syllabuset përkatëse, konstatohet gërshetim i formimit teorik e shkencor me atë praktik, si: ese-të, punë laboratori, vizita e anketa në terren e në institucione ligjzbatuese etj, çka bën të mundur fitimin e shprehive dhe konslifimin e kompetencave profesionale në fushën er kriminlogjisë. Ky PS mundëson studimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve e rekomandimeve kundër |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| problemeve me të cilat përballen institucionet/organizatat. | kriminalitetit. Me këto njohuri krijohet mundësia edhe zhvillim karriere dhe krijimin e drejtuesve me competencë profesionale. *(Evidenca nr.7, Evidenca 6.1, Evidenca nr.33).* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Struktura dhe organizimi i programit të studimit Master Ekzekutiv në Kriminologji është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bordit këshillimor, institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Institucioni ka kryer disa marrëveshje me institucione arsimore e të tregut të punës në funskion dhe konsultuar për përgatitjen e përmbajtjes së PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji", në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu njësitë përgjegjëse Departamenti i së Drejtës Penale & Publike kanë organizuar konsulta, kanë marrë në consideratë mendimet e padagogëve në përgatitjen e syllabusve, por edhe të njësisë së sigurimit të cilësisë së brenshëm NJSBC. Si PS i ri ngelet që në vazhdimësi të konsultohen me institucione partnere, me bordin e këshillimit të plotësuar me anëtarë nga politika apo punëdhës, si dhe me studentët që do të diplomohen. *(Evidenca nr. 7, Evidenca nr.6.1, Evidenca nr.22, Tabela e marrëveshjeve me të bashkëpunimit të FD meinstitucione kombëtare e ndërkombëtare gjatë viti akademik 2020-2021 dhe 2021-2022, (Evidenca nr.22.1)* |
| **Kriteri 2.**Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" është në proces përfundimi. Gjatë këtyre dy viteve akademikë njësitë bazë përgjegjëse për zbatimin e tyre kanë nxitur dhe konsideruar sugjerimet e studentëve në funksion të përmirësimit të programit |

| | |
|---|---|
| konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | në fjalë. Për të garantuar vazhdimësinë dhe cilësinë e këtij programi, njësia kryesore FD dhe njësitë bazë - Departamenti i së Drejtës Penale & Publike, të mbajnë lidhje dhe kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për të marrë e konsideruar prej tyre mendimet, sugjerimet dhe problematikat e hasura në praktikë në lidhje me PS. |
| **Kriteri 3.**Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat dhe riorganizon programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me bordin këshillimor të programit, rrjete profesionistësh dhe organizatat publike e private. | Departamenti i së Drejtës Penale & Publike të FD UT nëpërmjet bordit të këshillimit, por edhe nga bashkëpunimime organizata e rrjete partnere, në veçanti me OSBE-në ndjek dhe përditëson arritjet e fundit në fushën e studimit, zbulimit dhe parandalimit të kriminalitetit, në funskion të përmirësimit të programit të studimit, Master Ekzekutiv në "Kriminologji".<br><br>*(Evidenca nr.8, Evidenca nr. 34 Memorandum mirëkuptimi midis OSBE dhe UT për bashkërendimin dhe bashkëpunimin në zhvillimin e projekteve dhe veprimtarieve me interest ë ndërsjelltë.).* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>- *Institucioni i arsimit të lartë, FDUT nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.6**<br><br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" i ka të përcaktuara qartë objektivat mësimore e kërkimore shkencore, të cilat janë në përputhje me objektivat dhe misionin e UT. Ky PS ofron kualifikim dhe aftësi intelektuale për karrierë dhe studime të pavarurra në fushën e luftës kundër kriminalitetit. Objektiva këto |

| | |
|---|---|
| përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | që brenda objektivave madhore të UT: edukim me në qendër studentin, nxit rritje personale dhe intelektuale për karrierë productive dhe qytetarë të përgjegjshëm në një shoqëri globale.<br>*(Evidenca nr.3, Plani i kërkimit shkencor të UT 2017-22022).*<br>*(Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");* |
| **Kriteri 2.**Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Në bazë të ligjit të Arsimit të Lartë në RSH dhe statutit të UT, njësia kryesore\bazë gëzon liri akademike, e cila materializohet në mundësinë dhe mbështetjen e personelit akademik për ndërmarrje dhe aktiviteti të ndryshme shkencore, si: artikuj shkencorë, pjesmarrje në konferenca shkencore etj. Kështu, p.sh. përmendet Konferenca Shkencore Kombëtare: "Për krimet fiunanciare, pastrimin e parave dhe siguria kombëtare", në Shtator 2921, si dhe Konferenca në bp me OSBE-në me temë: "Roli i teknologjisë në parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit", në Qershor 2022. Gjithashtu, liria akademike shprehet edhe në përgatitjen e syllabusve të lëndës, brenda kornizës formale, në temat dhe nënçshtjet, trajtimi dhe interpretimi i tyre, si dhe në lidhjen e teorisë me praktikën, sipas mendimit individual të lektorit. |
| **Kriteri 3.**Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Në syllabuset e lëndëve/moduleve të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji", parashikohen studime, ese, projekte etj. të cilat krahas detyrimeve studentore, nxitin dhe motivojnë studentët të angazhohen në aktivitete të ndryshme shkencore, siç është rasti i pjesmarrjes së studentëve në shkollën verore në korrik 2022 në Universitetin LUISS në Romë, por edhe pjesmarrja e studentëve në Konferencat shkencore Kombëtare të përmendura në Kriterin 2 të Standartit II 6, edhe kanë referuar kumtesë. *(Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji"); (Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji")* |
| **Kriteri 4.**Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron | Njësia bazë mbështet nga institucioni për të financuar studime dhe aktivitete shkencore siapas projekteve të paraqituara nga personeli akademik e të miratuara nga departamenti, si dhe administron të ardhura nga aktivitete të ndryshme conform rregullave ligjore financiare. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga GVB dhe konsulta në institucion nuk ka patur një financim konkret nga buxheti i shtetit për kërkimin shkencor në lidhje me këtë PS, si dhe nga njësia bazë nuk janë administruar të ardhura |

| | |
|---|---|
| të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | nga aktivitete të ndryshme conform rregullave ligjore, me përjashtim të financimit nga OSBE, çka mbetet si kërkesë për tu realizuar në të ardhmen një financim i tillë. *(Evidenca nr. 1 Statuti i UT; Evidenca nr.3 Plani i kërkimit shkencor të UT 2017-2022 ;) (Evidenca nr.35 Seminar i organizuar nga Luiss Schol of Low – University of Tirana).* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>*- PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" garanton orientim dhe motivim të personelit akademik dhe studentëve në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.*<br>*- Duhet më shumë financim në të ardhmen në fushën e kërkimit shkencor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Departamenti i së Drejtës Penale & Publike të FD UT organizon, ndjek dhe mbështet veprimtarinë kërkimore-shkencore të grupeve lëndore. Pë këtë qëllim Instituconi ka realizuar marrëveshje e bashkëpunuar me institucione të ndryshme, si: me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe OSBE-në etj, çka ka ndihmura në përcaktimin dhe zhvillimin e përshtatshëm të kurrikulës, lëndëve/moduleve dhe kërkimit shkencor. *(Evidenca nr.4, Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.22 Tabela e marrëveshjeve të bashkëpunimit të FD me institucione kombëtare e ndëekombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021&2021-2022).* |
| **Kriteri 2.**Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e | Departamenti i së Drejtës Penale & Publike të FD UT bashkëpunon me Degën për projekte dhe mësimdhënie për të ndjekur dhe realizuar kërkesat eventuale për analiza, studime e |

| | |
|---|---|
| projekte me karakter kërkimor shkencor në nivel lokal, kombëtar apo rajonal, angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | projekte me karakter local, kombëtar apo rajonal duke angazhuar personelin akademik dhe studentët për realizimin e tyre.<br>*(Evidenca nr.22 Tabela e marrëveshjeve të bashkëpunimit të FD me institucione kombëtare e ndëekombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021&2021-2022).*<br>*(Evidenca nr.35 Seminar i organizuar nga Luiss Schol of Low – University of Tirana- OSBE*<br>*Organized Crime and Artificial Intelligence. The New Frontiers of the Criminal Justice.* |
| **Kriteri 3.**Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | Njësia përgjegjëse e PS Departamenti i së Drejtës Penale & Publike të FD UT ka organizuar konferenca dhe aktivitete shkencore, disa të cituara më sipër në Kriterin 2 të Standartit II 6, të cilat ndihmojnë personelin akademik dhe studentët për arritjen e objektivave të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji".<br>*(Evidenca nr.8, Evidenca nr. 34 Memorandum mirëkuptimi midis OSBE dhe UT për bashkërendimin dhe bashkëpunimin në zhvillimin e projekteve dhe veprimtarieve me interest ë ndërsjelltë.).*<br>*(Evidenca nr.22 "Tabela e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të FDUT me institucioine kombëtare e ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021 dhe 2021-2022).* |
| **Kriteri 4.**Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | Sipas planit mësimor, lëndët/modulet me syllabuset përkatëse, personelin akademik që e zbaton atë, personeli ndihmës dhe kushtet ku zhvillohet, PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji" formon profesionistë konkurues për tregun kombëatar dhe ndërkombëtar të punës në fushën e studimit, zbulimit dhe parandalimit të kriminalitetit. Ky PS është unik në vendin tone, ndërkaq meqënëse ai zhvillohet mbas dite (ora 16. 00 e në vijim) krijon lehtësira për vazhdimin e tij nga studentët që kryesisht vine nga marrënie pune. Si fillim ky PS është i kërkuar duke qënë se u plotësuan të gjitha kuotat e shpallura nga Instiucioni. Meqëse është fillimi, mbetet të shihet konkurenca në tregun e punës, por sa më sipër garanton sukses në këtë drejtim.<br>*(Evidenca nr.4 Rregullorja e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").* |

| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>*- Programi i Studimit: Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji" garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.në fushën e studimit dhe parandalimit të kriminalitetit.*<br>*- Me njohuritë e fituara në këtë PS bëhet e mundur edhe poersoektiva*<br>*Dhe konkurueshmëria e tij në tregun e punës.-* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësishtsisë** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin dhe që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, orët praktike të parashikuara në syllabuset e lëndëve, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji" zhvillohet në bazë të programit mësimor të miratuar dhe rregullores së këtij PS. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë metodat e praktikat më të mira, duke patur në qendër të tyre studentin, siç janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, orët praktike etj, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve të këtij PS.<br>*(Evidenca nr.33 "Dosja e plotë didaktike")*<br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.**Format dhe metodat e mësidhënies, garantojnë sigurimin e njohurive dhe zotërimin e metodave të avancuara të aftësimit profesional, që lidhen me fushën e studimeve dhe aplikimin e tyre. | Format dhe metodat e mësimdhënies të zbatuara në PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji", duke i dhënë përparësi punës së pavarur të studentit, si projekte, detyra etj, në vlerësimin e tij, garantojnë sigurimin e njohurive dhe zotërimin e metodave të avancuara të aftësimit profesional në fushën e studimit, zbulimit dhe parandalimit të kriminalitetit. Numri i orëve në auditor është në 10 orë mësimore për çdo 1 kredit (ECTS), ndërsa për 15 orët e punës së pavarur për çdo 1 kredit (ECTS) , student vlerësohet në masën rreth 60% në formën e detyrave/ projekteve kërkimore.<br><br>*(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në" Kriminologji")*<br><br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").* |
| **Kriteri 3.**Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Personeli akademik ndjek dhe zhvillon metodat e mësimdhënies e të mësimnxënies, për t'ju përgjigjur nevojave të studentëve, duke kombinuar ato klasike në auditor me komunikimet elektronike, konsultime dhe udhëheqje në detyra e projekte të ndryshme, rekomandim e sigurim të literaturës etj. Në këtë PS mësimi zhvillohet mbasdite, gjë që u krijon mundësi studentëve që janë në marrënie pune të vazhdojnë edhe studimet.<br><br>*(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji")*<br><br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").* |
| **Kriteri 4.**Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime që kanë në qendër studentin, nxisin mendimin krijues dhe kritik të studentit, autonominë dhe | Personeli akademik i ngarkuar për të zhvilluar këtë PS është i kategorisë "Profesor" dhe "Prof.Assoc", me kohë të plotë apo të pjesshme, gjë që me eksperiencën e tyre fushën akademike garanton kompetencën e transmetimit të dijeve tek studentët, nxisin mendimin krijues të tyre, kryesisht nëpërmjet punës së pavarur jashtë auditorit, por edhe përgjegjshmërinë në fitimin e shprehive dhe iniciativës së mendimit deri në projekte të luftës kundër kriminalitetit. Në këtë PS, krahas personelit akademik të kategorisë "Profesor", janë angazhuar edhe specialistë me përvojë në fushën luftës kundër kriminalitetit.<br><br>*(Evidenca nr.4; Evidenca nr.6.5, tabela 4 Mbi personelin akademik të angazhuar në PS Master Ekzekutiv në* |

| | |
|---|---|
| përgjegjshmërinë në funksion të zgjidhjeve praktike.<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | *"Kriminologji"; Evidenca 6.6 Tabela 5 Mbi lëndët dhe pedagogët në PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji"; Evidenca nr.33 Dosja e plotë didaktike).* |
| **Kriteri 5.**Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Stafi akademik i angazhuar në këtë PS, krahas përmirësimit të kompetencave didaktike duke ndjekur zhvillimet në këtë fushë, në mënyrë të veçantë është trajnuar nga pedagogë të huaj me mbështetje të OSBE-së. Ky trajnim, që është zhvilluar nga Prof.Kimberly McCabe – ekspert ndërkombëtar i kriminologjisë nga Universiteti i Linçburgut- Virxhinia USA, ka patur si qëllim përmirësimin e aftësive kërkimore të profesionistëve dhe personelit akademik të fushës.<br>*(Evidenca nr.16 Informacion për rritjen e kapaciteteve të stafit akademik të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 6.**Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel Programi dhe në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e tyre. | Ne kuadër dhe me qëllim përsosjen e metodave të mësimdhënies së stafit akademik të angazhuar në këtë PS, institucioni në bashkepunim me OSBE ka organizuar një seminar trajnimi në fushën e kriminologjisë me profesorë nga Universiteti i Virxhinias SHBA, si dhe seminari i organizuar nga Luiss Schkol of Law Romë – Universiteti i Tiranës me mbështetje të OSBE-së, me temë: "Corruption, Organized Crime and Artificial Inteligence: the New Frontiers of the Criminal Justice".<br>Institucioni ka ngritur një strukture (përgjegjës) për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e këtij PS që është Prof.assoc Dr. Skerdian Kurti.<br>*(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji")*<br>*(Evidenca nr.6.7, tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master "Ekzekutiv në Kriminologji").* |

| Konkluzione | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *IAL garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor të studentëvwe, nëpërmjet zbatimit të metodave dhe praktikave më të mira të mësimdhënies, duke patur në qendër studentin;*<br>- *Personeli akademik i ngarkuar për zhvillimin e këtij PS janë të kategorisës Prof., Prof. Assoc dhe Dr.*<br>- *Megjithë përvojën e gjatë akademike, institucioni organizon seminare trajnimi me stafin akademik për aftësimin e mëtejshmëe të të tyre në fushën e kërkimit shkencor për studimin dhe parandalimin e kriminalitetit.* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br><br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale të studentit realizohen në bazë të komponentëve vlerësues gjatët semestrit për çdo lëndë të përcaktuar në Rregulloren e PS dhe të bërë publike dhe njohur nga studentët. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme me prezantime, projekte etj, si dhe me provimin me shkrim e i kombinuar me gojë. Ky vlerësim është evidentuar me nota për çdo student në Regjistrin e posaçm të këtij PS ne sekretarinë e institucionit - FD. *(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 2.**Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e | Në fillim të çdo lënde/moduli lektori, titullari i lëndës informon studentët mbi metodologjinë e vlerësimit të njohurive, të dijeve e të aftësive profesionale e shkencore sipas parashikimeve në syllabuset e lëndëve/moduleve. Njëherësh syllabuset e çdo lënde u vihen në dispozicion studentëve në mënyrë fizike dhe elektronike. Këto detyrime të stafit akademik janë parashikuar në Rregulloren e PS. |

| | |
|---|---|
| lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | *(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 3.**Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Sipas Rregullores së PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" format dhe kriteret e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve përcaktohen në programin e çdo lëndë/moduli dhe i bëhen të ditura studentit në fillim të semestrit. Forat e vlerësimit bëhen të kombinuara, proviv me shkrim/ gojë por edhe i kombinuar me esse, projekte etj, me qëllim që student të shprehi lehtë dijet e fituara por edhe të bëhet një vlerësim sa më objektiv e i plotë i tyre. *(Evidenca nr. 4, Evidenca nr.33).* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Institucioni ka hartiuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve dhe ka garaantuar zbatimin e tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve shkencoredhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në syllabuset e çdo lëndë/moduli janë të përcaktuara kriteret e vlerësimit të studentëve për gjatë gjithë semestrit. Në bazë të rregullores së PS temat për realizimin e detyrave të kursit shpallen pa përfunduar semestri akademik (rreth javës së gjashtë) dhe në bp me studentët padagogët bëjnë miratimitn e tyre, duke u dhënë njëherësh edhe udhëzimet dhe literaturë për përgatitjen e tyre. Testimi i studentëve realizohet sipas një kalendari të miratuar nga përgjegjësi i njësisë bazë. *(Evidenca nr.4, Evidenca nr.33).* |
| **Kriteri 2.**Institucioni vë në zbatim sisteme të vlerësimit, | Në bazë të rregullores së PS, provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke u mbajtur i paditur emri i studentit deri sa |

| | |
|---|---|
| të cilat garantojnë nivel të lartë integriteti, etike dhe transparence. | provimi dorrëzohet i korigjuar në sekretari. Në fletën e provoimit shënohet numri i pikëve të fituara mbas korigjimit nga pedagogu dhe firmosur prej tij. Vlerësimi i sudentëve kryhet me pike të shënuar në fletën e provimit, maksimalja e të cilave janë bërë të dituara në prezantimin e syllabusit. Fleta (teza) e provimit përgatitet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i caktuar për drejtimin e Masterit Ekzekutiv në "Kriminologji. Pedagogu që ka korigjuar provimin pret rreth një javë ndonjë ankim eventual të studentëve për vlerësimin dhe mandej plotëson dhe firmos proceverbalin e vlerësimit të lëndës konkrete. Vlerësimi i studentit sipas procedurave të mësipërme garanton nivel të lartë integriteti, etikë dhe transparencë. *(Evidenca nr.4, Evidenca nr.33).* |
| **Kriteri 3.**Vlerësimi përfundimtar i lëndës përmban vlerësimin e vazhdueshëm në të cilin përfshihen komponentët e portofolit të detyrave/projekteve të studentit, etj, si dhe provimet e pjesshme dhe provimin përfundimtar. | Vlerësimi përfundimtar i lëndës plotësohet me element të tjerë të përcaktuara në syllabusin e lëndës/modulit e të bëra të ditura për studetë që në fillim të prezantimit të tij. Ato përbëhen nga vlerësimi vazhdues, detyra a projekte, punë laboratori, provim i pjesshëm etj. Dhe provimi përfundmtar.<br>*(Evidenca nr.33 "Dosja e plotë didaktike").*<br>*(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 4.**Vlerësimi i njohurive, dijeve shkencore dhe aftësive profesionale, shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i studentëve nga stafi akademik bëhet per çdo component të përcaktuar në syllabus duke mbajtur shënime. Ky vlerësim bëhet në vazhdimësi duke njoftuar në mënyrë individuale çdo student. Sipas rastit i bëhen edhe sqarime me synim përmirësimi dhe rezultate të larta në përvetësimin e dijeve të lëndës/modulit konkret.<br>*(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 5.**Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Në testimin e dijeve të studentëve, njësia përgjegjëse dhe stafi akademik kërkojnë shmangien apo tentativat e mundshme për plagjaturën në detyra, prtojekte apo tema, si dhe çdo formë kopjimi. Për këtë qëllim kërkohet që studentët të angazhohen për individualitet në punimet e tyre, të vendosin dhe citojnë burimet e materialeve të shfrytëzuara qoftë edhe nga internet, shmangja e cel. Gjatë sem. apo detyrave me shkrim, referimi i |

| | |
|---|---|
| | pavarur nga materiali shkruar etj. *(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 6.**Rezultatet e kontrollit të dijeve të dijeve shkencore dhe aftësive profesionale, bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Vlerësimi i dijeve të studentëve bazohet në kriteret e përcaktuara në syllabusin e çdo lënde. Sipas rregullores së PS rezultatet e kontrollit të dijeve shkencore dhe aftësive profesionale studentëve u jepen në kohë, për të shmangur ndonjë paqartësi apo mosdakortësi të mundshme. Nga bisedat e zhvilluara me studentët e PS Master Ekzekutiv në Kriminologji" nuk pati asnjë vrejtje apo pretendim negative në vlerësimin e dijeve të tyre nga stafi akademik. *(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 7.**Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Në bazë të rregullores së PS studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin e dijeve të tyre nga pedagogët dhe sipas rastit të kërkojnë rishikim të tij. Nga studentët na u konfiormua realizimi i një procedure të tillë për njohjen e vlerësimit të tyre, por ata nuk kanë patur ndonjë rast mosdakortësie e rishikim vlerësimi. *(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 8.**Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe nëse studenti mbetet i paqartë, vijohet me procedurën e parashikuar në rregulloren e programit të studimit. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Në bazë të rregullores së PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji" studentët kanë të drejtë të ankohen për verësimin ndaj tij nga pedagogu. Siç u tha më lartë studentët na konfirmuan se nuk kanë patur ndonjë rast të tillë. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, në se do të ketë ndonjë rast në vazhdimësi të këtij PS, në rregulloren e PS është parashikuar që: në qoftë se student ka ankesë, ai bën kerkesën me shkrim ku parashtron arsyet ku e bazon atë dhe ja dorëzon pergjegjësit të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji". Në vijim përgjegjësi në fjalë ngre një komision me tre pedagogë të fushës apo të ngjashëm me lëndën ku është bërë ankesa dhe me shumicën e përbërjes së tij, komisioni merr një vendim vlerësimi, i cili është përfundimtar.<br><br>*(Evidenca nr.4 Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Institucioni ka siguruar vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti;* |

| | |
|---|---|
| | - *Njësia bazë dhe personeli akademik ndjekin me konseguencë shmangjen e plagjaturës së studcentëve në p5rmbushjen e detyrimeve mësimore;*<br>- *-Institucioni u garanton studentëve të drejtën për njohjen me vlerësimin e bërë në përmbushjen e detyrimeve mësimore, duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br><br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive shkencore, të zhvillojë aftësitë profesionale, aftësitë për analizë kritike, vlerësim dhe sintezë të ideve të reja aplikative në fushën specifike të studimit. | PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji", në bazë të strukturës (120 ESTC) , dhe planit mësimor me lëndët/modulet përbërëse, kryesisht të fushës penale, por edhe publike e sociale, garanton thellimin e njohurive shkencore, zhvillimin e aftësive profesionale, aftësi për analizë kritike, sintezë dhe zbatim të ideve novatore në fushën e studimit të krimit dhe programeve e strategjive për parandalimit të kriminalitetit.<br>*(Evidenca nr. 4),*<br>*(Evidenca nr.6.1 "Informacion mbi PS")* |
| **Kriteri 2.**Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta komunikuese, ndërvepruese vendimmarrëse si dhe në fushën e teknologjisë së informacionit. | Në përbërje të PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji", planit mësimor të tij, parashikohen edhe lëndë, si: Etika, korrupsioni, media" dhe "Psikologjia ligjore dhe shëndeti mendor", që garantojnë njohuri specifike në fushën e komunikimit e ndërveprimit për analizën dhe studimin e krimit. Gjithahtu në planin mësimor të PS në fjalë, zhvillohet edhe lënda "Metodat shkencore në hetim", ku teknologjia e informacionit apo inteligjenca kriminalistike, garanton zbulimin e shpejtë të krimeve, rrjedhimisht parandalimin e kriminalitetit. *(Evidenca nr.6.1).* |
| **Kriteri 3.**Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të | Në syllabuset e çdo lënde/moduli përcaktohen qartë objektivat dhe kompetencat që synohet të arrijë studenti në përfundim të |

| | |
|---|---|
| paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe provimin përfundimtar i lëndës. | zhvillimit të saj/tij. Gjatë zhvillimit të lëndës pedagogu/stafi akademik, vë në pah, thekson dhe orienton studentët në çështjet më të rëndësishme të saj, për të fituar dije dhe shprehi aplikative e të qëndrueshme.<br>*(Evidenca nr.6.1, Evidenca nr. 6.7 Mbi planin mësimor të studimit Master Ekzekutiv në "Kriminologji";*<br>*(Evidenca nr.33).* |
| **Kriteri 4.**Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash me karakter dhe orientim të theksuar praktik, me qëllim avancimin e mëtejshëm profesional të studentëve dhe iu jep mundësi studentëve, të zhvillojnë njohuritë e marra në laborator dhe në orët praktike. | Mësimdhënia në PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji" realizohet mbi bazë kompetencash me karakter praktik, çka materializohet edhe në raportin teori/praktikë rreth 58/42%. Nëpërmjet zhvillimit të kësaj sasie orësh mësimore praktike, si: në projekte, laborator, sdtudime, tema etj, studentëve u jepet mundësia për të arrritur nivel të lartë profesional në fushën e studimit të krimit, zbulimit të tij dhe parandalimit të kriminalitetit. *(Evidenca nr.9 Strategjia e zhvillimit të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 5.**Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore - shkencore dhe aplikative dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar mobilitetin e studentëve si dhe krijuar oportunitete te reja për | Në PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji" stafi akademik, në veçanti në disa lëndë që janë me karakter më paraktik, si: Viktiminologjia, Krimi i organizuar dhe trafiqet, Politika penale në kriminologji etj., e realizon mësimin/ seminaret në diskutim të rasteve praktike apo të simuluara, duke krijuar një klimë ku student të shprehin mendimet e tyre për këto raste të orientuar nga njohuritë teorike të paraprira në këto lëndë. Ndërkaq studentët mbështetet në zhvillimin e orëve mësimore praktike, në vçanti në përgatitjen e temës së diplomës për çëshje shqetësuese të kriminalitetit, si: dhuna në familje, korrupsioni në administratën publike etj, çka krijon oportunitete për punësim apo karrierën e tyre profesionale.<br>*(Evidenca nr.6.1; Evidenca nr.6.7 Tabela 6 Mbi planin mësimor të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji"; Evidenca nr.33).* |

| | |
|---|---|
| punësimin dhe karrierën e tyre profesionale. | |
| **Kriteri 6.**Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, në kuadër të veprimtarive ekstra kurrikulare të lidhura me programin e studimit. | Personeli akaademik i brendshëm dhe i jashtëm ka realizuar orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të shkencës dhe teknologjisë, në kuadër të veprimtarive ekstrakurikulare të lidhura me PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji", siç është seminari me temë: "Krimi i organizuar, pastrami i parave dhe siguria kombëtare", si dhe "Krimi i organizuar dhe roli i inteligjencës artificiale", të mbështetuara nga OSBE-ja, ku kanë marrë pjesë edhe studentët e këtij masteri.<br>*(Evidenca nr.16 Informacion për rrritjen e kapaciteteteve të stafit akademik të PS Master Ekzekutiv në " Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.18 Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara në kuadër të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 7.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Fakulteti i Drejtësisë dhe njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji" nxisin zhvillimin e ideve inovative e studime kërkimore tek studentët, siç është rasti i referimit të një kumtese në Koferencën Shkencore Kombëatare: Krimet financiare, pastrami i parave dhe siguria kombëatare" mbajtur në shkurt 2021. Deri tani nuk ka patur financim për studentët për studime e kërkime shkencore, çka mbetet si rekomandim për t'u realizuar në vazhdim të këtij masteri. |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Programi i studimit Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji", garanton rritjen e aftësive krijuese e profesionale të studentëve në fushën e studimit dhe parandalaimit të kriminalitetit;*<br>- *Mësimdhënia në PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji" realizohet mbi bazë kompetencash me karakter praktik, çka materializohet edhe në raportin teori/praktikë;*<br>- *PS Master Ekzekutiv në Kriminologji nxit zhvillimin e ideve inovatore e studime shkencore tek studentët me synime thellimin e kompetencave profesionale e shkencore në fushën e studimit dhe parandalimit të kriminalitetit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **[illegible] përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br><br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni harton procedurë të posaçme për për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. | Procedura për realizimin e detyrimeve përmbyllëse përcaktoehet në Rregullore e PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji", pika 13 (detyrimet përmbyllëse të temës). Gjithashtu njësia përgjegjëse ka hartuar rregulloren për temë-diplomat e ciklit të tretë të studimeve.<br><br>Në rregulloren e PS në fjalë janë përcaktuar detaje dhe procedura për përgatitjen dhe dorëzimin e temës së Diplomës. Kështu, tema duhet të ketë në sasi rreth 40 mijë fjalë dhe dorëzohet dy javë para shqyrtimit nga komisioni. Komisioni i përbërë nga tre anëtarë të stafit akademik, dhe rregullat e punimit e dorëzimit të temës së diplomës vendosn nga komiteti shkencor i zgjedhur nga Departamenti i së Drejtës Penale & Publike. Komisioni vlerësues i temës së diplomës respekton etikën e kërkimit shkencor dhe plagjaturës. Tema e vlerësuar, me reflektimin e vrejtjeve eventuale të komisioni, ruhet në bibliotekën e Fakultetit të Drejtësisë.<br><br>*(Evidenca nr.4.1 "Mbi procedurën e miratimit të rregullores së PS Master Ekzekutiv në Kriminologji";*<br><br>*(Evidenca nr. 5 Rregullorja për diplomat e ciklit të tretë master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 2.**Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme, në funksion të realizimit të detyrimeve përmbyllëse. | Në bazë të rregullores së PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologji", përgjegjësi për mbikqyrjen e tij pajis studentët me formularin e temave dhe listen e pedagogëve udhëheqës. Në vijim, me zgjedhjen dhe miratimin e temës dhe pedagogut udhëheqës, vazhdon puna për përgatitjen e punimit – temës së diplomës. *(Evidenca nr.4.1; Evidenca nr.5).* |
| **Kriteri 3.**Udhëheqësi i punimit të diplomës asiston studentin në orientimin | Mënyra dhe përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor për realizimin e punimit të diplomës nga studentët është parashikuar në Rregulloren për këtë çështje. Pedagogët e këtij |

| | |
|---|---|
| metodologjik, në respektimin e kritereve të shkrimit akademik, ruajtjen e integritetit etik në kërkim, sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo, nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | masteri kishin nga një ose dy student në udhëheqje. Ata kryejnë seminare e bashkëbisedim me studentin që udhëheqin mbi metodologjinë, kriteret e shkrimit akademik, strukturën e temës, literaturën që do të shfrytëzohet e gërshetuar me studime, analiza të rasteve praktike të studimit dhe parandalimit të kriminalitetit. Kujdes i veçantë i kushtohet shmangjes së plagjaturës. Në UT, FD nuk ka një databez për verifikimin e plagjaturës evendtuale në një punim teme diploma, çka ngelet si detyrë për ta patur. Megjithatë verifikimi actual i origjinalitetit të punimit temë diplomë realizohet nëpërmjet deklarimit jo vetëm formal të studentit, por edhe ndjekjes dhe verifikimit pjesë pjesë të punimit nga pedagogu udhëheqës i temës, duke mbajtur edhe përgjegjësinë para komisionit që do ta vlerësojë. Temat e diplomave zgjidhen nga studentët nga temat e rekomanduara dhe të miratuar nga komiteti shkencoir i ngritur për këtë qëllim. FD, njësia bazë ka kapacitete akademike, ndaj pedagogët udhëheqës të temave janë të kategortisë 'Profesor" dhe "Prof. i asociuar". *(Evidenca nr.4.1; Evidenca nr.5).* |
| **Kriteri 4.**Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij, në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Në strukturën dhe planin mësimor të PS Masetr Ekzekutiv në "Kriminologj, përveç orëve të praktikës mësimore të parashikuara në lëndë/module të ndryshme, zhvillohet edhe lënda praktikë profesionale me 10 ECTS, e cila asistohet nga pegagogët gjatë zhvillimit të saj.<br>*(Evidenca nr.9; Evidenca nr.23 Informacion mbi zhvillimin e praktikave mësimore për PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji").* |
| **Kriteri 5.**Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studenti në përfundim të studimeve dhe mbrojtjes së diplomës do të pajiset me diplomë dhe suplementin e saj, të miratuara me Udhëzimin nr.11, dt.02.04.2020 të MASR dhe Vendimit të senatit akademik të UT nr.28, dt21.10.2020, "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës".<br>*(Evidenca nr.10.2 Vendim nr.51, dt.24.10.2019 Për miratimin e forms së diplomës për PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji");*<br>*(Evidenca nr.10.3 Vendim i Senatit Akademik nr.28, dt.21.10.2020 "Për miratimin e përmbajtjes dhe forms së suplementit të diplomës")* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.**Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi, kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin, nëse kërkohen. | Në institucion evidentohen dokumentacioni i studentit të PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" sipas legjislacionit në fuqi. Ai është në dispozicion të studentit nëse kërkohet prej tij. Ruajtja e këtij dokumentacioni sipas rregullave arkivore është detyrë e FD dhe njësisë bazë përgjegjëse e zhvillimit të masterit në fjalë, me qëllim vënien në dispozicion studentëve kur ata e kërkojnë, por edhe pë vlera historike e shkencore të vetë institucionit. |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *IAL,, FD-UT, ka ndjekur një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master Ekzekutiv në "Kriminologji";*<br>- *-IAL, FDUT ka hartuar e miratuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që shoqëron PS Master Ekzekutiv në Kriminologji sipas dispozitave të përcaktuara nga MASR;*<br>- *Institucioni vë në dispozicion të studentëve të gjithë dokumentacionin për detyrimet dhe të drejtat në liodhje me master Ekzekutiv në "Kriminlogji";.*<br>- *- Praktika domumentare e PS Master Ekzekutiv në "Kriminologji" ruhet në ambjentet e Institucionit dhe ajo është e disponueshme në çdo kohë nga studentë apo nga studjues.* |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1** |
|---|

| Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit dhe ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit dhe i bën ato publike. | Në aktet e brendshëm të UT janë parashikuar kushtet, kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur lidhur me rekrutimin e personelit akademik në përputhje me parashikimet e nenit 64 të ligjit Nr. 80/2015. Në këtë drejtim, UT ka hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të funksionimit të tij, procedura dhe kritere të posaçme për rekrutimin e personelit (*Evidenca 1, neni 67; Evidenca 30*).<br><br>Përgjegjës për koordinimin dhe sigurimin e procedurës së rekrutimit të personelit akademik është sektori i burimeve njerëzore, i cili pas përfundimit të procedurës së brendshme, shpall njoftimin për vendin e lirë të punës për të interesuarit nëpërmjet shpalljes (në buletinin e APP) (*Evidenca 1, neni 67; Evidenca 30*) si dhe nëpërmjet njoftimit në faqen elektronike të institucionit: (https://unitir.edu.al/category/njoftim-per-vend-te-lire-pune/), faqe e cila u konsultua nga GVJ. |
| **Kriteri 2.**Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Institucioni ka përcaktuar në mënyrë të qartë hapat që ndiqen në procesin e rekrutimit të stafit akademik, përmes procedurave transparente. Procesi i rekrutimit fillon nga përcaktimi i nevojave që ka njësia bazë, të cilat më pas i përcillen për miratim rektorit. Kriteret e përgjithshëm të punësimit të personelit janë të përcaktuar në aktet e brendshme të institucionit (*Evidenca 1, neni 67*). Nga ana tjetër, njësia bazë përcakton kritere të veçanta shtesë për vendet e punës, mbështetur mbi kategorinë e personit që kërkohet të punësohet, të cilat miratohen nga rektori. Kriteret e punësimit i përcillen rektorit nga drejtuesi i njësisë kryesore. Nëpërmjet drejtuesit, njësia kryesore, bën shpalljen në faqet zyrtare të internetit si dhe në buletinin e APP. Të interesuarit dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në sektorin e burimeve njerëzore. Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komisionin *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve fitues.Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, që nuk duhet të kenë konflikt interesi dhe që i përkasin kategorisë "Profesor". Ky komision, brenda afateve të caktuar në statut, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpanjëshme që janë, |

| | |
|---|---|
| | vlerësimi i dosjes dhe intervista. Intervistës i nënshtrohen vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve. Në vijim të procedurës, komisioni shpall kandidatin apo kandidatët fitues. Përparësi i jepet personelit që zotëron grada shkencore dhe tituj akademikë (*Evidenca 6.5*).<br><br>Mandej, komisioni *ad hoc* i paraqet kandidatin apo kandidatët fitues rektorit të UT-së nëpërmjet drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori, brenda 10 ditëve nga shpallja e kandidatit fitues, nënshkruan kontratën e punës me të, qëështë dhe momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës (*Evidenca 1, neni 67; Evidenca 30, seksioni 1*).<br><br>Në manual është përcaktuar dhe e drejta e ankimit ndaj vendimeve të komisionit *ad hoc*, ankim që shqyrtohet po prej tij. Kjo e drejtë parashikohet vetëm në manualin për punësimin, por nuk gjen rregullim në statutin e IAL (*Evidenca 30*). Gjatë vizitës në institucion u konfirmua se nuk ka pasur asnjë rast ankimi gjatë proceseve të rekrutimit të personelit në FDUT (*Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"*).<br><br>Marrëdhënia formalizohet përmes kontratës së punës (*Evidenca 1, neni 67/8*).<br><br>Sa i përket personelit akademik me kohë të pjesshme, njësia kryesore, sipas nevojave të propozuara nga njësia bazë, i kërkon rektorit miratimin e personelit akademik me kohë të pjesshme. Kriteret e rekrutimit për këtë kategori të personelit janë të përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore (*Evidenca 1, neni 68*). Njoftimet për angazhim të personelit akademik me kohë të pjesshme bëhen publike në faqen zyrtare të fakultetit: https://fdut.edu.al/2022/09/14/kritereve-per-personel-akademik-me-kohe-te-pjesshme/.<br><br>Rregulla të posaçme gjenden në manualin e punësimit dhe për personelin ndihmës-akademik dhe administrativ (*Evidenca 30, seksionet 2, 3 dhe 5*). |
| **Kriteri 3.**Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e | Institucioni është angazhuar në aktet e brendshme të tij për mbështetjen dhe aftësimin e personelit akademik (*Evidenca 1, neni 64; Evidenca 2, pika 5*).<br><br>Në mënyrë të detajuar, parimet që lidhen me personelin parashikohen dhe në Kodin e Etikës, të miratuar nga institucioni (https://unitir.edu.al/kodi-i-etikes-i-universitetit-te-tiranes/). |

| | |
|---|---|
| detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Konstatohet se ky Kod është bazuar në ligjin e shfuqizuar Nr. 9741, datë 21.5.2007, arsye për të cilën ***GVJ gjen me vend të sugjerojë për institucionin që të marrë masat për të miratuar Kodin e ri të Etikës, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi në fushën e arsimit të lartë.***<br><br>GVJ ka konstatuar gjatë vizitës në institucion se godina ku realizohet mësimdhënia teorike për këtë program studimi, ka klasa të pajisura me mjetet e duhura audio-vizive, salla të përshtatshme konferencash, të cilat lehtësojnë punën e personelit akademik.<br><br>Mjediset në dispozicion të stafit drejtues,për veprimtarinë kërkimore e shkencore, janë të përshtatshëm, po ashtu dhe mjediset për personelin akademik, për personelin administrativ si dhe për sekretarinë mësimore, me sipërfaqet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së secilit (*Evidenca 26*).<br><br>Ambientet kanë shërbim interneti *wireless*, të hapur për përdorim nga studentët dhe personeli akademik e administrativ i institucionit. Në mbështetje të stafit dhe studentëve funksionojnë shërbimi i fotokopjeve, printimit, etj., elemente të cilët u verifikuan gjatë vizitës së realizuar në institucion (*Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 4.**Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | UT, në vijimësi ka siguruar mundësitë për nxitjen profesionale të personelit, gjë e cila shprehet në akte të tjera formale ku vihet theksi në krijimin e mundësive për të zhvilluar aftësitë e personelit akademik dhe administrativ dhe fuqizimin e kërkimit shkencor (*Evidenca 1, nenet 8 dhe 64/3*).<br><br>Konkretisht, institucioni mundëson kërkimin shkencor të personelit nëpërmjet financimit, krijimit të mundësive për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, mobilitetin, etj. (*Evidenca 2, pikat 3 dhe 5*). Për nxitjen e stafit akademik në këtë drejtim është parashikuar një buxhet për pjesëmarrje në konferenca dhe botime (*Evidenca 1, neni 120*) si dhe janë përcaktuar procedurat përkatëse për të përfituar nga granti i parashikuar për këtë qëllim me vendimin Nr. 28, datë 22.7.2021 të Senatit Akademik të UT-së (https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/vendimi-nr28-1.pdf)<br><br>Gjatë vizitës në institucion u konfirmua ky fakt, ku u pohua nga stafi akademik se në respektim të udhëzimeve të MAS si dhe në |

| | |
|---|---|
| | vijim të vendimarrjes së Bordit të Administrimit, institucioni ka mundësuar në praktikë mbështetjen financiare për pjesëmarrje në veprimtari kërkimore dhe shkencore, brenda dhe jashtë vendit (*Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"; Evidenca shtesë "Grant për konferenca ndërkombëtare"*).<br><br>Nga aktet vërehet se UT zbaton programin e miratuar prej tij "UT-kërkim, ekselencë dhe inovacion", i cili ka nisur në vitin 2021, dhe që synon dhënien e informacioneve të nevojshëm për paraqitjen e propozimeve dhe dorëzimin e aplikimeve nga stafi akademik, në funksion të kualifikimit akademik (marrja e gradave dhe titjve), rritjes profesionale si dhe shtimit të veprimtarisë kërkimore (*Evidenca 32*).<br><br>Në funksion të kualifikimit në vijimësi të personelit, vlen sidomos Projekti i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri "Për krijimin e Masterit në Kriminologji" (2018-2023), i cili i kushton një vëmendje të rëndësishme komponentit të ngritjes së kapacitetit të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Komponenti Nr. 2 i projektit "Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënies dhe punës kërkimore, dhe burimeve të nevojshme për funksionimin e programit Master në Kriminologji, përbëhet nga disa aktivitete në këtë fushë, të tilla si:<br><br>▪ Trajnime të stafit akademik të Masterit në Kriminologji;<br>▪ Vizita studimore për stafin akademik dhe pjesëmarrje në konferenca/aktivitete;<br>▪ Mbështetje me literaturën e nevojshme për programin master, ku përfshihen blerje të disa librave dhe mundësimi i aksesit në disa biblioteka *online* dhe revista *online* në Kriminologji.<br><br>Po ashtu, në datat 28 - 29 Maj 2020, Prezenca, në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë në UT, kanë organizuar një seminar me stafin akademik të Programit të Masterit në Kriminologji, i cili kishte synim të përmirësonte aftësitë kërkimore të profesionistëve, akademikëve dhe politikëbërësve për të identifikuar shkaqet thelbësore të krimit. Seminari është zhvilluar nga Prof. Kimberly McCabe, eksperte ndërkombëtare e kriminologjisë, nga Universiteti i Lynchburg, Virxhinia, SHBA. |

| | |
|---|---|
| | Në datat 22 – 25 shtator 2020, si pjesë e projektit u organizua një sesion trajnimi në Tiranë për stafin akademik të Masterit. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 35 lektorë dhe asistent-lektorë nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, i cili u zhvillua nga dy ekspertë ndërkombëtarë akademikë në fushën e kriminologjisë, prof. Kimberly McCabe dhe prof. Keith Smith, nga Universiteti i Lynchburg, Virxhinia, SHBA. Trajnimi kishte për qëllim thellimin e njohurive të personelit akademik të programit dhe i ka ofruar stafit akademik një tablo më të hollësishme të lëndëve të posaçme që lidhen me kriminologjinë.<br><br>Në muajin Korrik 2022 është planifikuar një vizitë studimore e disa lektorëve dhe asistent-lektorëve të këtij programi në Universitetin LUISS në Romë. Një program akademik është planifikuar për t'u zhvilluar në datat 11-15 korrik 2022. Gjithashtu, gjatë programit, është planifikuar një takim ndërmjet stafit akademik të Fakultetit të Drejtësisë/Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë LUISS lidhur me ngritjen e një Qendre Kërkimore, qendër e cila është planifikuar të ngrihet gjatë dy viteve të ardhshme në Fakultetin e Drejtësisë, UT, si pjesë e projektit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (*Evidenca 16; Evidenca 17; Evidenca 18*).<br><br>Me rëndësi në këtë drejtim është dhe aktiviteti i zhvilluar në datat 2, 7 Mars 2022, 14 Prill 2022 dhe 12 Maj 2022, në formën e *webinar*-it të organizuar nga Luiss School of Law – University of Tirana – OSCE Presence in Albania, me temë "*Executive Course on 'Corruption, Organized Crime and Artificial Intelligence: The New Frontiers of the Criminal Justice*" (*Evidenca 35*).<br><br>Në funksion të kualifikimit në vijimësi të personelit janë dhe marrëveshjet e lidhura nga UT si dhe programet e mobilitetit, si Erasmus+ (https://unitir.edu.al/kerkimi-shkencor/; https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/). Nga këto marrëveshje dhe programe ka përfituar dhe Fakulteti i Drejtësisë, si pjesë përbërëse e UT (*Evidenca 18; Evidenca 22; Evidenca 22.1; Evidenca shtesë 4*).<br><br>Vlen gjithashtu të përmendet se UT ka marrë logon "HR Excellence in Research", nga Komisioni Evropian, gjë e cila krijon mundësi të mëtejshme për aplikimin në përfitimin e |

| | |
|---|---|
| | granteve si dhe mundëson zhvillimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor (https://unitir.edu.al/universiteti-i-tiranes-mbajtes-i-logos-hr-excellence-in-research/).<br><br>Nga aktet vërehet se Fakulteti i Drejtësisë, UT, nxit po ashtu pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari të tilla si konferenca, projekte, seminare, etj. (*Evidenca 1, neni 114/4; Evidenca 3*). Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga Covid-19, veprimtaritë e këtij lloji janë zhvilluar edhe nëpërmjet platformave online (*Evidenca 42, pika 3.4*), kurse disa aktivitete janë anuluar apo shtyrë në dy vitet në vijim (*Evidenca 16, f. 2*). |
| **Kriteri 5.**Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet që UT ka marrë masa në vijimësi për të siguruar trajnimin dhe kualifikimin e personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor. Trajnimet dhe programet janë në harmoni me objektivat që ka marrë përsipër institucioni (*Evidenca 2, pika 1;Evidenca 3; Evidenca 4*) dhe janë realizuar me trajnues vendas dhe të huaj (*Evidenca 17;Evidenca 42, pika 1; Evidenca 22.1; Evidenca 18*).<br><br>UT po zbaton dhe programin "UT-kërkim, ekselencë dhe inovacion", që siguron përkrahje të mëtejshme për arritjen e synimeve përkatëse në fushën e përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies dhe të teknologjive të reja. Objektivat e këtij programi janë:<br><br>a) Të mbështesë personelin akademik me kohë të plotë në fushat specifike të kërkimit për gjenerimin e të dhënave shkencore të besueshme dhe konkurruese në treg, të cilat do të shërbejnë si bazë për aplikime të mëtejshme edhe në aplikimet ndërkombëtare;<br><br>b) Të mbështesë personelin akademik me kohë të plotë për zhvillimin e projekteve të tyre kërkimore dhe krijimin e kushteve për përparimin në karrierë;<br><br>c) Të mbështesë Njësinë Kryesore dhe Njësinë Bazë për zgjerimin e fushës së tyre të kërkimit dhe inovacionit si dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me strategjinë e kërkimit shkencor të UT-së, dhe nevojave të tregut, si dhe për të përcaktuar realizueshmërinë e projektit me qëllim sigurimin e të |

| | |
|---|---|
| | dhënave paraprake për të mbështetur aplikimet për financime jashtë universitetit;<br><br>ç) Të mbështesë me fonde kërkimet strategjike të cilat përmbushin nevojat dhe prioritetet e UT-së (https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/June2022_THIRRJE-P%C3%8BR-PROJEKTE-PROGRAMI-UT-K%C3%8BRKIM-EKSELENC%C3%8B-DHE-INOVACION-1.pdf).<br><br>Në këtë program mund të aplikohet nga stafi akademik, gjë e cila konstatohet nga thirrjet e bëra në faqen online të universitetit (https://unitir.edu.al/thirrje-per-projekte-ne-programin-ut-kerkim-ekselence-dhe-inovacion-2/).<br><br>Gjithashtu, në funksion të këtij kriteri, paraqitet dhe aktiviteti i Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në UT, e cila ka kryer disa trajnime online për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrative të UT-së (https://unitir.edu.al/category/qendra-virtuale/).<br><br>Marrëveshjet me IAL të huaja në këtë drejtim përfundohen nga ana e UT-së, por duhet theksuar se në këtë drejtim, nga Fakulteti i Drejtësisëështë bashkëpunuar ngushtësisht me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për krijimin e këtij programi studimi dhe mbështetjen e tij në të gjithë fushat e nevojshme si mësimdhënie, kërkim shkencor, etj. (*Evidenca 16*).<br><br>Vlen të përmendet se departamentet përgjegjës për realizimin e këtij programi studimi, mund të ftojnë edhe profesorë nga universitetet jashtë vendit si pedagogë vizitorë në përputhje me marrëveshjet e mobilitetit, të lidhura me universitete perëndimore (*Evidenca 4, pika 8.3*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>- *Institucioni bën transparente procedurat për rekrutimin e stafit akademik dhe kërkuesve shkencorë. Procesi iniciohet nga njësia bazë, e cila është përgjegjëse për evidentimin e nevojave për staf akademik.*<br>- *Institucioni është angazhuar në aktet e brendshme të tij për mbështetjen dhe aftësimin e personelit akademik.*<br>- *Mjediset në dispozicion të stafit drejtues,për veprimtarinë kërkimore e shkencore, janë të përshtatshëm, po ashtu dhe mjediset për personelin akademik, për personelin* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *administrativ si dhe për sekretarinë mësimore, me sipërfaqet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së secilit.*<br>- *Institucioni mundëson kërkimin shkencor të personelit nëpërmjet financimit, krijimit të mundësive për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, mobilitetin, etj.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, është i kategorisë "Profesor". | Programi ofrohet nga Departamenti i së Drejtës Penale dhe i së Drejtës Publike, njësi bazë të Fakultetit të Drejtësisë i cili, në përputhje me kërkesat e nenit 23 të ligjit Nr. 80/2015, përbëhet tre departamente:<br>**1.** Departamenti i së Drejtës Civile;<br>**2.** Departamenti i së Drejtës Penale;<br>**3.** Departamenti i së Drejtës Publike;<br><br>Realizimi i këtij programi mbështetet edhe nga Fakulteti i Shkencave Sociale i UT (*Evidenca 1, neni 11/2, pika IV, neni 12; Evidenca 6.1, pika 3; Evidenca 6.3*).<br><br>GVJ zhvilloi një takim me dekanen e Fakultetit të Drejtësisë dhe përgjegjësen e departamentit të së drejtës penale. Në bazë të informacionit mbi stafin akademik rezulton se dekani i Fakultetit është me titullin "Prof. As.", pra në përmbushje të kërkesave të nenit 42/3 të ligjit Nr. 80/2015. Të njëjtin titull mban dhe përgjegjësja e departamentit.<br><br>Personeli akademik i angazhuar në këtë program është i përbërë nga **29 anëtarë gjithsej**, nga të cilët 26 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 3 janë personel akademik me kontratë (PAK) (*Evidenca 6.5*). Kualifikimi i tyre si më poshtë:<br><br>**<u>PAE:</u>** \| **<u>PAK:</u>** |

| | |
|---|---|
| 10 Prof. Dr. | 2 Prof. Dr. |
| 15 Prof. Asoc. | 1 Msc |
| 1 Dr./PhD | |
| **26 PAE** | **3 PAK** |
| **29 totali** | |

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion, personeli akademik përbëhet nga staf i brendshëm i UT, si më poshtë vijon:

- 21 anëtarë të Fakultetit të Drejtësisë;
- 6 anëtarë të Fakultetit të Shkencave Sociale;
- 1 anëtar i Akademisë së Sigurisë;
- 1 anëtar i punësuar pranë OSBE.

Sa i përket personelit akademik të Fakultetit të Drejtësisë, i përkasin:

- 12 anëtarë nga departamenti i së drejtës penale (45% e departamentit);
- 9 anëtarë nga departamenti i së drejtës publike (31% e departamentit);

Sa i përket personelit akademik të Fakultetit të Shkencave Sociale, i përkasin:

- 5 anëtarë nga departamenti i Sociologjisë (17% e anëtarëve të departamentit);
- 1 anëtar nga departamenti i Psikologjisë (3,5% e anëtarëve të departamentit).

Nga të dhënat që disponojmë rezulton se ngarkesa mësimore mbulohet në masën **90% PAE dhe 10% PAK**.

Siç është evidentuar më sipër, për të përmbushur objektivat e programit të studimit, Departamenti ka angazhuar personel akademik të kualifikuar në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit. Në këtë mënyrë e në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore në fushën e arsimit të lartë, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kategorisë "Profesor",me përjashtim të dy prej tyre. Gjithsesi, kjo vjen në pajtim me pikën 8.2 të rregullores së programit të studimit, ku përcaktohet se, për lëndët specifike, kategoria e personelit "profesor" mund të kombinohet me specialistë të

| | |
|---|---|
| | fushës me përvojë profesionale në fushën e kriminologjisë, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i lartë se 30% e personelit akademik (*Evidenca 4, pika 8*). |
| **Kriteri 2.**Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me fushën e programit të studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Rezulton që, në përputhje me lëndët e përfshira në program, fusha akademike-kërkimore e secilit prej anëtarëve të personelit akademik, përputhet me fushën e këtij programi.<br><br>Konkretisht, 12 anëtarët e departamentit të së drejtës penale të Fakultetit, janë caktuar për lëndët:<br>▪ Procedurë penale – 4 anëtarë;<br>▪ Kriminologji-Penologji – 2 anëtarë;<br>▪ Drejtësia Penale për të Miturit – 1 anëtar;<br>▪ E drejtë penale evropiane – 1 anëtar.<br><br>9 anëtarë të tjerë i përkasin departamentit të së drejtës publike.<br>▪ Kriminalistikë – 1 anëtar nga Akademia e Sigurisë dhe Hetimit.<br><br>Nga Fakulteti i Shkencave Sociale, janë angazhuar 5 anëtarë të departamentit të Sociologjisë dhe 1 anëtar nga departamenti i Psikologjisë. 1 anëtar në proces doktorature, vjen nga OSBE (*Evidenca 6.5; Evidenca 6.6*).<br><br>Ky angazhim është bërë duke pasur parasysh strukturën e programit mësimor të ndarë në dy grupe lëndësh, ato të detyrueshme që synojnë arritjen e njohurive të thelluara në fushën e kriminologjisë dhe disiplina të përafërta si dhe grupin e lëndëve me zgjedhje, që synojnë dhënien e njohurive të thelluara plotësuese në fushat e përafërta me kriminologjinë (*Evidenca 4, pika 9.1*).<br><br>Lëndët e përcaktuara në program kanë të bëjnë me teoritë kriminologjike, sistemet juridike bashkëkohore të drejtësisë penale, sistemet juridike bashkëkohore të drejtësisë penale, viktimologjinë, etikën, korrupsionin, median, psikologjinë ligjore dhe shëndetin mendor, organizimin e institucioneve të drejtësisë penale, gjininë dhe krimit, lëndë të cilat mbulohen plotësisht nga personeli akademik i angazhuar e në përputhje me profilizimin e secilit prej tyre (*Evidenca 6.1; Evidenca 6.7*).<br><br>Programi i studimit Master Ekzekutiv në Kriminologji është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të departamenteve të së drejtës penale dhe publike, me ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet |

| | |
|---|---|
| | nënligjore në zbatim të tij, me aktet e tjera rregullatore të Institucionit, si dhe në përputhje me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, Standartet dhe Parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. |
| **Kriteri 3.**Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Institucioni tregon si në pikëpamje formale, ashtu dhe në atë të zbatueshmërisë, se angazhohet në të gjithë drejtimet për të siguruar përmbushjen e plotë të detyrave nga burimet njerëzore që disponon, me qëllim arritjen e objektivave në kuadër të programit të ciklit të tretë të studimeve. Detyrat e secilit anëtar, sipas stafeve përkatës, janë të mirëpërcaktuar në aktet e universitetit, në përputhje me misionin dhe objektivat që ky i fundit synon të realizojë (*Evidenca 1;Evidenca 4: Evidenca 6.1*). Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare/ushtrime dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në kredite (në %) për veprimtaritë formuese është në pajtim me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*", i ndryshuar. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në këtë program (*Evidenca 6.4; Evidenca 6.5; Evidenca 6.6; Evidenca 6.7*).<br><br>Rezulton nga aktet se personeli akademik ka një ngarkesë prej 1080 orë mësimore në këtë program, ku:<br>▪ 888 orë mësimore zhvillohen nga personeli akademik i Fakultetit të Drejtësisë – 82,5%;<br>▪ 186 orë mësimore zhvillohen nga personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Sociale – 17%;<br>▪ 6 orë mësimore zhvillohen nga personeli akademik i jashtëm (OSBE) – 0,5%.<br><br>Nga kjo ngarkesë e përgjithshme prej 1080 orë:<br>▪ 944 orë mësimore zhvillohen nga personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar – 87,5%;<br>▪ 136 orë mësimore zhvillohen nga personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar – 12,5%.<br><br>Personeli akademik i Fakultetit të Drejtësisë ka këtë ngarkesë:<br>▪ 570 orë mësimore personel nga departamenti i së drejtës penale – 53%; |

| | |
|---|---|
| | ▪ 318 orë mësimore personel nga departamenti i së drejtës publike – 29,5%.<br>Nga ky personel:<br>▪ 440 orë mësimore mbulohen nga personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar – 88%;<br>▪ 130 orë mësimore mbulohen nga personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar – 2% (*Evidenca 6.1; Evidenca 6.5; Evidenca 6.6; Evidenca 6.7*).<br>Ndarja në kategori e veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre, bëjnë të mundur arritjen e objektivave të programit. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe iu krijon mundësi punësimi studentëve në përputhje me këtë fushë studimi, në sektorin publik dhe privat (*Evidenca 4; Evidenca 6.1*). |
| **Kriteri 4.**Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Në këtë program studimi janë angazhuar 28 anëtarë personeli akademik PAE nga Fakulteti i Drejtësisë dhe ai i Shkencave Sociale. Pra, në mbulimin e lëndëve të programit, pjesa më e madhe e lëndëve realizohet ngapersonel akademik i brendshëm, gjë që siguron dhe garanton qëndrueshmërinë dhe kualifikimin e personelit akademik të brendshëm për të gjithë periudhën e akreditimit (*Evidenca 6.6*). Me secilin anëtar të personelit akademik janë lidhur kontratat përkatëse të punësimit si dhe rezultojnë të mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, gjë që u konfirmua gjatë vizitës në institucion, në zyrën e burimeve njerëzore (*Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 5.**Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës | Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë 2 anëtarë të personelit ndihmës akademik dhe 2 anëtarë të personelit administrativ, të angazhuar në këtë program studimi, që mundësojnë realizimin e planit mësimor dhe mbështetje për mjediset mësimore. Për qëllime të asistencës në lidhje me burime informacioni, përdorimi i sistemit *online* të bibliotekës, etj., mund të thuhet se gjatë vizitës së GVJ, angazhimi nga ana e personelit të bibliotekës dhe stafit administrativ të institucionit, ishte i dukshëm (*Evidenca 24; Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"*). |

| | |
|---|---|
| specifike të programit të studimit. | |
| **Kriteri 6.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Institucioni ka përcaktuar në mënyrë të qartë hapat që ndiqen në procesin e rekrutimit të stafit akademik, përmes procedurave transparente. Procesi i rekrutimit fillon nga përcaktimi i nevojave që ka njësia bazë, të cilat më pas i përcillen për miratim rektorit. Kriteret e punësimit i përcillen rektorit nga drejtuesi i njësisë kryesore. Nëpërmjet drejtuesit, njësia kryesore, bën shpalljen në faqet zyrtare të internetit si dhe në buletinin e APP. Të interesuarit dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në sektorin e burimeve njerëzore; vlerësimi paraprak i kandidatëve që përmbushin kriteret, kryhet nga komisioni *ad hoc*, i ngritur për këtë qëllim. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, që nuk duhet të kenë konflikt interesi dhe që i përkasin kategorisë "Profesor". Komisioni bën shpalljen e fituesit apo fituesve dhe ia paraqet rektorit, i cili përfundon procedurën e nisur (*Evidenca 1, neni 67; Evidenca 30, seksioni 1*).<br><br>Marrëdhënia formalizohet përmes kontratës së punës (*Evidenca 1, neni 67/8*).<br><br>Sa i përket personelit akademik me kohë të pjesshme, njësia kryesore, sipas nevojave të propozuara nga njësia bazë, i kërkon rektorit miratimin e personelit akademik me kohë të pjesshme. Kriteret e rekrutimit për këtë kategori të personelit janë të përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore (*Evidenca 1, neni 68*). Rregulla të posaçme gjenden në manualin e punësimit dhe për personelin ndihmës-akademik dhe administrativ (*Evidenca 30, seksionet 2, 3 dhe 5*). |
| **Kriteri 7.** IAL harton si rregull marrëveshje bashkëpunimi me institucionet/organizatat e punësimit të studentëve të cilat i mundësojnë atyre realizimin e orëve praktike të moduleve. | Në rregulloren mësimore të këtij programi studimi është përcaktuar se praktikat mësimore dhe stazhet zhvillohen pranë institucioneve që kryejnë veprimtari në fushën e kriminologjisë si Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Autoriteti për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Njësitë për mbrojtjen e të miturve në bashki, gjykatat, prokuroria, policia e shtetit, Shërbimi i Provës, institucionet e vuajtjes së dënimit dhe ato të riedukimit si dhe çdo instiotucion apo qendër kërkimore shkencore që ofron ekspertizë në fushën e kriminologjisë (*Evidenca 4, pika 2.4*).<br><br>Për arritjen e këtij objektivi, rezulton të jenë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione vendase për qëllime të realizimit të praktikës profesionale. Nga dokumentacioni i |

| | |
|---|---|
| | dorëzuar si dhe nga takimet e GVJ gjatë vizitës në institucion, institucioni ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione qendrore, ente, agjenci, etj., që parashikojnë kryerjen e praktikave profesionale në fushën e kriminologjisë *(Evidenca 22; Evidenca)*.<br><br>Gjatë vizitës në institucion u evidentua ndër të tjera vendosja e bashkëpunimit me Entin Rregullator të Energjisë, që synon realizimin e *workshop*-eve, praktikat mësimore dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, me fokus kryesor "Kriminologjinë e gjelbër", lëndë e përfshirë në kurrikulën e këtij programi (*Evidenca 22; Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"*).<br><br>***Në lidhje me këto marrëveshje, GVJ sugjeron lidhjen e marrëveshjeve me institucione të tillë si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Spitale Psikiatrike si dhe institucione të tjerë, ku mund të realizohen praktika në lidhje me probleme të caktuara e specifike kriminologjike, në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.*** |
| **Kriteri 8.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në orët praktike të moduleve, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Sipas dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë gjatë takimeve të GVJ, realizimi i praktikave organizohet, mbikëqyret dhe menaxhohet nga departamenti, nëpërmjet pedagogëve të ngarkuar me ndjekjen e praktikës së grupit përkatës të studentëve deri në realizimin e vlerësimit përfundimtar të studentit. Praktika zhvillohet në institucionet e caktuara nga departamentet përkatëse dhe vlerësohet me notë. Praktika profesionale ka 10 ECTS (*Evidenca 4, pika 12.24*).<br><br>Në funksion te plotësimit të këtij kriteri, në këtë program është përfshirë dhe lënda "Praktika profesionale". Në këtë lëndë, pedagogët e saj bashkëpunojnë me Klinikën e Ligjit të FDUT-së, ku një nga metodologjitë ka qenë trajtimi i rasteve të ndryshme në praktikë. Duke qenë se studentët janëpothuajse të gjithë të punësuar dhe vijnë nga eksperienca të ndryshme praktike, u është lënë si detyrë që të prezantojnë, sipas fushës së tyre të punës, një ese me raste praktike; kjo gjithmonë brenda programit të studimit të Masterit Ekzekutiv. Studentët më pas, gjatëprezantimit dhe nën moderimin e dy lektorëve zhvillojnë debate (*Evidenca 23*).<br><br>Gjithashtu, sipas Rregullores së programit studentët që ndjekin këtë program studimi kanë një udhëheqës për punën kërkimore |

| | |
|---|---|
| | dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Punimi i diplomës realizohet nën drejtimin e një pedagogu sipas interesit të shprehur nga ana e studentëve dhe përshtatshmërisë së profilit të tij. Udhëheqësi i tezës ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" dhe duhet të ketë përvojë në mësimdhënie në fushën në të cilën do të kryhet punimi i diplomës. Gjatë takimit të zhvilluar me stafin u konfirmua se, për shkak dhe të numrit të studentëve që pranohen në këtë program, udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë studentë nga norma e caktuar për temat e ofruara në këtë program studimi (*Evidenca 4, pika 13; Evidenca 5; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Në këto akte, konstatohet që institucioni ka miratuar rregulla për mënyrën e përmbushjes së këtij detyrimi nga studentët, procedurat e ndjekura dhe format që duhet të respektohen (*Evidenca 10.2; Evidenca 10.3.1*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>- *Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kategorisë "Profesor",me përjashtim të dy anëtarëve, gjë e cila lejohet nga pika 8.2 e rregullores së programit të studimit, ku përcaktohet se, për lëndët specifike, kategoria e personelit "profesor" mund të kombinohet me specialistë të fushës me përvojë profesionale në fushën e kriminologjisë, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i lartë se 30% e personelit akademik.*<br>- *Në përputhje me lëndët e përfshira në program, fusha akademike-kërkimore e secilit prej anëtarëve të personelit akademik, përputhet me fushën e këtij programi.*<br>- *Institucioni angazhohet në të gjithë drejtimet për të siguruar përmbushjen e plotë të detyrave nga burimet njerëzore që disponon, me qëllim arritjen e objektivave në kuadër të programit të ciklit të tretë të studimeve Master Ekzekutiv në Kriminologji. Detyrat e secilit anëtar, si nga stafi akademik, ashtu dhe ai ndihmës-akademik, janë të përcaktuar saktë në aktet e universitetit, në përputhje me misionin dhe objektivat që ky i fundit synon të realizojë.*<br>- *Stafi akademik efektiv (PAE) mbulon ngarkesën mësimore në auditor, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi në fushën e arsimit të lartë.* |

| | |
|---|---|
| | - *Institucioni ka përcaktuar në mënyrë të qartë hapat që ndiqen në procesin e rekrutimit të personelit, përmes procedurave transparente.*<br>- *Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione vendase për qëllime të realizimit të praktikës profesionale, konkretisht me institucione qendrore, ente, agjenci, etj., që parashikojnë kryerjen e praktikave profesionale në fushën e kriminologjisë.* ***GVJ sugjeron lidhjen e marrëveshjeve me institucione të tillë si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Spitale Psikiatrike si dhe institucione të tjerë, ku mund të realizohen praktika në lidhje me probleme të caktuara e specifike kriminologjike, në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.***<br>- *Realizimi i praktikave organizohet dhe mbikëqyret dhe menaxhohet nga departamenti nëpërmjet pedagogëve të ngarkuar me ndjekjen e praktikës së grupit përkatës të studentëve deri në realizimin e vlerësimit përfundimtar të studentit. Praktika zhvillohet në institucionet e caktuara nga departamentet përkatëse dhe vlerësohet me notë. Praktika profesionale ka 10 ECTS.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me | FDUT disponon infrastrukturën e përshtatshme për plotësimin në mënyrë efektive të programit mësimor dhe funksioneve mbështetëse të tij. Mësimdhënia për programet e studimit Master Ekzekutiv në Kriminologji realizohet në ambientet e godinës së FDUT-së. Vlerësimi është kryer nëambientet në fjalë, ku u zhvillua vizita nga GVJ. GVJ konstatoi një sipërfaqe të mjaftueshmenë funksion të sallave për leksione, etj., në raport me numrin e studentëve, dhe të mjaftueshëm për zyra, sa i përket |

| | |
|---|---|
| natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | stafit. Sipas këtyre të dhënave, universiteti vë në dispozicion 13 auditore që shërbejnë si salla leksioni me kapacitet prej 360 studentë; 12 auditore shërbejnë si salla për seminare me kapacitet prej 167 studentë (*Evidenca 26; Evidenca 6.1, f. 10; Evidenca shtesë 16 "Auditorët e FD"*).<br><br>Në përpjestim me numrin e studentëve të këtij programi, 25 të tillë, sipërfaqet në fjalë janë mëse të mjaftueshme. Sallat janë të pajisura me ndriçim dhe me aksesorët e nevojshëm teknologjikë për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të veprimtarisë për të cilën janë destinuar. Ambientet janë të pajisura me dritare dhe menjë sistem të përshtatshëm ajrimi dhe kondicionimi.<br><br>Fakulteti nuk ka në përdorim sipërfaqe parkimi, nuk siguron sipërfaqe çlodhëse për studentët.<br><br>Nga ana tjetër, siguron mjediset hidrosanitare të nevojshme.<br><br>Nga vizita në institucion u konstatua se institucioni siguron aksesueshmëri, në kuptimin infrastrukturor, për personat me aftësi të kufizuara, edhe pse aktualisht nuk kishte të regjistruar të tillë rishtas apo në vazhdim të studimeve (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 2.**Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Nga vizita në institucion u vërejt se Fakulteti i Drejtësisë zotëron ambientet e duhura për realizimin e programit mësimor të studimeve të ciklit të tretë Master ekzekutiv, ku klasat dhe sallat janë të pajisura me pajisjet përkatëse elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Pajisjet në fjalë, video projektorë, TV, projektorë, kompjutera, pajisje të tjera teknologjike, lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies (*Evidenca 26; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji").*<br><br>Në godinë funksionon normalisht shërbimi i internetit *wireless*, i aksesueshëm nga studentët dhe nga stafi i institucionit, gjë që u konstatua dhe nga GVJ. Rezulton që institucioni ka siguruar e vënë në shfrytëzim pajisjet e duhura e të nevojshme, në funksion të programit të studimeve Master Ekzekutiv në përputhje me rregullimet e bëra në nenin 8/7 të Statutit të tij(*Evidenca 1; Evidenca 6.1, f. 10*). |
| **Kriteri 3.**Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, | Në godinë përfshihen laboratorët, sallat e studimit, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura, etj. Ambientet e zhvillimit |

| | |
|---|---|
| përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | të leksioneve e seminareve janë me hapësira të mjaftueshme dhe mundësojnë qëndrimin lirshëm të studentëve.<br>Gjithashtu, janë të pajisura me pajisje kompjuterike, projektorë, etj., dhe lehtësojnë përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies. Ambientet konsiderohen të përshtatshëm për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për aktivitete të tjera të ngjashme (*Evidenca 26*). |
| **Kriteri 4.**Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Në përputhje me programin e studimit, IAL nuk ka parashikuarlaboratorë informatike, por ka siguruar ambientin e nevojshëm për përdorimin e pajisjeve kompjuterike në sallën e bibliotekës (*Evidenca 26; Evidenca 6.1, pika 7*). Në këtë sallë, studentët kanë mundësinë që të kryejnë detyra e punime të ndryshme, duke shfrytëzuar programe profesionale, që lehtësojnë punën e tyre. |
| **Kriteri 5.**Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale sipas lëndëve / moduleve dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | Praktikat profesionale dhe disa veprimtari të tjera praktike realizohen në ambientet e vetë institucionit, të cilët u përshkruan më lart, por dhe pranë subjekteve, me të cilët IAL ka lidhur marrëveshje (*Evidenca 22*).<br>Fakulteti ka sallë për zhvillimin e gjyqeve imituese si dhe Klinikën e ligjit, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme. |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:* |

| | |
|---|---|
| | - *Institucioni përmbush kënaqshëm kërkesat sa i përket infrastrukturës së duhur për realizimin e programit të ciklit të tretë të studimeve, Master Ekzekutiv në Kriminologji. Në këtë drejtim, mjediset zotërojnë cilësinë e përshtatshme për realizimin e programit mësimor e praktik, sallat janë të përshtatshme dhe studentët kanë lehtësi në akses.*<br>- *IAL ka vendodhje të qëndrueshme, e cila përfshin si mjedisin administrativ, ashtu dhe mjediset e zhvillimit të veprimtarisë mësimore.*<br>- *Institucioni ka krijuar lehtësira infrastrukturore për studentët me aftësi të kufizuara (edhe pse aktualisht nuk kishte të regjistruar të tillë rishtas apo në vazhdim të studimeve).*<br>- *Institucioni zotëron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive akademike dhe shkencore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit (dokumentuar sipas stilit APA si në syllabuse, dhe në jetëshkrimet e personelit akademik). | Nga vëzhgimi i syllabuseve të lëndëve, por edhe i titujve të bibliotekës fizike dhe *online* të institucionit vërehet se ka një përpjekje të mirë për të përfshirë në literaturë informacionin e nevojshëm për qëllimet e programit të lëndëve. Literatura e rekomanduar është e pasqyruar në syllabusin e çdo lënde. Ka lëndë që nuk kanë një literaturë të veçantë, për të cilat pedagogu sugjeron literaturë të huaj, artikuj të ndryshëm shkencorë ose materiali përgatitet nga ana e lektorit të lëndës sipas temave të përfshira. Në përgjithësi, literatura e ofruar në bibliotekë është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat më themelore të studimit dhe kërkimit shkencor.<br><br>Institucioni ka bibliotekën e tij, e aksesueshme nga ambientet fizike ose *online*. Biblioteka zotëron fondin e saj fizik me |

| | |
|---|---|
| | botime/tituj në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, fond i cili pasurohet herë pas here me blerje/hyrje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga departamenti, siç ishte dhe informacioni më i fundit i marrë gjatë vizitës në Institucion. Ofrohet mundësia edhe për akses të studentëve në biblioteka *online*, pa pagesë (*Evidenca 33; Evidenca 19; Evidenca 20; Evidenca 21*). |
| **Kriteri 2.**Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Sikundër evidentohet në*RVB, f. 52*, punonjëset e bibliotekës, në përputhje me rregullat e vendosura në rregulloren e bibliotekës (*Evidenca 25*), përpilojnë çdo vit listat me titujt përkatës, që u vijnë në ndihmë përdoruesve. Këto lista sigurohen fizikisht në ambientet e bibliotekës si dhe në faqen zyrtare elektronike të fakultetit: https://fdut.edu.al/biblioteka/.<br><br>Sipas përcaktimeve të rregullores përkatëse, burimet kryesore për pasurimin e bibliotekës janë blerjet, dhuratat dhe projektet (*Evidenca 25; Evidenca 20*).<br><br>GVJ i është vënë në dispozicion materiali që hedh dritë mbi përditësimin e literaturës me botime të fundit, që gjenden në bibliotekën e fakultetit (*Evidenca shtesë 11 "Lista e librave të FD"*).<br><br>Nga aktet rezulton se institucioni ka miratuar "Rregulloren e bibliotekës së BFD". Në përmbajtje të këtij akti është parashikuar procedura për shtimin e literaturës në bibliotekë dhe për përditësimin e fondit të saj, gjë që vjen në harmoni me parashikimet e nenit 122 të statutit të UT-së (*Evidenca 1*). |
| **Kriteri 3.**Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën, e cila organizohet dhe funksionon në secilën njësi kryesore. Qëllimi i saj është që të mbështesë me literaturë mësimore dhe shkencore, aktivitetin e personelit akademik, studentëve, profesionistëve si dhe kërkuesve shkencorë në përgjithësi (*Evidenca 1, neni 122*).<br><br>Për të përmbushur këtë qëllim, FDUT siguron bibliotekën e tij në nivel njësie kryesore, nga e cila përfitojnë dhe studentët e këtij programi, objekt vlerësimi (*Evidenca 6.1, pika 7.3*).<br><br>Si në pikëpamje të akteve të brendshme të institucionit, ashtu dhe në atë objektive, rezulton që biblioteka të jetë lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët. |

| | |
|---|---|
| | Për të përfituar nga fondi i bibliotekës, studentëve iu hapet kartela përkatëse, ku paraqesin vërtetimin e studentit, letërnjoftim dhe fotografi (*Evidenca 25; Evidenca shtesë 6 "Kartelë në bibliotekë"*).<br><br>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ishte vendosur në katin e dytë të godinës, me ambient të mjaftueshëm, me ndriçim, ajrim dhe sistem të përshtatshëm kondicionimi (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 4.**Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Fakulteti i Drejtësisë zotëron një bibliotekë me larmi botimesh, me një fond prej 20000 libra, nga të cilët 9500 tekste në gjuhën shqipe dhe 10 500 në gjuhë të huaja si anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht dhe rusisht; 1350 tekste mësimore dhe monografi, nga të cilat 320 tekste në fushën e së drejtës penale dhe 550 tekste në fushën e së drejtës publike.<br><br>Gjithashtu, në bibliotekë gjenden të gjithë punimet e doktoraturave të mbrojtura në këtë fakultet, duke nisur nga viti 1962 si dhe 535 punime MND.<br><br>Në fondin e bibliotekës gjenden kodet nga viti 1929 e në vijim.<br><br>Biblioteka ka 1500 revista periodike, ku futen Fletoret Zyrtare nga viti 1932 e në vijim, revistat "Drejtësia Popullore" për periudhën 1948-1993, "Bibliografia Kombëtare" për periudhën 1966-1989, "Studime Juridike" nga viti 2000 e nëvijim dhe "Jeta juridike" si dhe botime të tjerë (*Evidenca shtesë 11 "Lista e librave të FD"*).<br><br>Në funksion të këtij programi studimi, vlen të përmendet zbatimi i projektit nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, që në bashkëpunim me fakultetet në fjalë, sigurojnë abonimin vjetor online në revista në fushën e kriminologjisë si "The British Journal of Criminology" i Oxford University Press, në të cilën botohen punime nga e gjithë bota në të gjitha fushat e kriminologjisë dhe siguron burime të vlefshme informacioni për stafin akademik si dhe studentët, për kërkimet e tyre shkencore (*Evidenca shtesë 11 "Lista e librave të FD"; Evidenca 19*).<br><br>Sipas *RVB, f. 53*, biblioteka e institucionit siguron një gamë të gjerë titujsh, të përzgjedhur në pëputhje me programet e studimit të ofruar nga ky universitet. UT boton disa revista shkencore, ku ndër të tjera botohen dhe artikuj e punime në fushën e së drejtës. |

| | |
|---|---|
| | Këto punime mund të aksesohen online: https://unitir.edu.al/botime-dhe-revista-shkencore/.<br><br>Literatura e gjendur në bibliotekë, në gjuhën shqipe dhe angleze, garanton përmbushjen e objektivave të programit për studentët (*Evidenca shtesë 11 "Lista e librave të FD"; Evidenca 42, pika 3.4*). |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Nga vizita e kryer në institucion dhe sipas të dhënave të vëna në dispozicion, institucioni ka siguruar akses pa pagesë për studentët në bibliotekat online "Jstore" dhe "Edward Elgar Publishing's journals and development studies e Books", në të cilën studentët dhe personeli akademik e kërkimor-shkencor mund të gjejnë larmi tekstesh e punimesh, në përputhje me programin e studimit (*RVB, f. 52*).<br><br>Aksesi në bibliotekën *online* sigurohet në bazë të abonimit, është pa pagesë për përfituesit e saj si dhe mund të arrihet nëpërmjet shërbimit *wifi* të internetit, në të gjithë ambientet e Fakultetit të Drejtësisë, nëpërmjet faqes zyrtare online të UT:https://unitir.edu.al/sherbimet-online/.<br><br>Sipas *f. 55 të RVB*, projekti i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ka mundësuar aksesin *online* në revista akademike të tri kompanive botuese: Sage, Springer Nature dhe Oxford Academic Press. Aksesi *online* realizohet në nivel institucional dhe do të zgjasë deri në fund të projektit (*Evidenca 21.1 "Springer Licence"; Evidenca 21.1 "Trade Mark(s) Licence ndërmjet Fakultetit"*).<br><br>Biblioteka digjitale COBISS+ ka të bëjë me një sistem kombëtar të informacionit të bibliotekave me katalogim të përbashkët, ku mund të gjenden materiale që janë kataloguar në bibliotekat shqiptare. Gjatë vizitës në institucion u verifikua që puna për vënien në funksionim të kësaj biblioteke është në vijim të procesit (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>*GVJ kërkoi aksesimin në bibliotekën online dhe bazat e tjera të të dhënave, gjatë vizitës në institucion, gjë e cila rezultoi plotësisht e realizueshme, me përjashtim të programit "Jstore"(Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji").* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të | Gjatë vizitës së kryer në institucion, GVJ konstatoi që biblioteka e institucionit është e pajisur me pajisjet e duhura teknike, tavolinat e punës si dhe programet kompjuterike që mundësojnë |

| | |
|---|---|
| tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve. | shfrytëzimin e saj nga studentët (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Njëra prej hapësirave të saj përmban zonën e kompjuterave dhe aksesorët e tjerë të nevojshëm. Për të përfituar nga fondi i bibliotekës, studentëve iu hapet kartela përkatëse, ku paraqesin vërtetimin e studentit, letërnjoftim dhe fotografi (*Evidenca 30, neni 7*). Sipas *RVB, f. 56*, dhe nga vizita e kryer, konstatohet që databaza e bibliotekës gjendet dhe në formatin elektronik në faqen elektronike zyrtare të institucionit (https://fdut.edu.al/biblioteka/).<br><br>Sistemi i përdorur në funksion të shfrytëzimit shërben për regjistrimin e materialeve, sistemin e klasifikimit të bibliotekës si dhe për procedurat e katalogimit të koleksionit kryesor (*Evidenca 25*). |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Oraret e punës së bibliotekës në FD janë të disponueshme për studentët nga dita e Hënë deri ditën e Premte në orarin 08.00 – 16.00. Oraret e ofrimit të këtij shërbimi vijnë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.<br><br>Orari është i shpallur në hyrje të bibliotekës. |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë | Nga takimi i zhvilluar në institucion me punonjëset e bibliotekës u konstatua se në përputhje me sa parashikohet në rregulloren për funksionimin e saj, kryhen raportime të përbashkëta me njësinë bazë që ofron programin e studimit lidhur me tekstet e gjendur në bibliotekë si dhe çdo literaturë tjetër fizike, por dhe për titujt që sigurohen *online*. Mbi bazën e të dhënave të nxjerra, merren masat e nevojshme dhe ndiqen procedurat përkatëse për përditësimin, por dhe për shkallën e shfrytëzimit të bibliotekës si nga personeli, ashtu dhe nga studentët. Këto analiza shërbejnë për të evidentuar dhe titujt e rinj që duhet të pasurojnë bibliotekën. Punonjëset e bibliotekës hartojnë listat me titujt e librave të rinj që duhet të përfshihen në fondin e bibliotekës dhe e paraqesin në dekanat për blerjen e tyre.<br><br>Gjithashtu, në mënyrë periodike, kryhen abonimet në Fletoren Zyrtare dhe në revistën "Jeta Juridike" që botohet nga Shkolla e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Magjistraturës (*Evidenca 25; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Institucioni ka krijuar në vite një fond të pasur në bibliotekën e tij, me tekste në fushën e drejtësisë. Titujt zgjidhen nga departamentet.*<br>- *Në bibliotekë gjenden botime periodike dhe sigurohet akses në disa faqe online, që i shërbejnë kërkimit shkencor, përgatitjes së tezave, etj.*<br>- *Biblioteka ka orare të përshtatshme të shërbimit, të lidhura me programin e studimit dhe nevojat e studentëve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Sipas përcaktimeve të bërë në aktet e brendshme të UT, në institucion funksionojnë njësitë ndihmëse si zyra e sekretarisë mësimore, e cila disponon dhe administron informacionin që lidhet me studentët. Nëpërmjet strukturave të tij, si të natyrës akademike, ashtu dhe administrative, universiteti siguron mbështetje të vazhdueshme ndaj studentëve në të gjithë aspektet. Për këtë qëllim janë ngritur strukturat përkatëse, të përshkruara në statut, që bëjnë të mundur shkëmbimin e të dhënave mes njësive drejtuese, akadamike dhe njësive të tjera ndihmëse apo të shërbimit (*Evidenca 1, neni 11/1*).<br>Institucioni ka hartuar dhe miratuar rregulloren e re të përgjithshme (*arsye për të cilën GVJ ka shfrytëzuar dhe i është referuar kësaj rregulloreje dhe jo rregullores së vjetër Evidenca* |

| | |
|---|---|
| | *1.1- e cila është përmendur në RVB*), ku parashikohen strukturat, roli dhe rregullimet sa u përket studentëve, procesit të mësimdhënies, etj, në përputhje me parashikimet e nenit 33 të ligjit Nr. 80/2015 (*Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022"*).<br><br>Informacioni për studentët administrohet në sistemin e të dhënave të sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave (https://fdut.edu.al/sekretaria-mesimore/). Në sekretari janë arkivuar dosjet e secilit student të regjistruar, të çregjistruar apo që ka përfunduar studimet, gjë që u verifikua gjatë vizitës në këtë zyrë nga GVJ (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Institucioni disponon gjithashtu të dhëna për studentët nga momenti i regjistrimit. Deri më tani, për shkak të kohës kur është hapur programi i studimit, nuk ka studentë të diplomuar (*Evidenca 6.1, f. 11; Evidenca 41*).<br><br>Nga kontrolli i kryer në dosjet e regjistrimit të studentëve në sekretarinë mësimore, të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u konstatua se në to gjendeshin të administruar të gjithë dokumentet e nevojshëm, të përcaktuar në aktet e brendshëm të institucionit, përkatësisht në pikën 5 të Rregullores së programit të studimit (*Evidenca 4*). Nuk u konstatuan probleme sa i përket matrikullimit të studentëve, por |
| **Kriteri 2.**Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Strukturat përkatëse që administrojnë të dhënat lidhur me personelin e punësuar në të, janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet e brendshme të UT.<br><br>Nga aktet e vënë në dispozicion rezulton që institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ (*Evidenca 6.5; Evidenca 6.1; Evidenca 24*).<br><br>Të dhënat që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore në nivel institucional dhe fakulteti, e cila, ka vënë në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme.Nga dokumentet e administruar në dosje u vu re që ishin në përputhje me llojet e dokumenteve të përcaktuar në |

| | |
|---|---|
| | aktet e brendshme rregulluese, me përjashtim të një personeli akademik të jashtëm, dosja e së cilës përmbante vetëm *curriculum vitae*. Punonjëset e zyrës së burimeve njerëzore në FDUT kanë shpjeguar verbalisht se dokumentacioni është verifikuar nga departamenti dhe dosjet origjinale mbahen në zyrën e burimeve njerëzore në nivel rektorati.<br><br>***GVJ sugjeron që zyra e burimeve njerëzore në nivel njësie kryesore duhet të mbajë kopje të plotë të dosjeve të secilit anëtar të stafit të punësuar me kohë të plotë apo me të pjesshme*** (*Evidenca 30; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Departamenti që mbulon këtë program studimi administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e bëra (*Evidenca 14; Evidenca 6.5; Evidenca 6.6; Evidenca 16; Evidenca 17; Evidenca 18*).<br><br>Po ashtu, departamenti në fjalë dhe institucioni, zotërojnë të dhëna mbi partnerët e angazhuar në realizimin e programit të studimit (*Evidenca 22; Evidenca 22.1; Evidenca shtesë 1*). |
| **Kriteri 3.**Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion rezulton që strukturat përgjegjëse për programin e studimit objekt vlerësimi, sekretaria mësimore dhe departamenti, mundësojnë dhënien e informacioneve e dokumentacionit të kërkuar si për personelin, ashtu dhe për studentët. Në funksion të këtij kriteri, shkëmbimi i të dhënave kryhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit që siguron llogari personale (postë elektronike) për anëtarët e personelit dhe secilin student, në faqen zyrtare elektronike të UT-së. Secili prej këtyre personave ka në dispozicion llogarinë e tij elektronike, me akses të personalizuar, ku mund të regjistrohet në kurset që do të frekuentojë si dhe të njihet me vlerësimet në fushën akademike. Nëpërmjet këtij sistemi mund të aksesojë dhe dokumente të ndryshme që lidhen me aktivitetin studentor e mësimor (*Evidenca 1, neni 86; Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022", neni 99*).<br><br>Të dhëna të hollësishme mbi programin e studimit jepen në rregulloren përkatëse (*Evidenca 4).*<br><br>Gjatë vizitës në institucion rezultoi se të dhënat mbi programin e studimit iu jepen studentëve në ditën e prezantimit dhe |

| | |
|---|---|
| | orientimit të tyre (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Të dhënat mbi kalendarin akademik dhe aktet përkatëse, aksesohen dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL: https://fdut.edu.al/doktorature-ne-drejtesi/.<br><br>Sa i përket syllabus-it të secilës lëndë, ky iu jepet studentëve në orën e parë të kursit, gjithashtu iu dërgohet studentëve në adresën elektronike (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*);<br><br>Sa i përket kritereve të pranimit të studentëve, universiteti i përcakton në bazë vjetore sipas vendimarrjes së strukturave përkatëse (*Evidenca 12; Evidenca 13; Evidenca 14; Evidenca 4, pika 4*). Kriteret publikohen në faqen zyrtare të universitetit: https://fdut.edu.al/2021/12/17/kriteret-e-pranimit-ne-programet-master-i-shkencave-ne-drejtesi-master-shkencor-dhe-profesional-master-ekzekutiv-ne-kriminologjise/.<br><br>Shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve ka funksionuar më së miri edhe gjatë periudhës së pandemisë, të shkaktuar nga Covid-19, nëpërmjet platformës së përdorur për këtë qëllim, *Microsoft Teams* (*Evidenca shtesë "Manual përdorimi Microsoft Teams"*). |
| **Kriteri 4.**Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Sipas *RVB (f. 58)*, institucioni ka krijuar mundësinë e komunikimit midis stafit akademik dhe studentëve përgjatë gjithë vitit akademik. Në radhë të parë, e gjithë godina ka akses në internet në tërësinë e ambienteve të tij. Studentët mund të njihen me vlerësimet e marra (notat) në sistemin e postës elektronike, sipas mënyrës së aksesit të mundësuar nga vetë institucioni. Nëpërmjet këtij sistemi mundësohet komunikimi dhe me struktura administrative të institucionit (*Evidenca 1, neni 86; Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022", neni 99*).<br><br>Komunikimi është verbal, por dhe me anë të postës elektronike, gjë që u konfirmua gjatë vizitës në institucion në takimet me personelin dhe studentët (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Gjithashtu, mundësohet komunikimi nëpërmjet platformës *Microsoft Teams*:https://unitir.edu.al/manual-perdorimi-microsoft-teams/. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Rregullimi i brendshëm i veprimtarisë së UT-së, përfshi FDUT, nëpërmjet statutit dhe rregulloreve, është bërë në mënyrë të tillë që strukturat drejtuese dhe titullarët të marrin dijeni për veprimtaritë e kryera nga personeli akademik dhe ai administrativ (*Evidenca 1; Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022"*).<br><br>Vlen të theksohet në këtë drejtim edhe përpilimi i raportit vjetor të institucionit, nëpërmjet të cilit përshkruhen veprimtaritë e brendshme dhe të jashtme studentore, akademike dhe administrative të tij. Raporti në fjalë përgatitet nga të gjitha strukturat akademike, administrative dhe të menaxhimit, nën drejtimin e rektoratit. Ky i fundit, është përgjegjës për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve dhe për përgatitjen e raportit vjetor, i cili i paraqitet në vijim për miratim Senatit dhe Bordit të Administrimit (*Evidenca 1, neni 31/1, germa k, në lidhje me nenin 55/1, gërma l*). |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | FDUT mundëson dhënien e informacionit në faqen zyrtare *online* të veprimtarisë së tij, https://fdut.edu.al/, si në lidhje me objektivat, stafin akademik, studentët, veprimtaritë shkencore, etj. Informacioni mundësohet në gjuhën shqipe dhe pjesërisht në gjuhën angleze. Gjatë aksesimit të kësaj faqeje, GVJ ka konstatuar se disa prej rubrikave janë të paaksesueshme ose nuk ofrojnë informacion të plotë. Në gjuhën angleze gjendet broshura informuese mbi programin e studimit Master Ekzekutiv në Kriminologji: https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/Informative-Brochure_Final-design_ENG-1.pdf.<br><br>***GVJ sugjeron që, në përputhje me standardet e vendosur në shtojcën Nr. 5 të VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë", informacionet të publikohen edhe në gjuhën angleze si dhe të jenë të sakta e të plota.*** |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Institucioni disponon të dhënat e nevojshme dhe ka ngritur strukturat e duhura për menaxhimin e të dhënave mbi studentët që nga momenti i regjistrimit.*<br>- *Institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe* |

| | |
|---|---|
| | *administrativ.Njësia bazë administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e bëra, gjithashtu mbi partnerët e angazhuar në realizimin e programit të studimit.* ***GVJ sugjeron që zyra e burimeve njerëzore në nivel njësie kryesore, të mbajë kopje të plotë të dosjeve të secilit anëtar të stafit të punësuar me kohë të plotë apo me të pjesshme.***<br>- *Strukturat përgjegjëse për programin e studimit objekt vlerësimi, sekretaria mësimore dhe departamenti, mundësojnë dhënien e informacioneve e dokumentacionit të kërkuar si për personelin, ashtu dhe për studentët. Shkëmbimi i të dhënave kryhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit që siguron llogari personale (postë elektronike) për anëtarët e personelit dhe secilin student, në faqen zyrtare elektronike të UT-së.*<br>- *Strukturat drejtuese dhe titullarët marrin dijeni rregullisht për veprimtaritë e kryera nga personeli akademik dhe ai administrativ.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.6**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Njësia kryesore/bazë harton planin buxhetor për programet e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tyre. | Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, FDUT është njësi përbërëse e UT, i cili është i organizuar në formën e një personi juridik publik, i njohur si i tillë me ligj (*Evidenca 1, nenet 3 dhe 11*).<br><br>Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, institucioni harton në mënyrë periodike pasqyrat financiare të të ardhurave si dhe të ndarjes së burimeve financiare.<br><br>UT gëzon autonomi financiare dhe në bazë të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015, harton planin buxhetor afatmesëm, pjesë e |

| | |
|---|---|
| | planit strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili përditësohet çdo vit (*Evidenca 1, neni 143*).<br><br>Nga të dhënat, (*RVB, f. 62*), procesi i hartimit të programit financiar nis në periudhën Mars-Maj dhe miratohet në vijim nga organet kompetente. Nga buxheti institucional, FDUT-së i akordohet buxheti përkatës, pasur parasysh nevojat përkatëse, bazuar në buxhetin afatmesëm të tij 3-vjeçar. Për këtë qëllim, FDUT harton çdo vit akademik plan-buxhetin e vet në përputhje me objektivat e programeve të studimit që ofron. Sipas *RVB-së, f. 61*, financimi dhe të ardhurat për FDUT-në, janë pjesë e informacionit dhe të dhënave financiare të UT-së.<br><br>Në përputhje me nenin 147 të statutit, UT i paraqet çdo vit akademik ministrisë përgjegjëse për arsimin raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim, etj. (*Evidenca 1*).<br><br>Burim i të ardhurave sipas statutit janë të ardhurat nga: buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për arsimim, të ardhurat për shërbimet e kryera, të ardhurat nga marrëdhëniet me palët e treta, donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi, veprimtari kërkimore-shkencore, projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare (*Evidenca 1, neni 144*). |
| **Kriteri 2.**Plani buxhetor i njësisë kryesore/bazë përgjegjëse për programet e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, RVB dhe aktet shoqëruese, rezulton se në buxhetin afat-mesëm dhe atë të vitit fiskal të UT-së, parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve të përfituar nga buxheti i shtetit, të cilët ndahen në tre kategori:<br><br>1) Shpenzime për politikat e zhvillimit;<br><br>2) Shpenzime për mësimdhënie dhe,<br><br>3) Shpenzime për punën kërkimore-shkencore dhe veprimtari krijuese (*Evidenca 1, neni 145*).<br><br>Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre. Buxheti përmban miratimin e detajimit të kuotave të buxhetit të konsoliduar (grant mësimdhënie, të ardhura), miratimin e detajimit të shpenzimeve operative, miratimin e detajimit të investimeve, miratimin e numrit të planifikuar të |

| | |
|---|---|
| realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | punonjësve. Këto zëra përfshijnë mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e saj, aksesin në bibliotekat *online*, përmirësimin e infrastrukturës së mjediseve, auditoret e leksioneve, sallat e seminareve dhe laboratorëve, rimbursim publikimesh, etj., që vlejnë dhe për këtë program studimi (*F. 60-61 e RVB*). |
| **Kriteri 3.**Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Nga aktet e vënë në dispozicion rezulton që administratori i FDUT raporton para dekanit të lidhur me analizën e realizimit të buxhetit për një vit kalendarik, duke dhënë në mënyrë të detajuar realizimin e shpenzimeve sipas treguesve. Në këtë analizë përfshihet dhe rezultati i pritshëm i të ardhurave (*Evidenca 27; Evidenca 29*). |
| **Kriteri 4.**Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, veprimtaria e UT-së i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar.<br><br>Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm e UT, e cila ka varësi organizative dhe funksionale nga Bordi i Administrimit, të cilit i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë, sipas legjislacionit në fuqi në këtë fushë (*Evidenca 1, neni 57*).<br><br>Në *RVB (f. 61)* është pasqyruar se raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. Raportet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm analizojnë eficencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe nga burime të tjera, përdorimin e tyre për të bërë të mundur rritjen e cilësisë së studimeve për të gjitha ciklet. Raportet financiare përmbajnë tabelat për të ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare të detajuara, ku institucioni.harton një raport financiar të kostove të programeve të studimit. Financimi dhe të ardhurat për FDUT-në janë pjesë e të dhënave financiare të UT-së (*Evidencashtesë 2*). |
| **Kriteri 5.**Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të | Pasur parasysh dokumentacionin e konsultuar, vlerësohet se institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit objekt vlerësimi. Situata financiare paraqet qëndrueshmëri dhe për ata studentë që do të zgjedhin të ndjekin programet e studimit të ofruar nga FDUT. Financimi nga |

| | |
|---|---|
| këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | buxheti i shtetit siguron qëndrueshmëri financiare dhe siguri për zhvillimin e programit të studimit.<br>Nga aktet rezulton se raportet financiare janë të administruara (*Evidenca 28; Evidenca 29*). Procedurat përkatëse nisin në periudhën Mars-Maj, mandej rektorati përgatit raportin financiar, bazuar në planifikimet e kryera në programin financiar (*Evidenca shtesë 2*). Raporti shqyrtohet dhe miratohet nga Bordi i Administrimit dhe në përfundim të këtij procesi bëhet dhe analiza që planifikon ndërhyrjet e duhura në të ardhmen për mbarëvajtjen e programeve të studimit (*Evidenca 1, neni 55, gërmat ll-n*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar. Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm, në lidhje me destinacionin e përdorimit të të ardhurave dhe përmbushjen e qëllimit të vjeljes së tyre.*<br>- *Raportet e auditit përmbajnë në mënyrë të detajuar situatën financiare si dhe të dhëna për përdorimin e buxhetit të planifikuar për realizimin e programit mësimor. Të dhënat përfshijnë gjithashtu pagat, shpenzimet operative, detyrimet ndaj të tretëve, etj.*<br>- *Drejtimet e shpenzimeve kanë të bëjnë me përmirësimin e mësimdhënies, hapësirat për studentët, përmirësimin e trajtimit të personelit akademik, të kushteve të punës së këtij personeli, shtimin e literaturës në bibliotekë, etj.*<br>- *Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit objekt vlerësimi. Situata financiare paraqet qëndrueshmëri dhe për ata studentë që do të zgjedhin të ndjekin programet e studimit të ofruar nga FDUT. Financimi nga buxheti i shtetit siguron qëndrueshmëri financiare dhe siguri për zhvillimin e programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | UT ka hartuar dhe miratuar procedurat e nevojshme për regjistrimin e studentëve, periudhën e studimeve dhe diplomimin e tyre, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion e përkatësisht akteve të brendshëm (*Evidenca 1, krerët VII dhe IX; Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022", Kreu V; Evidenca 4, pikat 4-13*).<br><br>Aktet e brendshëm janë hartuar në respektim të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Mbi bazën e akteve themelore të organizimit të brendshëm, institucioni ka ngritur disa zyra dhe zbaton procedura që mbulojnë momentin e regjistrimit, pranimit, transferimit, lënies së studimeve, këshillimit gjatë periudhës së studimeve, diplomimin e studentëve (*Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022";Evidenca 4; Evidenca 5; Evidenca 12; Evidenca 14.1*). |
| **Kriteri 2.**Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Institucioni ka parashikuar politika dhe procedura regjistrimi, pranimi dhe transferimi të studentëve në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor të aplikueshëm. Procedurat e hyrjes dhe të daljes si dhe ato gjatë kohëvazhdimit të studimeve, të përcaktuara qartë dhe të bëra publike, garantojnë respektimin e të drejtave të secilit kandidat/student (*Evidenca 1, neni 6; Evidenca 4, pikat 4-13*).<br><br>Këto parime përmenden dhe në strategjinë e zhvillimit të UT-së,në drejtim të ofrimit dhe dhënies së mundësive të barabarta për të gjithë studentët apo kandidatët për të qenë të tillë (*Evidenca 2, pika 1*). |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.**Për t'u pranuar në një program studimi "Master Ekzekutiv" (ME) kandidati duhet të ketë përfunduar së paku një program studimi të ciklit të dytë ("Master i shkencave" apo program të integruar të studimi të ciklit të dytë), të jetë profesionist i fushës, të ketë eksperiencë profesionale mbi dy vite të dëshmuar, të ketë njohuri te gjuhës se huaj sipas specifikimeve tëbazës ligjore, si dhe të plotësojë standardet akademike të kritereve të pranimit të institucionit respektiv për këto programe studimi, të cilat bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion. | Pranimi i studentëve që ndjekin programin e ciklit të tretë të studimeve në FDUT është realizuar sipas kritereve që vendos ligji Nr. 80/2015, nenet 77-78, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë statuti i UT dhe Rregullorja e programit. Pasur parasysh rregullimet e nenit 99/4 të statutit të UT-së, të drejtën për të aplikuar në këtë program studimi e kanë personat që:<br>- Kanë përfunduar studimet e larta në fushën e kërkuar dhe që zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë, një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi;<br>- Kanë rezultate të larta në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, në përputhje me kriteret e shpallura;<br>- Kanë dëshmi zotërimi të një nga pesë gjuhët e huaja të vlerësuara sipas testeve të njohur ndërkombëtarisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi;<br>- Kanë dy rekomandime nga persona që gëzojnë titull akademik, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;<br>- Zotërojnë standardet shkencore dhe etike (*Evidenca 1*).<br><br>Sipas pikës 4 të Rregullores së programit të studimit, për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në Kriminologji, studenti duhet të:<br>- Ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë diplomën "Master i Shkencave" ose një diplomë tjetër të fituar brenda ose jashtë vendit të vlerësuar ekuivalente me të, si diplomë e nivelit të dytë, diplomë e integruar e nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi;<br>- Ketë përfunduar studimet e larta në Drejtësi ose Shkenca Sociale. Pranohen edhe kandidatë që kanë përfunduar studimet e larta në shkenca të tjera të përafërta me fushën e masterit ekzekutiv, nëse janë të angazhuar profesionalisht në institucione ku kërkohet ekspertizë në fushën e kriminologjisë;<br>- Njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar |

| | |
|---|---|
| | një diplomë në një program studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri (*Evidenca 4*).<br><br>Pika 5 e Rregullores së programit përcakton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim dhe procedurën që duhet ndjekur, dispozitë e cila është në harmoni me kërkesat e nenit 99 të statutit të UT-së (*Evidenca 1*).<br><br>Referuar kritereve dhe dokumentacionit të pranimit, të publikuar në faqen zyrtare elektronike të UT-së, dokumentacioni që duhet dorëzuar për aplikim është:<br><br>- Formulari i aplikimit;<br>- Kopjen e noterizuar të diplomës së nivelit të parë/Bachelor që studenti ka fituar dhe diplomën e nivelit Master Shkencor ose ekuivalente me të;<br>- Jetëshkrimi i kandidatit (CV);<br>- Një letër interesi ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe arsyet që aplikon për Masterin Ekzekutiv në Kriminologji apo lidhjen e masterit me angazhimin profesional;<br>- Një projekt-ide në lidhje me fushat me interes për kërkim shkencor të aplikantit gjatë programit Master Ekzekutiv në Kriminologji;<br>- Dy letra rekomandimi nga persona që gëzojnë titull akademik, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;<br>- Dokumentacioni në lidhje me gjuhën e huaj, sipas legjislacionit në fuqi (*Evidenca 4*);<br><br>Pranimet e studentëve bëhen në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore dhe kriteret e pranimit të vendosura nga njësia bazë e njësia kryesore si dhe publikohen në faqen elektronike të fakultetit përpara pranimeve të radhës: https://fdut.edu.al/2021/12/17/kriteret-e-pranimit-ne-programet-master-i-shkencave-ne-drejtesi-master-shkencor-dhe-profesional-master-ekzekutiv-ne-kriminologjise/. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të | Kriteret dhe procedurat mbi pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve janë parashikuar në aktet e brendshme të institucionit mbi bazën e kritereve të përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015. Procedura të hollësishme janë parashikuar në statut, |

| | |
|---|---|
| studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | rregulloren themelore dhe në atë të programit të studimit, ku është përqendruar dhe GVB (*Evidenca 1; Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022"; Evidenca 4*).<br><br>Kriteret e regjistrimit janë publikuar dhe në faqen zyrtare elektronike të institucionit dhe të njësisë (https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/;https://fdut.edu.al/2021/12/17/kriteret-e-pranimit-ne-programet-master-i-shkencave-ne-drejtesi-master-shkencor-dhe-profesional-master-ekzekutiv-ne-kriminologjise/), të aksesueshme nga cilido i interesuar.<br><br>Sa u përket procedurave të tjera gjatë vazhdimit të studimeve, përfshi transferimet, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, institucioni ka krijuar mekanizmat përkatës, rregullore dhe zyrat zbatuese të tyre. Informacione të hollësishme studentëve iu sigurohen në faqen *online* të UT-së si dhe të FDUT-së.<br><br>Institucioni ka hartuar dhe miratuar një guidë për studentët, ku gjejnë të përmbledhur të gjithë rregullat, procedurat dhe strukturat që ofrojnë këto shërbime (*Evidenca shtesë 8*).<br><br>Gjithashtu, FDUT ka hartuar për këtë qëllim një broshurë informuese, e cila përshkruan qëllimin, objektivat, përfituesit, kriteret e pranimit dhe ofron një pasqyrë të moduleve/kurseve të Masterit Ekzekutiv në Kriminologji. Për më tepër, broshura jep informacion mbi kompetencat profesionale dhe sektorët për mundësitë e punësimit si dhe është publikuar në faqen zyrtare të fakultetit: https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/Informative-Brochure_Final-design_ALB-1.pdf.<br><br>Informacioni është lehtësisht i kuptueshëm dhe përfshin të dhënat e nevojshme. |
| **Kriteri 5.**Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion del në pah që fakulteti i drejtësisë vë në dispozicion të publikut përpara fillimit të secilit vit akademik, broshura informuese që sigurojnë të dhëna të qarta për programin e studimit, organizimin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentëve, jetën studentore, etj. (*Evidenca 4, pika 4.4; Evidenca 6*). Përveç kritereve të përgjithshme, në këto materiale informuese paraqiten dhe kriteret e veçanta të programit të studimit. Departamenti përcakton kuotat e pranimit, kriteret e pranimit |

| | |
|---|---|
| | dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 10 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik për programin e studimit që ofron (*Evidenca 1, neni 99; Evidenca 37*).<br><br>Gjatë vizitës në institucion u konfirmua se FDUT bëhet i dukshëm për publikun dhe të interesuarit edhe nëpërmjet rrugëve të tjera informale, gjatë takimeve në IAL të tjera, rrjete sociale, faqes elektronike të OSBE-së në Shqipëri, etj. (*Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"*) si dhe publikimeve në faqen zyrtare të UT-së dhe FDUT-së: https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/; https://fdut.edu.al/njoftime/. |
| **Kriteri 6.**Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave etj. | Në pikën 4.4 të rregullores së programit të studimit përcaktohet se departamentet që e mbulojnë këtë program mund të shpallin edhe kritere të tjerë specifikë akademikë, kritere të cilët shpallen publikisht (*Evidenca 4*). Nga të dhënat e administruara, *RVB, f. 65*, si dhe gjatë vizitës në institucion rezultoi se për këtë program nuk janë parashikuar kritere dhe kuota të veçanta për kandidatët me aftësi të veçanta, pakicat, etj. (*Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 7.**Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Nga të dhënat e administruara, *RVB, f. 65*, si dhe gjatë vizitës në institucion rezultoi se për këtë program nuk janë parashikuar kritere dhe kuota të veçanta për kandidatët nga shtete të tjerë (*Evidenca shtesë "Minuta ME Kriminologji"*) |
| **Kriteri 8.**Institucioni harton politika të ndihmës/bursave dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Në lidhje me këtë kriter, për këtë program studimi nuk aplikohen ndihma/bursa, në përputhje me përcaktimet e vendimit Nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar. |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>- *Institucioni ka parashikuar politika dhe procedura regjistrimi, pranimi dhe transferimi të studentëve në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor të aplikueshëm. Procedurat e hyrjes dhe të daljes si dhe ato gjatë kohëvazhdimit të studimeve, të përcaktuara qartë dhe të* |

| | |
|---|---|
| | *bëra publike, garantojnë respektimin e të drejtave të secilit kandidat/student.*<br><br>- *Pranimi i studentëve që ndjekin programin e ciklit të tretë të studimeve në FDUT është realizuar sipas kritereve që vendos ligji Nr. 80/2015, nenet 77-78, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë statuti i UT dhe Rregullorja e programit.*<br><br>- *Sipas pikës 4 të Rregullores së programit të studimit, për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në Kriminologji, studenti duhet të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë diplomën "Master i Shkencave" ose një diplomë tjetër të fituar brenda ose jashtë vendit të vlerësuar ekuivalente me të, si diplomë e nivelit të dytë, diplomë e integruar e nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi; Të ketë përfunduar studimet e larta në Drejtësi ose Shkenca Sociale. Pranohen edhe kandidatë që kanë përfunduar studimet e larta në shkenca të tjera të përafërta me fushën e masterit ekzekutiv, nëse janë të angazhuar profesionalisht në institucione ku kërkohet ekspertizë në fushën e kriminologjisë.*<br><br>- *FDUT vë në dispozicion të publikut përpara fillimit të secilit vit akademik, broshura informuese që sigurojnë të dhëna të qarta për programin e studimit, organizimin e institucionit, të drejtat dhe detyurat e studentëve, jetën studentore, etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.**Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në | Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, mund të konfirmohet se studentët marrin të dhëna të detajuara mbi programin e studimeve, afatin e përfundimit të tyre, të |

| | |
|---|---|
| lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | drejtat dhe detyrimet e studentëve, akreditimin e programit. Informacioni për këtë program studimi gjendet i qartë dhe në faqjen online të universitetit:https://fdut.edu.al/.<br><br>FDUT organizon që në javën e parë të vitit akademik një javë orientuese, ku marrin pjesë studentët, personeli akademik dhe ndihmës-akademik, me qëllim informimin e studentëve mbi objektivat e programit të studimit, arritjet në fund të tij dhe kriteret për kalimin në vitin pasardhës akademik. Gjatë kësaj jave mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative për studentët e rinj (*Evidenca 4, pika 7.2*).<br><br>Në fillim të çdo semestri, studentëve iu vihen në dispozicion programet për secilën lëndë. Programet shpërndahen në klasë nga pedagogu, depozitohen në departamentin e të drejtës penale, që drejton Masterin Ekzekutiv, dhe publikohen në formën e një broshure (*Evidenca 4, pika 9.3; Evidenca 6*).<br><br>Të dhëna mbi lëndën dhe syllabus-in e saj, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe detyrimet, studentët i marrin në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga pedagogu përkatës (*Evidenca 33*).<br><br>Vlerësimet për secilën lëndë hidhen në sistemin e informacionit të studentëve dhe administrohen nga zyra e sekretarisë. Stafi akademik plotëson dhe nënshkruan fletën e rezultateve të provimit për secilën lëndë. Fletët e rezultatit administrohen dhe arkivohen nga zyra e sekretarisë (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). Vlerësimet e lëndëve të programit iu bëhen të ditur studentëve nga sekretaria mësimore nëpërmjet adresave elektronike ose drejtpërdrejt: https://fdut.edu.al/sekretaria-mesimore/. |
| **Kriteri 2.**Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | UT njeh mundësinë e transferimit të studentëve të cilët kanë përfunduar të paktën një vit studimor në programe të të njëjtit cikël, prej institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. FDUT, si njësi kryesore e UT-së, sipas kuotave të pranuara, ofron mundësi për transferime të studentëve, të cilët kanë përfunduar të paktën një vit studimor në programe të ngjashme (shkenca humane), prej institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit. Procedura e përcaktuar në këto akte është e qartë, në drejtim të njohjes së studimeve të kryer më parë nga studenti. Me qëllim njohjen e këtyre studimeve të mëparshme, ngrihet një komision i posaçëm sipas rregullave të |

| | |
|---|---|
| | caktuara nga UT në aktet e tij të brendshëm. Vendimin përfundimtar për kërkesën për transferim e merr dekani i fakultetit ku ka aplikuar kandidati. (*Evidenca 1, neni 109; Evidenca 6.1, f. 11*). Informacioni mund të merret në faqen zyrtare të FDUT-së: https://fdut.edu.al/sekretaria-mesimore/.<br><br>Nga të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion, nuk ka pasur raste të transferimit të studimeve nga dhe për këtë program (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 3.**Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Institucioni ka një strukturë të informimit dhe këshillimit për studentët (sektori i marrëdhënieve me studentët në nivel rektorati), me të cilën bashkëpunon FDUT, e cila mundëson informimin në mënyrë të detajuar mbi programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit, kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të tyre (*Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 14*).<br><br>Njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi, jep informacionin e nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin dhe ndjekjen e programit, syllabus-et, praktikat, ushtrimet, laboratorët, etj. Gjatë takimeve në institucion u konfirmua se format praktike që përdoren për këtë qëllim janë: platforma TEAMS, nëpërmjet llogarive personale elektronike të ngritura për këtë qëllim, në faqen *online* të fakultetit (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Ky informacion iu sigurohet në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga departamenti si dhe pedagogu përkatës (*Evidenca 4, pika 9.3; Evidenca 33*).<br><br>Të dhënat mund të aksesohen po ashtu dhe në faqen zyrtare të institucionit, ku janë publikuar rregullorja e programit dhe broshura informuese: https://unitir.edu.al/studentet/ dhe https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/Informative-Brochure_Final-design_ALB-1.pdf.<br><br>Në sistemin elektronik studentët gjejnë vlerësimet për secilën lëndë (*Evidenca 1, neni 86; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 4.**Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me | Studimet e ciklit të tretë Master Ekzekutiv në Kriminologji përfundojnë me punimin e diplomës, pasi studenti të ketë shlyer gjithë detyrimet akademike që përmban plani mësimor. Teza e |

| | |
|---|---|
| kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | diplomës është punë krijuese e studentit, e cila trajton një çështje aplikative që lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe stazhin apo praktikën profesionale që ka kryer studenti. Studimi duhet të synojë paraqitjen strategjike, politike dhe zbatuese për përmirësime konkrete brenda institucioneve, veprimtaria e të cilëve lidhet ngushtë me fushën e kriminologjisë. Tema (mikroteza) është punimi kërkimor që studenti kryen në mënyrë të pavarur, nën udhëheqjen e pedagogut përkatës të caktuar nga përgjegjësi për mbikëqyrjen e këtij programi studimi. Zgjedhja e temës dhe puna për shkrimin e saj nis që në fillim të vitit të parë akademik, sipas procedurës dhe kritereve të mirëpërcaktuar në rregulloren e programit. Temat e propozuara dhe pedagogët udhëheqës për secilin student miratohen nga Komiteti Shkencor *ad hoc*, i ngritur për këtë qëllim. Në funksion të temës së diplomës është lënda "Projekti kërkimor-shkencor", e cila është përcaktuar për t'u zhvilluar vitin e tretë të studimeve (*Evidenca 4, pika 2.5 dhe pika 13*).<br><br>Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni ka parashikuar procedurat përkatëse për punimin e temës së diplomës, i cili lehtëson punën e studentëve që mbyllin studimet përmes punimit të saj (*Evidenca 5*).<br><br>Strukturat kompetente kanë përcaktuar formën e diplomës për këtë cikël studimi si dhe përmbajtjen dhe formën e suplementit të diplomës (*Evidenca 10.2; Evidenca 10.3; Evidenca 10.3.1*). Të dhëna të përgjithshme mbi mikrotezën gjenden dhe në broshurën informuese mbi programin e studimit (*Evidenca 6*). Orientimi i studentëve lidhur me diplomimin kryhet nga departamenti, i cili iu siguron informacionin e duhur. Atyre iu jepen të dhënat e nevojshme që në fillim të vitit akademik rreth procedurave të vlerësimit dhe mbylljes së studimeve, përfshi procesin e diplomimit (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 5.**Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për | Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni u siguron të interesuarve dhe studentëve informacionin e nevojshëm për këtë program studimi, nëpërmjet takimeve të ndryshme që realizohen për këtë qëllim (*RVB, f. 67*).<br><br>Të dhënat përkatëse për programin e studimit janë të publikuara dhe *online*: https://fdut.edu.al/wp- |

| | |
|---|---|
| informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | content/uploads/2021/10/Informative-Brochure_Final-design_ALB-1.pdf, në faqen zyrtare të njësisë, përkatësisht broshura informuese mbi programin e studimit.<br>*(Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 14 dhe lidhja Nr. 3).* |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Studentët marrin të dhëna të detajuara mbi programin e studimeve, afatin e përfundimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, akreditimin e programit. Informacioni iu jepet gjatë javës orientuese, nga departamenti, pedagogu i lëndës, me anë të broshurave si dhe nëpërmjet publikimeve online.*<br>- *Njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi, jep informacionin e nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin dhe ndjekjen e programit, syllabus-et, praktikat, ushtrimet, laboratorët, etj. Format praktike që përdoren për këtë qëllim janë: platforma Teams, llogaritë personale elektronike të ngritura për këtë qëllim, faqja online e fakultetit.*<br>- *Institucioni ka parashikuar procedurat përkatëse për punimin e temës së diplomës, i cili lehtëson punën e studentëve që mbyllin studimet përmes punimit të saj. Orientimi i studentëve lidhur me diplomimin kryhet nga departamenti, i cili iu siguron informacionin e duhur. Atyre iu jepen të dhënat e nevojshme që në fillim të vitit akademik rreth procedurave të vlerësimit dhe mbylljes së studimeve, përfshi procesin e diplomimit.*<br>- *Institucioni, nëpërmjet sektorit të marrëdhënieve me studentët, organizon takime për të informuar të interesuarit dhe studentët mbi programin e studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3** |
|---|

| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentët marrin informacione të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve që do të ndjekin, si nga stafi akademik, ashtu dhe ai administrativ i universitetit. Vlen të përmendet në lidhje me këtë kriter, orientimi që marrin studentët në fillim të çdo viti akademik mbi programin e studimit (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"; Evidenca 4, pika 7.2*).<br><br>Sektori i marrëdhënieve me studentët në rektoratin e UT-së është një ndër strukturat që sigurojnë informacionin e vazhdueshëm të nevojshëm sa i përket çështjeve që lidhen me infrastrukturën, organizimin e studimeve dhe orientimin pas studimeve (*Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 14*).<br><br>Rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luajnë dhe të dhënat e publikuara në faqen zyrtare elektronike të universitetit dhe FDUT-së, sikundër është broshura informuese për programin e studimit (*Evidenca 6*). |
| **Kriteri 2.**Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Departamentet që mbulojnë këtë program studimi dhe pedagogët e secilës lëndë, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat administrative të FDUT-së, sigurojnë dhënien e informacioneve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për modulet, lëndët, ngarkesën mësimore, orët në auditor, syllabus-et e detajuar, praktikat, ushtrimet, detyrat e kursit si dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në programin e studimit (*Evidenca 33*). Informimi mundësohet si në fillim (kryesisht), por dhe në vijim të vitit akademik. Ky është një detyrim që buron nga aktet e brendshme rregulluese të IAL (*Evidenca 4, pika 7.2 dhe 9.3*). Mandej, informacionet për planprogramet e kursit gjenden dhe të shpallura *online* në faqen: https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/Informative-Brochure_Final-design_ALB-1.pdf. |
| **Kriteri 3.**Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si | Ky program studimi synon që të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike në fushën e kriminologjisë, të jenë të aftë të punojnë në grup si dhe të jenë të aftë të përballen me tregun e |

| | |
|---|---|
| dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | punës, në sektorë të ndryshëm ku do të vlejnë dijet e marra në drejtim të luftës dhe parandalimit të kriminalitetit (*Evidenca 6.1, f. 2-3*). Në statutin e UT-së përcaktohet se pranë rektoratit funksionojnë disa struktura ndihmëse me karakter akademik, të cilat janë të përbëra nga personel ndihmësakademik me karakter administrativ konkretisht: 1) struktura e programeve mësimore dhe e sigurimit të cilësisë; 2) struktura e marrëdhënieve me jashtë dhe studentët; 3) struktura e kërkimit shkencor dhe IT-së; 4) struktura juridike dhe e marrëdhënieve me publikun; 5) struktura e burimeve njerëzore dhe e protokoll-arkivit, të cilat organizohen dhe funksionojnë sipas përcaktimeve të bërë në rregulloren e rektoratit (*Evidenca 1, neni 44; Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat"*).<br><br>Në përputhje me këta rregullime dhe aktet e tjerë të brendshëm, pranë rektoratit të UT është ngritur dhe funksionon Zyra e Karrierës dhe Orientimit Studentor, nëpërmjet së cilës këtyre të fundit iu ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. FDUT bashkëpunon me të për të arritur objektivat më drejtim të planifikimit të karrierës dhe këshillimit për studentët e regjistruar. Zyra e karrierës është ngritur dhe në nivel fakulteti (https://fdut.edu.al/zyra-e-karrieres/), ku merren dhe informacione më të detajuara në këtë drejtim (*Evidenca 24*).<br><br>Nga dokumentacioni vërehet se të interesuarit marrin informacione mbi programet e studimit që ofron FDUT, për të zgjedhur programin e duhur në përputhje me objektivat personale, regjistrimi në program si dhe informacione të detajuara mbi trajnimet, aktivitetet e ndryshme, *internship*-et, praktikat profesionale dhe mundësi punësimi për studentët si dhe informacione të tjerë me rëndësi për procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në UT (https://fdut.edu.al/njoftime/).<br><br>Pasur parasysh këtë kriter, ***GVJ gjen me vend të sugjerojë hartimin e një dokumenti të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës, në formën e Udhëzuesit për zhvillimin e karrierës***. |
| **Kriteri 4.**Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, | Informacionin e plotë lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, studentët e marrin që në leksionin e parë (*Evidenca 4, pika 9.3*). Në këtë drejtim, vlen të përmendet dhe roli i sektorit për marrëdhëniet me studentët, i cili siguron udhëzime për secilin student në të gjitha çështjet akademike |

| | |
|---|---|
| logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | (*Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 14*).<br><br>Të dhëna të tjera të hollësishme mbi procesin mësimor studentët marrin dhe nëpërmjet broshurës informuese mbi programin e studimit (*Evidenca 6*). Informacioni i përditësuar gjendet dhe në faqen zyrtare elektronike të UT dhe FDUT-së (https://fdut.edu.al/master-ekzekutiv-ne-kriminologji/) si dhe një sërë informacionesh, sipas *f. 68 të RVB-së*, gjenden në këndet e njoftimeve në ambientet e fakultetit. |
| **Kriteri 5.**Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, vizita e kryer në institucion dhe nga takimi me studentët, konstatohet që strukturat përgjegjëse në rang akademik dhe administrativ kanë mundësuar dhënien e informacionit në mënyrë të saktë e të kuptueshme (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Institucioni ka ngritur sistemin elektronik të përshtatshëm për arritjen e shkëmbimit të informacionit nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm (*Evidenca 1, nenet 85-86*).<br><br>Ky informacion ka qenë lehtësisht i arritshëm edhe në distancë (sidomos gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19), duke realizuar shkëmbimin e të dhënave në rrugë elektronike (nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit: http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut, postës elektronike dhe platformës së ngritur për mësimdhënien në distancë) (*Evidenca shtesë 10 "Rregullore zhvillimit të provimeve online; Evidenca shtesë "Rregullore e posaçme për procedurën e zhvillimit të provimeve online"; Evidenca shtesë "Udhëzues mësimdhënia në distancë"*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>- *Sektori i marrëdhënieve me studentët në rektoratin e UT-së është një ndër strukturat që sigurojnë informacionin e vazhdueshëm të nevojshëm sa i përket çështjeve që lidhen me infrastrukturën, organizimin e studimeve dhe orientimin pas studimeve. Rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luajnë dhe të dhënat e publikuara në faqen zyrtare elektronike të universitetit dhe FDUT-së, sikundër është broshura informuese për programin e studimit.*<br>- *Departamentet që mbulojnë këtë program studimi dhe pedagogët e secilës lëndë, në bashkëpunim të ngushtë me* |

| | |
|---|---|
| | *strukturat administrative të FDUT-së, sigurojnë dhënien e informacioneve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për modulet, lëndët, ngarkesën mësimore, orët në auditor, syllabus-et e detajuar, praktikat, ushtrimet, detyrat e kursit si dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në programin e studimit. Informimi mundësohet si në fillim (kryesisht), por dhe në vijim të vitit akademik.*<br>- *Të interesuarit marrin informacione mbi programet e studimit që ofron FDUT, për të zgjedhur programin e duhur në përputhje me objektivat personale, regjistrimi në program si dhe informacione të detajuara mbi trajnimet, aktivitetet e ndryshme, internship-et, praktikat profesionale dhe mundësi punësimi për studentët si dhe informacione të tjerë me rëndësi për procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në UT.* ***GVJ sugjeron hartimin e një dokumenti të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës, në formën e Udhëzuesit për zhvillimin e karrierës.***<br>- *Informacioni është lehtësisht i arritshëm edhe në distance, duke realizuar shkëmbimin e të dhënave në rrugë elektronike, nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit, postës elektronike dhe platformës së ngritur për mësimdhënien në distancë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Njësia kryesore si dhe departamenti që mbulon këtë program studimi disponojnë dhe mbajnë statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar për programin e studimit për secilin vit akademik objekt shqyrtimi. Të dhënat përfshijnë statistikat e përgjithshme mbi numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, aktivitetet ku janë përfshirë. Duke qenë se |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>programi, objekt vlerësimi, është hapur në vitin 2020, nuk ka ende studentë të diplomuar, rrjedhimisht as të dhëna mbi punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve (Evidenca 6.1, f. 11; Evidenca 41; Evidenca 42).</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2.Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</td>
<td>Institucioni zotëron të dhënat e nevojshme statistikore për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara, për programin estudimeve të ciklit të dytë. Të dhënat administrohen nga sekretaria mësimore, në dokumentacionin e mbajtur për këtë qëllim (Evidenca 41; Evidenca 42; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji").<br><br>Referuar Evidencës 41 "Statistikat mbi numrin e studentëve"dhe vizitës në institucion (Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"), numri i studentëve për këtë program studimi rezulton:<br><br>
<table>
<tr><th>Programi i studimit</th><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar</th></tr>
<tr><td rowspan="2">MP.EU Business Law</td><td>2020-2021</td><td>24</td></tr>
<tr><td>2021-2022</td><td>25</td></tr>
<tr><td colspan="2">Totali</td><td>49</td></tr>
</table>
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3.Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</td>
<td>Nga aktet e konsultuar vërehet që të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga strukturat e ngritura për këtë qëllim, si sekretaria mësimore, janë mbajtur përgjithësisht në mënyrë të saktë dhe mund të aksesohen me lehtësi. Aksesi në to mundësohet nga baza e të dhënave elektronike, e krijuar për këtë qëllim. Institucioni ka miratuar akte që synojnë mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimet e paligjshme, humbjet aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose shpërndarjen e tyre nga persona të autorizuar (Evidenca 1, neni 124; Evidenca 40).</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 4.Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit</td>
<td>Në përputhje me kriteret e përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015, UT ka miratuar aktet e brendshme që përcaktojnë organizimin administrative, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit të përfshirë në të dhe që merren posaçërisht me çështje të sekretarisë mësimore dhe sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit në tërësi. Këto rregullime që gjenden në statut, në rregulloren e përgjithshme të universitetit, etj, mundësojnë kontrollin dhe mbajtjen e përgjegjësive konkrete në lidhje me informacionin dhe dokumentacionin e administruar për studentët e për veprimtaritë ku ata janë të përfshirë (Evidenca 1;</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | *Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022"; Evidenca 27; Evidenca 40*). Rregulloret janë të publikuara dhe në faqen zyrtare të institucionit: https://unitir.edu.al/rregullore-ut/. |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Sipas *RVB, f. 69*, departamenti i së drejtës penale i FDUT-së, mban raporte vjetore mbi studentët që ndjekin studimet pranë tij. Raportet përmbajnë të dhëna sasiore dhe cilësore që kanë të bëjnë ndër të tjera me studentët, tregun e punës, etj. Të dhënat përfshihen në raportin vjetor të fakultetit dhe shërbejnë për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të përmirësimit të treguesve të ndryshëm. Sikundër u vu në dukje, programi objekt vlerësimi ka nisur veprimtarinë në vitin 2020, arsye për të cilën nuk ka ende studentë të diplomuar si dhe të dhëna për shkallën e punësimit të tyre, pas përfundimit të studimeve në të. (*Evidenca42*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Institucioni zotëron të dhëna sa i përket numrit të studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara. Të dhënat gjenden në sekretarinë mësimore.*<br>- *Të dhënat përfshijnë statistikat e përgjithshme mbi numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, aktivitetet ku janë përfshirë. Duke qenë se programi, objekt vlerësimi, është hapur në vitin 2020, nuk ka ende studentë të diplomuar, rrjedhimisht as të dhëna mbi punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve.*<br>- *Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga strukturat e ngritura për këtë qëllim, janë mbajtur përgjithësisht në mënyrë të saktë dhe mund të aksesohen me lehtësi. Aksesi në to mundësohet nga baza e të dhënave elektronike, e krijuar për këtë qëllim.*<br>- *Institucioni ka miratuar akte që synojnë mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimet e paligjshme, humbjet aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose shpërndarjen e tyre nga persona të autorizuar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi V.5<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Në harmoni me përcaktimet e nenit 98/1, gërma *c*, të ligjit Nr. 80/2015, studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë. Në përputhje me këtë parashikim ligjor, në nenin 125/1, pikat 1, 2 e 129 në lidhje me nenet 30, 40, 41, 42, 43 të statutit të UT, përcaktohet se studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e UT dhe përfaqësohen në senat, Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisionin e përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisionin e përhershëm të kurrikulës, Këshillin e etikës, Këshillat e Studentëve (*Evidenca 1*). Të njëjtat parashikime janë përcaktuar dhe në Rregulloren e përgjithshme të institucionit (*Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022"*). |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | E drejta për pjesëmarrje në vendimmarrjen e UT është garantuar në mënyrë efektive, kjo si në pikëpamje të akteve të brendshme rregulluese, ashtu dhe nga pohimet e studentëve, gjatë takimit të zhvilluar me ta. Emrat e studentëve, anëtarë të senatit, etj., mund të konsultohen lehtësisht në faqen zyrtare elektronike të institucionit (https://unitir.edu.al/senati-akademik/) si dhe në dokumentacion (*Evidenca 36; Evidenca 43*). Mendimet e studentëve mblidhen në mënyrë periodike dhe shqyrtohen nga institucioni me qëllim marrjen e masave për ndërmarrjen e veprimeve në të ardhmen (*Evidenca 42, pika 1*). Një prej studentëve është dhe anëtar i GVB (*RVB dhe Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*).<br><br>Në *RVB, f. 70*, vihet në dukje se, nëpërmjet përfshirjes në strukturat përkatëse, studentëve iu jepet mundësia që të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimit, rregulloret për veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve të ofruar, etj. Vlerësimi i rezultateve të mësimdhënies është pjesë e të dhënave që nxirren nga anketimet e studentëve për secilën lëndë e pedagog, |

| | |
|---|---|
| | anketime të cilët zhvillohen në mënyrë periodike (*Evidenca 31, aneksi 3*). |
| **Kriteri 3.**Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | UT ka garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në statutin e institucionit. Nga pikëpamja e realizimit të kriterit, studentëve u jepet mundësia të shprehen mbi elementet e programit të studimit (*Evidenca shtesë "Paketa e instrumenteve"; Evidenca "Model pyetësor studenti"*), mendime të cilët merren në shqyrtim nga strukurat përgjegjëse të institucionit, që shpie në rishikim apo përmirësim të këtyre elementeve (*Evidenca 1, neni 140; Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 33*).<br><br>Përfshirja në këtë proces garantohet dhe nga Këshilli Studentor (*Evidenca 1, nenet 130-132*), veprimtaria e të cilit iu bëhet e njohur studentëve dhe online: https://unitir.edu.al/keshillat-e-studenteve/. |
| **Kriteri 4.**Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Pika 12 e Rregullores së programit të studimit përcakton në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentit nga pedagogu i lëndës. Në këtë akt rregullohet dhe procedura e ankimimit të vlerësimit, nënpikat 12.20 dhe 12.21, sipas të cilave studenti ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimimit për çdo shkelje të pretenduar të të drejtave të tij (*Evidenca 4*). Studenti ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe ka të drejtën e ankimimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve (*Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022", neni 62*), por ky afat nuk përmendet në rregulloren e programit. Nga dokumentacioni (*RVB*), si dhe nga vizita në institucion, nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë proces të ezauruar në të gjitha shkallët përkatëse lidhur me procesin e vlerësimit të dijes, pasi çdo pretendim i studentëve që kanë pasur të tillë, është sqaruar nga pedagogu i lëndës (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji", takimet me stafin akademik, studentët dhe vizita në sekretarinë mësimore*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e UT dhe përfaqësohen në senat, Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisionin e përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisionin e përhershëm të kurrikulës, Këshillin e etikës, Këshillat e Studentëve.*<br>- *Nëpërmjet përfshirjes në strukturat përkatëse, studentëve iu jepet mundësia që të shprehin mendime dhe propozime për* |

| | |
|---|---|
| | *programet e studimit, rregulloret për veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve të ofruar, etj. Vlerësimi i rezultateve të mësimdhënies është pjesë e të dhënave që nxirren nga anketimet e studentëve për secilën lëndë e pedagog, anketime të cilët zhvillohen në mënyrë periodike.*<br>- *Aktet e brendshme rregullatore përcaktojnë në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentit nga pedagogu i lëndës si dhe procedurën e ankimimit të vlerësimit, ku studenti ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimimit për çdo shkelje të pretenduar të të drejtave të tij.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Institucioni ka hartuar procedura e ngritur njësi të posaçme në drejtim të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve, sipas rregullimeve të bërë në statut, rregulloren e përgjithshme, në nivel qendror dhe të njësisë kryesore (*Evidenca 1, neni 44; Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022"; Evidenca 4*), me të cilat studenti njihet në mënyrë të përgjithshme në momentin e regjistrimit në programin e studimit (*Evidenca 8*) si dhe nëpërmjet veprimtarisë së zyrave përkatëse (*Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 14*).<br><br>Informimi dhe shërbimi ndaj studentit realizohet nga sekretaria mësimore, në nivel njësie, si dhe një rol mjaft të rëndësishëm në këtë aspekt luan dhe departamenti gjatë periudhës së studimeve (*RVB, f. 71*). Përmes departamenteve që mbulojnë këtë program studimi, studentëve iu sigurohet një tutor institucional, i cili ofron udhëheqje dhe këshillim të vazhdueshëm gjatë periudhës së studimeve, sidomos në lidhje me përgatitjen e temës së diplomës (*Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022"*). Gjithashtu, informacionin e nevojshëm dhe zyrat që realizojnë shërbimet |

| | |
|---|---|
| | përkatëse janë të publikuara dhe në faqen online të FDUT: https://fdut.edu.al/njoftime/.<br><br>Faqja zyrtare e UT-së për këtë pjesë të informacionit për studentët (https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/) është në ndërtim e sipër.<br><br>Vlerësohet që në aktet e brendshme të FDUT-së, të ketë përcaktime të mirëfillta lidhur me njësitë e posaçme për informimin dhe shërbimin e studentëve, në mënyrë që ata të orientohen lehtësisht në këtë drejtim. |
| **Kriteri 2.**Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Gjatë takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, konstatohet që ata marrin këshillimin dhe mbështetjen e nevojshme përgjatë kohëvazhdimit të procesit mësimor të programit të studimit (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). Institucioni ka ngritur një sistem të posaçëm për këtë qëllim, ku rol kryesor luan departamenti dhe stafi akademik, koordinatori, zyrat e administratës së IAL, Zyra e karrierës dhe orientimit studentor, të cilët udhëzojnë studentët mbi anën akademike dhe administrative të procesit, zgjedhjen e lëndëve, ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore (*Evidenca 4; Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 14*).<br><br>Platformat e komunikimit janë të larmishme dhe synojnë shkëmbimin e saktë dhe të shpejtë të informacioneve të ndryshëm, përmes faqes zyrtare të IAL *online*, rrjeteve sociale të komunikimit dhe postës elektronike (*Evidenca 1, nenet 85-86*). Përgjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, UT ka miratuar platformën elektronike e-learning dhe udhëzuesin e nevojshëm, e cila është përdorur gjatë gjithë procesit të mësimdhënies (*Evidenca shtesë "Manual Perdorimi Microsoft teams"; Evidenca shtesë "Rregullore e posaçme për procedurën e zhvillimit të provimeve online"; Evidenca shtesë "Udhëzues mësimdhënia në distancë"*). |
| **Kriteri 3.**Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar | Ndër njësitë e ngritura brenda strukturës së rektoratit të UT-së është Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët, sipas nenit 14 të Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit (*Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat"*). |

| | |
|---|---|
| informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Sektori i marrëdhënieve me studentët në këtë drejtori, në rektorat, ka për detyrë të mbulojë organizimin e jetës studentore, mbikëqyrjen dhe nxitjen e eventeve kulturore, sportive, mjedisore, etj., për të krijuar gjallëri dhe aktivizim mes të rinjve. FDUT bashkëpunon me këtë strukturë në lidhje me karrierën dhe orientimin e studentëve për programet e studimeve që ofrohen prej kësaj njësie si dhe ka ngritur zyrën për këshillimin dhe çështjet studentore në nivel fakulteti. Zyra në fjalë ndihmon studentët që të kuptojnë pikat e tyre të forta akademike dhe rritjen e potencialit të të nxënit, të nxitë të mësuarit gjatë gjithë jetës, të lehtësojë procesin e rritjes së dijeve duke krijuar një mjedis mbështetës dhe bashkëpunues midis studentëve, personelit akademik dhe personelit mbështetës (*Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 14; Evidenca 24; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). Të dhënat mbi këtë zyrë mund të aksesohen online, në faqen zyrtare të IAL, janë në ndërtim e sipër: https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/.<br><br>***Mirëorganizimi i punës së kësaj zyre do të mund të realizohej dhe nga miratimi i një rregulloreje të posaçme për funksionimin e saj si dhe të planveprimit, gjë e cila nuk është kryer, ndaj GVJ sugjeron miratimin e këtyre akteve.***<br><br>Pedagogët e departamenteve përgjegjës dhe koordinatori i programit udhëzojnë studentët çdo fillim viti akademik dhe semestri mbi anën akademike të procesit, lëndët, ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore (*Evidenca 4*). Institucioni siguron gjithashtu këshillimin për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët. Në përfundim të saj, studentët vlerësojnë mënyrën e kryerjes së praktikës, me anë të formularit që plotësohet për këtë qëllim, aktivitet për të cilin vlerësohen dhe nga pedagogu mbikëqyrës (*Evidenca shtesë "Rregullore UT 2022", neni 66; Evidenca 10.3.1; Evidenca 23*).<br><br>Rregullat për kryerjen e praktikës janë përcaktuar në rregulloren e programit (*Evidenca 4, pika 12.24*). Institucioni ka lidhur disa marrëveshje me institucione publike, ku ata planifikohet të zhvillojnë praktikën profesionale (*Evidenca 22; Evidenca 22.1*). |
| **Kriteri 4.**Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna | FDUT, nëpërmjet këtij programi studimi, synon të aftësojë studentët që të përballen me tregun e punës si dhe të jetë i përditësuar për të qenë në koherencë me nevojat e tregut të punës për specialistë në fushën e kriminologjisë (*Evidenca 4*). |

| | |
|---|---|
| mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Si rregull, në çdo IAL është zyra e karrierës, ajo që siguron të dhëna për studentët, për fazën pas diplomimimit të tyre lidhur me mundësitë për zënie me punë.<br><br>Në nivel qendror, rezulton të ketë pranë rektoratit të UT-së një sektor për marrëdhënien me studentët që shërben si zyrë karriere dhe orientimi studentor (*Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 14*).<br><br>FDUT ka një zyrë të tillë në strukturën e tij (https://fdut.edu.al/zyra-e-karrieres/); zyra, ndër synimet e saj ka dhe ruajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar në vite (alumni), për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin, si promovues të vlerave të tij (*Evidenca 2*).<br><br>Për shkak se programi është i ri, nuk ka të dhëna për punësimin e studentëve, pasi nuk ka të tillë, të diplomuar.<br><br>Faqja *online* e institucionit, e cila duhet të paraqesë të dhëna të tjera mbi veprimtarinë e kësaj zyre, mbi alumni-t, mundësitë për punësim, etj., është në ndërtim: https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/. |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>- *Institucioni ka hartuar procedura e ngritur njësi të posaçme në drejtim të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve, sipas rregullimeve të bërë në statut, rregulloren e përgjithshme, në nivel qendror dhe të njësisë kryesore, me të cilat studenti njihet në mënyrë të përgjithshme në momentin e regjistrimit në programin e studimit si dhe nëpërmjet veprimtarisë së zyrave përkatëse.*<br><br>- *Sektori i marrëdhënieve me studentët në rektorat ka për detyrë të mbulojë organizimin e jetës studentore, mbikëqyrjen dhe nxitjen e eventeve kulturore, sportive, mjedisore, etj., për të krijuar gjallëri dhe aktivizim mes të rinjve. FDUT bashkëpunon me këtë strukturë në lidhje me karrierën dhe orientimin e studentëve për programet e studimeve që ofrohen prej kësaj njësie si dhe ka ngritur zyrën për këshillimin dhe çështjet studentore në nivel fakulteti. Zyra në fjalë ndihmon studentët që të kuptojnë pikat e tyre të forta akademike dhe rritjen e potencialit të të nxënit, të nxitë të mësuarit gjatë gjithë jetës, të lehtësojë procesin e rritjes së dijeve duke krijuar një* |

| | |
|---|---|
| | *mjedis mbështetës dhe bashkëpunues midis studentëve, personelit akademik dhe personelit mbështetës.*<br>- *Zyra, ndër synimet e saj, ka dhe ruajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar në vite (alumni), për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin, si promovues të vlerave të tij. Për shkak se programi është i ri, nuk ka të dhëna për punësimin e studentëve, pasi nuk ka të tillë, të diplomuar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni harton udhëzues në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Mësimdhënia në këtë program studimi bëhet sipas standardeve të vendosura nga institucioni në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Gjithashtu, institucioni ka hartuar dhe përdor udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, ku përfshihet edhe informacion mbi mësimdhënien. Programi ofron një kombinim midis leksioneve dhe seminareve. Pedagogët kanë liri akademike në përcaktimin e përmbajtjes së syllabus-eve në përputhje me objektivat e programit të studimit; gjithashtu edhe për metodën e përshtatshme të mësimdhënies (*Evidenca 33*).<br>Siç është përmendur dhe më lart, një nga format e kontrollit të cilësisë së mësimdhënies është përmes anketave/vlerësimeve të studentëve për pedagogët të cilat zhvillohen në përfundim të lëndës. |

| | |
|---|---|
| | Format kryesore të mësimdhënies për këtë program studimi janë leksionet dhe seminaret dhe orët praktike (*Evidenca 4*).<br><br>Përmirësimi i mësimdhënies nëpërmjet metodave të ndryshme dhe inovative, është një ndër objektivat kryesorë strategjikë të UT (*Evidenca 2, pika 1*). Institucioni ka miratuar broshurën informuese mbi programin e studimit, një dokument orientues lidhur me institucionin, shërbimet në dispozicion të studentit, zyrat përkatëse, rregullat akademike, çështje adminsitrative dhe të lidhura me programin e studentit (si regjistrimi i lëndëve, metodat e vlerësimit, sezoni i provimeve, diplomimi, procedurat ankimore etj.) (*Evidenca 6*). |
| **Kriteri 2.**Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike, aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Rregullorja e programit të studimit përmban rregullat e funksionimit të këtij programi dhe të marrëdhënieve që krijohen ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në veprimtaritë e tyre. Ajo përcakton strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të programeve të studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, raportet ndërmjet tyre, etj. (*Evidenca 4*).<br><br>NJSBC, si strukturë e ngritur me qëllim vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë në vlerësimet periodike, përfshin edhe vlerësimin e pedagogut nëpërmjet anketimeve të studentëve mbi metodologjitë e mësimdhënies. Po ashtu, departamenti ka ngritur edhe grupin e sigurimit të cilësisë për bashkëpunimin dhe bashkërendimim me strukturat institucionale për garantimin e cilësisë (DSC), duke përfshirë këtu edhe monitorimin periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësive mësimdhënëse të tij. Rezultatet e monitorimeve përfshihen në raportin vjetor që bëhet në fund të çdoviti në departament si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë (*Evidenca 24; Evidenca 31; Evidenca 39; Evidenca 42*). |
| **Kriteri 3.**Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Në bazë të nenit 141 të statutit të UT-së, studentëve iu jepet mundësia për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies çdo vit, nëpërmjet pyetësorëve që realizohen në fund të zhvillimit të çdo semestri, duke ruajtur anonimatin. Pyetësorët përfshijnë pyetje mbi pedagogun, metodën e mësimdhënies, nivelin e përgatitjes, literaturën, përmbajtjen e lëndës, etj, si dhe për asistencën nga stafi administrativ. Gjetjet, pasi përpunohen, analizohen me qëllim përmirësimin e cilësisë (*Evidenca 1; Evidenca 39; Evidenca 2, pika 1.2*). |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.**Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Pas përpunimit statistikor dhe cilësor të të dhënave, ato shfrytëzohen për vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik. DSC informon gjithashtu dekanin dhe përgjegjësin e departamentit rreth rezultateve të dala, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe stafit akademik në të ardhmen. Në përfundim të këtij procesi, KPSC harton një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të institucionit ose/dhe të programit të studimit, përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë. Ky raport i bëhet me dije Senatit Akademik, i cili pasi e merr në shqyrtim, e miraton (*Evidenca 1, nenet 140, 141; Evidenca 42, pika 1*).<br><br>Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit: https://unitir.edu.al/akreditimi-i-programve-te-studimit-te-ut-se/. |
| **Kriteri 5.**Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Megjithëse nuk u përcoll ndonjë model i vlerësuar si shembull i një praktike të mirë, sipas shpjegimeve të marra gjatë vizitës, rezultatete nxjerra përpunohen nga NJSBC-ja qendrore si dhe KPSC, duke vlerësuar nevojën për të zhvilluar më tej aspekte të veçantë të performancës në institucion. Mbi bazën e këtyre gjetjeve, KPSC harton planin e trajnimeve tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies apo në funksion të përmirësimit të cilësisë (*Evidenca 1, nenet 139, 140; Evidenca 31; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Institucioni ka ngritur strukturat e duhura, përmes së cilave realizon kontrollin e performancës së stafit akademik. Ky proces mundësohet përmes vlerësimit në katër drejtime: vlerësimit nga studentët, vlerësimit nga kolegët, vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit dhe vetëvlerësimi.*<br>- *Institucioni ka hartuar dhe përdor udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, ku përfshihet edhe informacion mbi mësimdhënien.*<br>- *Rregullorja e programit të studimit përcakton strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të programeve të studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, raportet ndërmjet tyre, etj.* |

| | |
|---|---|
| | - *Pas përpunimit statistikor dhe cilësor të të dhënave, këto të fundit shfrytëzohen për vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Sipas përcaktimeve ligjore të nenit 103 e vijues të ligjit Nr. 80/2015, UT ka bërë parashikime në aktet e brendshme rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, përkatësisht në nenet 41 dhe 138-141 të statutit (*Evidenca 1*).<br><br>Sipas nenit 13 të Rregullores së përgjithshme, sektori i sigurimit të cilësisë përfshihet në strukturën e administratës qendrore (*Evidenca shtesë"Rregullore UT 2022", neni 30/4; Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 11*).<br><br>Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit. Komisioni, për përmbushjen e këtij objektivi, bashkërendon dhe bashkëpunon me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohet në statut dhe në rregulloren e tij (*Evidenca 1, neni 41*).<br><br>Në përputhje me parashikimet e nenit 42/4 të statutit të UT, GVJ konstatoi se institucioni ka hartuar Projekt-Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (*Evidenca shtesë 3*).<br><br>Sipas nenit 141 të statutit, në njësitë kryesore të UT-së krijohen dhe funksionojnë njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC). Mënyra e funksionimit të NJSBC-ve në njësitë kryesore të UT-së përcaktohet në rregulloret e tyre të brendshme. |

| | |
|---|---|
| | Sipas akteve shtesë të sjellë nga FDUT, konstatohet që senati akademik ka miratuar rregulloren për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në Universitetin e Tiranës. Në përputhje me këto parashikime, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional. Detyrat e njësive lidhen me garantimin e plotësimit të standarteve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit. Institucioni ka hartuar dokumentet përkatës që mundësojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"; Evidenca shtesë "Paketa e instrumentave"; Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve"*). |
| **Kriteri 2.**Institucioni ka ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, si dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë, bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Lidhur me sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, në nivel institucional, me vendimin Nr. 43, datë 7.12.2020 të senatit akademik të UT-së është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, ku tre prej anëtarëve janë përfaqësues të studentëve (*Evidenca 36*). Grupi i vlerësimit të cilësisë funksionon dhe në nivel njësie kryesore, FDUT (*Evidenca 24*), ku një prej anëtarëve vjen nga radhët e studentëve. Rëndësia që i ka dhënë IAL strategjisë nuk shprehet vetëm në mënyrë të përgjithshme në statutin e institucionit, por politika të detajuara janë shprehur në rregulloren për sigurimin e brendshëm të cilësisë (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT*).<br><br>Në këtë proces dhe struktura, sikundër u vu në dukje në paragrafët më lart, janë përfshirë dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, neni 139/1, germa dh, i statutit të UT-së (*Evidenca 2*).<br><br>Nga aktet dhe gjatë vizitës në institucion rezultoi që departamentet që mbulojnë këtë program studimi bashkëpunojnë me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, si organizëm që mundëson ofrimin e programit të studimit Master Ekzekutiv në Kriminologji, gjatë procesit mësimor si dhe në hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm (*Evidenca shtesë 7; Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji*). |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë të institucionit të arsimit tëlartë, realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Institucioni përdor instrumente e metoda të ndryshme për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucionit, të cilat janë detajuar në dokumentin që parashikon instrumentet për kryerjen e këtyre vlerësimeve (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 31/2; Evidenca shtesë "Paketa e instrumenteve"*).<br><br>Në përputhje me rregulloren për sigurimin e cilësisë, UT e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Në këtë dokument, institucioni ka qartësuar parime dhe standarde konkrete në shërbim të krijimit të një sistemi efikas për sigurimin e cilësisë. Parashikohet se institucioni duhet t'i nënshtrohet sigurimit të jashtëm të cilësisë në baza ciklike, në përputhje me standardet dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 5/5, neni 6, neni 7).*<br><br>Në mënyrë periodike, institucioni realizon vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë, standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në vijim të të cilëve merr masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", nenet 30, 33*).<br><br>Njësia e sigurimit të cilësisë në nivel universiteti, ndër të tjera, bashkëpunon me ASCAL për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e UT-së (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 21/2, germa k*).<br><br>Gjithashtu, institucioni ka zhvilluar një sërë veprimtarish në funksion të aftësimit të stafit për procesin e sigurimit të cilësisë (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën | Në nenet 138 e 139 të statutit, UT ka përcaktuar politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit (*Evidenca 1*), të shtjelluara në mënyrë të hollësishme dhe në rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe atë të organizimit dhe funksionimit të NJSBC-ve të njësive kryesore (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"; Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve"*).<br><br>Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas parashikimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. |

| | |
|---|---|
| promovime nxitëse për arritjet më të mira. | Njësia e Sigurimit të Cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo njësi organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit. Të dhënat e nxjerra nga këta pyetësorë përdoren gjatë procesit të vlerësimit të performancës akademike të çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik, po ashtu dhe në raport me lëndët e programit që ndjekin si dhe të shërbimeve të ofruar nga FDUT. Mbi bazën e të dhënave të marra nga pyetësori studentor dhe informacioneve të tjerë, hartohet raporti i vlerësimit vjetor (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", nenet 21, 26, 30 dhe 13/1, germa l; Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", nenet 13-14; Evidenca 31*).<br><br>Në përfundim të vitit akademik, departamenti harton raportin vjetor, ku përfshihen të dhëna përshkruese si dhe sasiore mbi programin e studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e studentëve, kalueshmërinë dhe notën mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, të dhënat mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore si dhe masat për t'u ndërmarrë në të ardhmen (*Evidenca 42*).<br><br>Në këtë mënyrë, kontrolli mbi cilësinë nis nga niveli bazë e më pas kalon në rang institucional, duke përfshirë të gjithë hallkat e IAL.<br><br>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë ndërmjetëson, harton dhe jep raporte për aktivitete dhe nisma të reja që lidhen me sigurimin e cilësisë për të gjitha njësitë e UT-së si dhe realizon koordinimin e procesit të brendshëm të cilësisë. Funksionimi i Komisionit, si rregull, duhet të rregullohet nga Rregullorja përkatëse, e hartuar dhe miratuar në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, e cila është hartuar dhe duhet të miratohet (*Evidenca shtesë 3*).<br><br>Përgjegjësitë kryesore të Komisionit kanë të bëjnë me:<br>- Hartimin e planit të zhvillimit institucional për sigurimin e cilësisë;<br>- Vlerësimin për herë të parë të programeve të reja që do të ofrohen;<br>- Vlerësimin në vazhdimësi të programeve që ofrohen nga UT nëse janë në përputhje me standardet e cilësisë si dhe koherencën e tyre; |

| | |
|---|---|
| | - Bashkëpunimin me ASCAL në rast akreditimi apo vlerësimi të cilësisë;<br>- Vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore në njësitë kryesore/degët e UT-së, në përputhje me standardet e cilësisë dhe hartimin e raporteve përkatës të vlerësimit të brendshëm;<br>- Ndjekjen e politikave të hartuara nga senati akademik për sigurimin e cilësisë dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre;<br>- Hartimin dhe organizimin çdo fund semstri për studentët pyetësorin për cilësinë e mësimdhënies në të gjithë programet e ofruar nga UT;<br>- Realizimin e studimeve gjurmuese lidhur me ecurinë e punësimit të studentëve pas formimit të tyre akademik dhe efikasitetin e programeve të orfruar;<br>- Raportimin para senatit akademik për rezultatet e vlerësimit dhe propozimin e nismasve për përmirësimin e standardeve të cilësisë;<br>- Bashkëpunimin me agjenci të huaja të sigurimit të cilësisë, anëtare të Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (*Evidenca 1, neni 140*).<br>Rregullorja e cilësisë dhe paketa e instrumenteve të cilësisë, në këtë drejtim, sigurojnë parashikimin e procedurave që do të ndiqen si dhe japin modelet për secilin prej formularëve të vlerësimit (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"; Evidenca shtesë "Paketa e instrumenteve"*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Në përputhje me parashikime ligjore të aplikueshme, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional dhe të secilës njësi kryesore. Detyrat e njësive lidhen me garantimin e plotësimit të standarteve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit.*<br>- *Institucioni ka hartuar dokumentet përkatës që mundësojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë.*<br>- *Për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm përdoren instrumente e metoda të ndryshme, të cilat janë detajuar në dokumentin që parashikon instrumentet për kryerjen e këtyre vlerësimeve.* |

| | |
|---|---|
| | - *Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas parashikimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve, dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UT planifikojnë dhe organizojnë vlerësimin e brendshëm të cilësisë si për programet e studimit, ashtu dhe për institucionin (*Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve"*). Kryerja e procedurave, përmes mekanizmave të përcaktuar nga këto struktura, bëhet në mënyrë periodike mbi programin e studimit.<br><br>Drejtimet e vlerësimit janë të ndarë sipas zërave përkatës në rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe përfshijnë vlerësimet e studentëve, vlerësimet e personelit akademik, formën individuale të vlerësimit të performancës së pedagogëve, formën e transparencës së notave, vlerësimin në raportet vjetore mbi procesin e të mësuarit dhe standardet përkatëse të cilësisë të departamentit në fund të vitit akademik (*Evidenca 30; Evidenca 33; Evidenca 6.1, pika 3*).<br><br>Në nivel njësie dhe të programit të studimit, syllabus-et e lëndëve rishikohen kur vlerësohet e nevojshme (*Evidenca 4, pika 9*). Kur është e nevojshme, rekomandohen masa për ndryshimin, rishikimin ose përmirësimin e elementeve të këtij programi. Brenda programit të studimit mund të bëhen ndryshime deri në masën 20% të përmbajtjes. Propozimi i argumentuar bëhet nga departamenti i këtij programi studimi dhe përcillet në rektorat nga dekani i fakultetit, ku merret në shqyrtim dhe vlerësohet nga Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, që është dhe struktura përgjegjëse për të kryer këtë vlerësim. Ndryshimet në planin mësimor realizohen me vendim të senatit akademik, duke njoftuar në vijim Ministrinë e Arsimit jo më vonë se gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik |

| | |
|---|---|
| | (*Evidenca 4, neni 9; Evidenca 1, neni 42/1, neni 105; Evidenca shtesë 5; Evidenca shtesë "Rregullore funksionimi administrata Rektorat", neni 11 dhe lidhja 3*).<br><br>Në aktet e brendshëm për sigurimin e cilësisë, institucioni ka parashikuar shfrytëzimin e metodologjive të vlerësimit, instrumenteve të matjes dhe vlerësimit për programet e studimit (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"*). Instrumentet paraqiten në mënyrë të detajuar në paketën përkatëse, të miratuar nga senati akademik i UT-së (*Evidenca shtesë "Paketa e instrumenteve"*). Në tërësi këto mjete përdoren nga Komisioni për sigurimin e cilësisë, NJSC në nivel qendror dhe NJSBC e njësive kryesore, me qëllim përgatitjen e raportit vjetor institucional, ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruar studentëve si dhe masat e rekomanduara në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Raporti në fjalë i paraqitet senatit akademik të UT-së (*Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", neni 14*).<br><br>Mekanizmat e përdorur janë pyetësorë dhe vlerësime të studentëve, fokus grupe me studentët, procesi i vlerësimit të anëtarëve të personelit akademik, procesi i vetëvlerësimit të pedagogëve, raporte vjetore të FDUT-së, etj. (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 31; Evidenca shtesë "Paketa e instrumenteve"; Evidenca 39*). Në përfundim të procesit të vlerësimit, si në rang departamenti, ashtu dhe institucional, të dhënat e grumbulluara përpunohen dhe dokumentohen në aktet e mbajtur për këtë qëllim, të cilët më pas dërgohen në instancat përgjegjëse për vendimmarrje të mëtejshme (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 16/1, germa g; Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", neni 14*).<br><br>Në mënyrë më të detajuar:<br><br>- Në rastin kur propozohen ndryshime në programin e studimit (kurrikulat), informacioni shkresor dërgohet pranë zyrës së kurrikulave dhe komisionit për kurrikulat dhe mësimin. Nëse vlerësohen ndryshimet e kurrikulave, akti përkatës i dërgohet për miratim senatit (*Evidenca 4; Evidenca 1, neni 42/1; Evidenca shtesë 5*).<br><br>- Në nivel institucional, të dhënat e vlerësimit NJSBC e njësisë bazë i përpunon dhe i dërgon pranë NJSBC në nivel njësie |

| | |
|---|---|
| | kryesore, bashkë me rekomandimet përkatës. Më pas, kjo njësi, brenda afateve të caktuar ia përcjell të dhënat NJSBC së UT, e cila harton raportin e vlerësimit institucional, të cilin ia kalon për shqyrtim Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Ky i fundit, më pas e përcjell në Senat, me qëllim marrjen e vendimeve në funksion të përmirësimeve të nevojshme (*Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", neni 14).*<br><br>Hartimi i raportit dhe procedurat për njohjen me të nga autoritetet përgjegjëse janë shtjelluar në rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve në njësitë kryesore (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"; Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve"*).<br><br>Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit: https://unitir.edu.al/akreditimi-i-programve-te-studimit-te-ut-se/. |
| **Kriteri 2.**Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Në aktet për sigurimin e cilësisë janë përcaktuar elementet që duhet të përmbajë raporti vjetor i vlerësimit. Raporti duhet të përmbajë dhe të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin nga ai. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga aktorë të ndryshëm, duhet të përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik (*Evidenca 31*). Në nivel departamenti, në raportin vjetor të departamentit, bëhet një përshkrim i rezultatevetë vlerësimeve, por nuk është hartuar një plan veprimi për masat e marra për adresimin e mangësive për vitin pasardhës akademik (*Evidenca 42*).<br><br>Përfundimet e nxjerrë nga raporti vjetor institucional shërbejnë për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit (*Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", nenet 5/4; 8, 9, 14; Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 33*). |
| **Kriteri 3.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i | Metoda të drejtpërdrejta, të përmendura shprehimisht në rregulloren për sigurimin e cilësisë, nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 31*). Si metoda të tilla përmenden vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, syllabuseve, rezultatet e të |

| | |
|---|---|
| cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ orëve praktike, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | nxënit, testet. Sipas *RVB, f. 78*, UT përfshin të dhënat e raporteve semestrale si p.sh. përqindjen e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit (*Evidenca 42*).<br><br>Metoda të tjera në këtë drejtim janë përmendur në*f. 78 të RVB* për promovimin e mësimdhënies: informacioni nga raporti vjetor për ndryshimet e propozuara të kurrikulës, të dhënat statistikore mbi kalueshmërinë dhe mesataren e studentëve, pyetësorët me studentët (*Evidenca 39*).<br><br>Departamenti shqyrton dhe vlerësimet që bëhen në përmbyllje të praktikës mësimore, nëpërmjet formularëve që plotësohen për këtë qëllim (*Evidenca 4; Evidenca 30*). |
| **Kriteri 4.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të të diplomuarve, të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësve e të institucioneve që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera, që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Metoda të tërthorta të përmendura shprehimisht në rregulloren për sigurimin e cilësisë nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë.<br><br>Si metoda të tërthorta rezultojnë të përdoren: vlerësimet e drejtuesve; vlerësimet e ekspertëve, vlerësimet e studentëve; vlerësimet e të diplomuarve; vlerësimet e bashkëpunëtorëve; vlerësimet e punëdhënsve; të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve, e plotësimit të formularëve të vlerësimit, intervistave, fokus grupeve, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve, të diplomimit (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 1, germat d-j; Evidenca shtesë "Paketa e instrumenteve"; Evidenca 39*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br><br>- *Në aktet e brendshëm për sigurimin e cilësisë, institucioni ka parashikuar shfrytëzimin e metodologjive të vlerësimit, instrumenteve të matjes dhe vlerësimit për programet e studimit.* |

| | |
|---|---|
| | - *Instrumentet dhe metodat e drejtpërdrejta e të tërthorta paraqiten në paketën përkatëse, të miratuar nga senati akademik i UT-së.Mekanizmat e përdorur janë pyetësorë dhe vlerësime të studentëve, fokus grupe me studentët, procesi i vlerësimit të anëtarëve të personelit akademik, procesi i vetëvlerësimit të pedagogëve, raporte vjetore të FDUT-së, etj.*<br>- *Në tërësi këto mjete përdoren nga Komisioni për sigurimin e cilësisë, NJSC në nivel qendror dhe NJSBC e njësive kryesore, me qëllim përgatitjen e raportit vjetor institucional, ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruar studentëve si dhe masat e rekomanduara në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Raporti në fjalë i paraqitet senatit akademik të UT-së.*<br>- *Përfundimet e nxjerrë nga raporti vjetor institucional shërbejnë për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personeli akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë, përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm siç janë Bordi i Programit, ekspertë të fushës, përfaqësues të organizatave bashkëpunuese apo edhe përfaqësues të industrisë, të interesuar për | Institucioni, në aktet e tij të brendshëm dhe në politikat e procedurat e brendshme të cilësisë, ka parashikuar dhe figurat që përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë proces janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, por dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve (*Evidenca 1, neni 41; Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", kreu III; Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", neni 13*).<br><br>Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, sipas përcaktimeve statutore (*Evidenca 1, neni 139/1, germa dh*) dhe në rregulloren për organizimin dhe |

| | |
|---|---|
| sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | funksionimin e NJSBC-ve të njësive kryesore (*Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", neni 6/4*). |
| **Kriteri 2.**Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë, së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Institucioni, në vijim të parashikimeve ligjore të aplikueshme, ka përcaktuar detyrat që duhet të përmbushen nga personat e angazhuar në sistemin e brendshëm të cilësisë, të nivelit bazë dhe institucional.<br><br>Detyrat dhe përgjegjësitë janë përmendur në nenet 140 e 141 të statutit (*Evidenca 1*), në kreun III të Rregullores përsigurimin e cilësisë (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"*), si dhe në kreun II të rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njësive kryesore (*Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve"*). Ndërkohë, për sigurimin e cilësisë në nivel të njësisë, FDUT, nuk ka parashikime në aktet e brendshme të njësisë kryesore (p.sh., Rregullorja e fakultetit nuk figuron në dokumentacionin e vënë në dispozicion) apo atë të programit të studimit.<br><br>Nga shqyrtimi i rregullimeve të brendshme konstatohet që, formalisht, ushtrimi me përgjegjësi i detyrave në drejtim të sigurimit të cilësisë, është i garantuar (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 16/1, germa d*), por ***GVJ sugjeron detajimin e përgjegjësive dhe detyrave në aktet e brendshme të FDUT-së lidhur me njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, sikundër është parashikuar në statut dhe në rregulloret në fushën e sigurimit të cilësisë.*** |
| **Kriteri 3.**Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve tëprogramit të studimit. | Në përputhje me rregullimet e bëra nga statuti i UT-së, neni 41, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë gjithsej 11 anëtarë, të cilët duhet të jenë të paktën një përfaqësues nga secili fakultet i UT-së, një përfaqësues nga strukturat e sigurimit të cilësisë në rektorat, një përfaqësues nga institutet/degët, tre përfaqësues nga studentët (*Evidenca 1*). NJSBC e UT-së përbëhet nga 9 anëtarë, ku përfshihen personel akademik i secilit fakultet dhe ISE me kohë të plotë, 1 anëtar i jashtëm (ekspert) dhe një përfaqësues i Këshillit Studentor. NJSBC në nivel njësie kryesore ka në përbërje një anëtar nga stafi akademik me kohë të plotë i çdo njësie bazë, një anëtar personel ndihmës-akademik dhe një student. Në nivel njësie bazë, NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, që përfshijnë tri përfaqësues nga personeli akademik me kohë të plotë, një personel ndihmës-akademik dhe një student (*Evidenca shtesë* |

| | |
|---|---|
| | *"Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", neni 6*).<br><br>***GVJ vëren se në nivel njësie kryesore NJSBC nuk ka anëtar të jashtëm që përfshihet në proceset e vlerësimit të cilësisë. GVJ sugjeron që të përfshihet një i tillë.***<br><br>Stafi akademik dhe administrativ marrin përsipër rolin kryesor në zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe NJSBC në nivel qendror dhe njësie, duke siguruar përgjegjësinë institucionale. Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces janë të informuar për rëndësinë e procesit të akreditimit dhe hapat që duhen ndjekur në rregulloret përkatëse (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"*).<br><br>Senati ka përgjegjësinë finale për miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 13*). |
| **Kriteri 4.**Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit, duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie, kundrejt personelit dhe studentëve. | Sipas përcaktimeve statutore dhe rregullores së nxjerrë për këtë qëllim, vlerësimi i brendshëm i cilësisë konceptohet dhe zbatohet mbështetur në standardet profesionale, duke zbatuar parimin e pavarësisë institucionale. Struktura, roli dhe përgjegjësitë e sistemit dhe organeve të sigurimit të cilësisë bazohen në kornizën ligjore të aplikueshme dhe në organizimin e brendshëm të institucionit (*Evidenca 1, neni 139; Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 7*). Duke mbajtur parasysh dhe qëllimet e vlerësimit si dhe mënyrat e marrjes dhe administrimit të të dhënave, procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 8*). Ky fakt nuk rezultoi as gjatë takimeve me grupin e pedagogëve dhe të studentëve në institucion (*Evidenca shtesë "Minutat ME Kriminologji"*). |
| **Kriteri 5.**Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm, që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin | Sipas nenit 6 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njësive kryesore, një nga anëtarët e NJSBC, është ekspert i jashtëm në fushën e sigurimit të cilësisë, i caktuar me vendim të rektorit (*Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve"*).<br><br>Vlerësimi i brendshëm bazohet ndër të tjera, dhe në vlerësimet e ekspertëve (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 31/1,* |

| | |
|---|---|
| ekspertizë e mendime profesionale, në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | *germa e*). Në hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi, janë angazhuar dhe ekspertë të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, që ka mbështetur krijimin dhe vazhdimin e tij, duke bashkëpunuar ngushtësisht me FDUT-në (*Evidenca shtesë 7*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, si dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve.*<br>- *Në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm.*<br>- *Procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve.*<br>- ***GVJ sugjeron detajimin e përgjegjësive dhe detyrave në aktet e brendshme të FDUT-së lidhur me njësinë bazë të sigurimit të cilësisë.***<br>- ***GVJ sugjeron përfshirjen e një anëtari të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë, në NJSBC në nivel njësie kryesore.*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë transparente dhe bëhen publike për | Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të UT, janë transparente dhe mundësojnë parimisht akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo i interesuar (*Evidenca 1, neni 139; Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", neni 5*). Sipas përcaktimeve të nenit 32 të rregullores për sigurimin e cilësisë në UT, informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë është i përshtatshëm, i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet |

| | |
|---|---|
| studentët dhe të gjithë të interesuarit. | me një gjuhë të kuptueshme për të gjithë. Raportet e vlerësimit të brendshëm e të jashtëm bëhen publike. UT dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"*).<br><br>Neni 15 i rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njësive kryesore përcakton se publikimi i rezultateve të raporteve të vlerësimit është i detyrueshëm. Raporti i vlerësimit institucional, pas miratimit nga senati akademik publikohet në faqen zyrtare të UT-së dhe njësive kryesore. Publikimi i rezultateve të pyetësorit studentor bëhet nga NJSBC e UT-së brenda 30 ditëve nga hartimi i raportit përfundimtar, i cili publikohet në faqen zyrtare të UT-së dhe njësive kryesore (*Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve"*).<br><br>Raportet në fjalë gjenden në faqen elektronike të institucionit: https://unitir.edu.al/akreditim-i-ut-se/.<br><br>***GVJ, pas konsultimit me faqen zyrtare të FDUT-së konstatoi se detyrimi për publikimin e raporteve nuk është përmbushur prej saj, në cilësinë e njësisë kryesore, ndaj sugjerohet që të merren masa për publikimin e këtyre të dhënave, në përputhje me përcaktimet e neneve 5 e 32 të Rregullores për sigurimin e cilësisë në UT dhe të nenit 15 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njësive kryesore*** (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"; Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve"*). |
| **Kriteri 2.**Institucioni i arsimit të lartë, publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit nga institucioni qendror bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me aktet rregullatore të brendshme të UT-së. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të UT-së si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale (*Evidenca shtesë "Paketa e instrumenteve"; Evidenca 39*). Qëllimi i vlerësimit është paraqitja e të dhënave të sakta mbi programet e studimit dhe përmirësimi i këtyre të fundit. |
| **Kriteri 3.**Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e | Institucioni i përdor të dhënat që dalin nga vlerësimi i stafit akademik në funksion të rritjes së cilësisë së procesit akademik dhe në përgjithësi të cilësisë në rang universiteti. Të dhënat që rezultojnë nga pyetësorët, etj., shërbejnë për hartimin në vijim të planit të masave që duhen marrë në vijim nga strukturat drejtuese të |

| | |
|---|---|
| mangësive e dobësive të evidentuara. | universitetit në rang njësie kryesore (*Evidenca 39*) dhe në rang institucional. Të gjitha procedurat e sigurimit të cilësisë vlerësohen në periudha të rregullta dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i paraqiten Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Senatit, nëse ka nevojë për ndryshime institucionale në politikat dhe praktikat e miratuara. Raportet duhet të përfshijnë jo vetëm përshkrime, por dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë të përcaktuara në udhëzuesin mbi vlerësimin dhe zhvillimin e cilësisë. Vlerësimet programore dhe të departamenteve planifikohen për çdo vit akademik bazuar në rezultatet e proceseve të kryer për këtë qëllim.Aktet që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë vlerësohen në mënyrë periodike(*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT", nenet 16, 21 dhe 33*; *Evidenca shtesë "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve", neni 14*). |
| **Kriteri 4.**Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Përfshirja e rregullimeve specifike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave në rrjedhim të veprimtarive që monitorojnë vlerësimin e cilësisë nga ana e institucionit, tregon rëndësinë që universiteti i kushton këtij procesi. Sipas nenit 5 të rregullores për sigurimin e cilësisë, nëpërmjet procesit vlerësues synohet: kontrolli i cilësisë, vlerësimi i gjendjes së cilësisë dhe propozime për përmirësimin e saj (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"*).<br><br>Institucioni ka parashikuar procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë (*Evidenca 4; Evidenca 1, neni 42/1*). Në nivel njësie, FDUT ka hartuar raportin vjetor, ku ka bërë përshkrimin e situatës dhe performancën, një analizë të pikave të forta dhe të dobëta si dhe janë nxjerrë detyra që të mundësojnë përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë(*Evidenca 42*). |
| **Kriteri 5.**Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët, për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë, të | Sipas nenit 16/2 të rregullores për sigurimin e cilësisë në UT, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Stabdardeve të Cilësisë mund të formojë grupe të vegjël pune për të dhënë ekspertizë, këshilla ose për të tërhequr mendime për çështje të sigurimit të cilësisë (*Evidenca shtesë "Rregullore për SC në UT"*).<br><br>Rezulton nga të dhënat e vëna në dispozicion se institucioni ka organizuar veprimtari në vijimësi me personelin, por dhe me studentët, me qëllim që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar |

| | |
|---|---|
| cilësisë së programit të studimit. | për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi e më gjerë, në vazhdimësi. Kështu, sipas të dhënave të *f. 81 të RVB*-së, në fund të kontrolleve për të gjitha lëndët e semstrit, organizohet një takim i përbashkët i njësive kryesore dhe njësive bazë, përfaqësues të KPSC me studentët, ku ballafaqohen me mendimet dhe opinionet e secilit në lidhje me problematika dhe sugjerime të mundshme (*Evidenca 31*). |
| **Konkluzione** | *GVJ del ne konkluzione si më poshtë:*<br>- *Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të UT, janë transparente dhe mundësojnë parimisht akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo i interesuar.*<br>- *Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit nga institucioni qendror bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me aktet rregullatore të brendshme të UT-së. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të UT-së si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale.*<br>- *Në nivel njësie kryesore,* ***GVJ, sugjeron që të merren masa nga FDUT për publikimin e të dhënave lidhur me procesin e sigurimit të cilësisë****.*<br>- *Institucioni ka parashikuar procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë.*<br>- *Institucioni ka organizuar veprimtari në vijimësi me personelin, por dhe me studentët, me qëllim që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi e më gjerë, në vazhdimësi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të Tretë Master Ekzekutiv në "Kriminologji"**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Institucioni zotëron një përvojë të vlefshme në drejtim të ngritjes dhe zhvillimit të programeve të ciklit të tretë të studimeve, sic është programi në vlerësim, përvojë e cila siguron më së miri adresimin dhe përballimin e sfidave dhe vështirësive që mund të lindin;
2. Institucioni mbështet programin në vlerësim dhe në tërësi të gjithë veprimtaritë e tij akademike, shkencore e administrative mbi një strukturë të mirëorganizuar e funksionale, që është një tregues i rëndësishëm në drejtim të qëndrueshmërisë institucionale dhe të aktiviteteve që realizon;
3. Personeli akademik i angazhuar në këtë program, ka eksperiencë të gjatë në institucionet e arsimit të lartë apo në sektorin e drejtësisë, një faktor me rëndësi të vecantë për përmbushjen e objektivave në lidhje me cilësinë e programit të ofruar;
4. Institucioni mundëson kërkimin shkencor të personelit nëpërmjet financimit, krijimit të mundësive për pjesëmarrje në aktivitete shkencore dhe mobilitetin. Në funksion të kualifikimit në vijimësi të personelit, vlen sidomos Projekti i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri "Për krijimin e Masterit në Kriminologji" (2018-2023), i cili i kushton një vëmendje të rëndësishme komponentit të ngritjes së kapacitetit të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
5. Institucioni disponon ambiente me standardet e duhur për zhvillimin e programit të studimit, të pajisur me mjetet e përshtatshëm nga pikëpamja logjistike;
6. Biblioteka garanton një akses të bollshëm në literaturën e nevojshme të programit dhe fushës së drejtësisë në përgjithësi, si fizikisht ashtu edhe online;

**b. Pika të dobëta:**

1. Mungesa e planeve analitike periodike në lidhje me rezultatet dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera në funksion të realizimit të programit të studimit; ***(Standardi I.3, kriteri 4)***

2. Mungesa e politikëbërësve dhe përfaqësuesve të tregut të punës në përbërje të Bordit Këshillues të ngritur nga FDUT, ku bëjnë pjesë vetëm personel akademik dhe studentë, për realizimin e programit të studimit "Master Ekzekutiv në Kriminologji; ***(Standardi II.2, kriteri 4)***
3. Mungesa e marrëveshjeve me institucione të tillë si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Spitale Psikiatrike si dhe institucione të tjerë, ku mund të realizohen praktika në lidhje me probleme të caktuara e specifike kriminologjike, në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi; ***(Standardi IV. 2, kriteri 7)***

**Rekomandime**

1. FDUT duhet të realizojë plane analitike periodike në lidhje me rezultatet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera në funksion të realizimit të programit të studimit;
2. Përfshirja e politikëbërësve dhe përfaqësuesve të tregut të punës në përbërje të Bordit Këshillues të ngritur nga FDUT për realizimin e programit të studimit "Master Ekzekutiv në Kriminologji;
3. FDUT duhet të shtojë përpjekjet dhe të nxisë e mbështesë financiarisht stafin akademik për të kryer kërkime shkencore, në përputhje me fushën e tyre të studimit;
4. Institucioni duhet të lidhë marrëveshje me institucione të tillë si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Spitale Psikiatrike si dhe institucione të tjerë, ku mund të realizohen praktika në lidhje me çështje specifike kriminologjike, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit;
5. Zyra e burimeve njerëzore në FDUT duhet të mbajë kopje të plotë të dosjeve të secilit anëtar të stafit të punësuar me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme;
6. FDUT duhet të marrë masat që të dhënat dhe informacionet, të cilat kanë të bëjnë me programin e studimit, strukturën akademike, përmbajtjen e lëndëve, metodat e mësimdhënies dhe kriteret e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë, shërbimet për studentët si dhe aktivitetet e ndryshme të publikohen dhe përditësohen rregullisht në faqen zyrtare *online* të fakultetit;
7. Hartimi i një dokumenti të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës, në formën e Udhëzuesit për zhvillimin e karrierës;
8. FDUT dhe njësia bazë duhet të rishikojnë, me qëllim përmirësimi, aktet e brendshme në funksion të sigurimit të cilësisë dhe plotësimin e standardeve të vendosur në këtë drejtim;
9. Përfshirja e një anëtari të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë, në NJSBC në nivel njësie kryesore;

**Evaluation's conclusions for the Third cycle study program Executive Master in "Criminology"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. The institution has a valuable experience in terms of setting up and developing programs of the third cycle of studies, such as the program under evaluation, experience which ensures the best addressing and coping with challenges and difficulties that may arise;
2. The institution supports the evaluation program and all its academic, scientific and administrative activities on a well-organized and functional structure, which is an important indicator in terms of institutional stability and the activities it carries out;
3. The academic staff engaged in this program has long experience in higher education institutions or in the justice sector, a factor of special importance for the fulfillment of the objectives related to the quality of the offered program;
4. The institution enables the scientific research of personnel through funding, creating opportunities for participation in scientific activities and mobility. In terms of the continued qualification of personnel, the OSCE Presence Project in Albania "For the creation of a Master's in Criminology" (2018-2023) is particularly relevant, which pays significant attention to the component of increasing the capacity of academic staff, engaged in this study program;
5. The institution has premises with the appropriate standards for the development of the study program, equipped with suitable tools from a logistical point of view;
6. The library guarantees ample access to the necessary literature of the program and the field of law in general, both physically and online;

**b. Weaknesses:**

1. Lack of periodic analytical plans regarding the results and benefits from cooperation agreements with other institutions in function of the realization of the study program; ***(Standard I.3, criterion 4)***
2. 2Lack of policy makers and representatives of the labor market in the composition of the Advisory Board set up by FDUT, where only academic staff and students participate, for the realization of the study program "Executive Master in Criminology; ***(Standard II.2, criterion 4)***
3. Lack of agreements with institutions such as the General Directorate of Prisons, Psychiatric Hospitals and other institutions, where internships can be carried out in relation to certain and specific criminological issues, in order to fulfill the objectives of this study program; ***(Standard IV. 2, criterion 7)***

**Recommendations**

1. FDUT should implement periodic analytical plans regarding the results from cooperation agreements with other institutions in function of the realization of the study program;
2. The inclusion of policy makers and representatives of the labor market in the composition of the Advisory Board set up by FDUT for the realization of the study program "Executive Master in Criminology;
3. FDUT should increase efforts and encourage and financially support academic staff to conduct scientific research, in accordance with their field of study;
4. The institution should conclude agreements with institutions such as the General Directorate of Prisons, Psychiatric Hospitals and other institutions, where internships related to specific criminological issues can be carried out, in order to fulfill the objectives of the study program;
5. The human resources office at FDUT should keep complete copies of the files of each staff member employed full-time or part-time;
6. FDUT should take measures that data and information, which are related to the study program, academic structure, course content, teaching methods, evaluation and quality assurance criteria, services for students and various activities are published and regularly updated on the official website of the faculty;
7. Drafting of a special document for students regarding orientation to the labor market, in the form of a Guide for career development;
8. FDUT and the basic unit should review, with the aim of improvement, the internal acts in function of quality assurance and the fulfillment of the established standards in this direction;
9. 9Involvement of an external member in the quality assessment process, in NJSBC at the main unit level;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | [redacted] | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |